

**“BASHKIMI EUROPIAN, ADMINISTRIMI I TIJ
DHE SHQIPËRIA”**

ARJAN GJINI

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
SHKENCA JURIDIKE, me profil **E DREJTË PUBLIKE**,
për marrjen e gradës shkencore, “ Doktor”.

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. XHEZAIR ZAGANJORI

Numri i fjalëve: 56.014

Tiranë, Janar 2021

DEKLARATË E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se ky studim është punë origjinale dhe nuk përmban plagjiaturë. Punimi është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të citura dhe të referuara.

ABSTRAKT

Bashkimi European aktualisht është një realitet i prekshëm. Tashmë, ky është një progres që ne e konsiderojmë të mirëqenë dhe të pakthyeshëm. Bashkimi European sot kërkon të përmirësojë jetën e të gjithëve. Një Europë e begatë për të gjithë qytetarët e vetë duke garantuar barazi sociale dhe institucione të konsoliduara dhe efikase. Ky unitet european, në përvjetorin e gjashtëdhjetë, duket tashmë kaq i mirëqenë, sa që i shohim vetëm ndonjë "mangësi", pa u kujtuar për të gjithë ato gjëra që na ka dhuruar, pavarësisht sfidave të tij. Forma e administrimit dhe e funksionimit të institucioneve dhe administratës së BE-së, mundësia reale e administrimit edhe në Republikën e Shqipërisë përbëjnë objektivat e punimit tim doktoral. Administrata publike ka të bëjë me institucionet publike,¹ me strukturat administrative që përbëjnë bazën e marrjes dhe të zbatimit të vendimeve, si edhe rregullat, sipas së cilave kryhen shërbimet publike.² Për këtë, shtjellimi i kësaj teme ka qenë e mbetet mjaft aktuale. Ky punim, ka parashtruar referenca të qarta të dala nga institucionet kryesore në BE, në Tiranë dhe vende të tjera të rajonit. Përse shërben Bashkimi Evropian?! Pa Bashkimin European, rregullat dhe traktatet e tij, Europa do vuante nga një mungesë stabiliteti politik, social, ekonomik dhe konfliktet e ndryshme, të cilat në të kaluarën kanë shkaktuar, një seri luftërash në zemër të Evropës. Bashkimi European sot është një fuqi ekonomike me një GDP të konsiderueshme që i imponohet ekonomisë globale . Sot BE-ja me një popullsi mbi 500 milionë banorë është një faktor i rëndësishëm në zhvillimet botërore. Dizertacioni është strukturuar në disa kapituj, të cilat kanë pasur për qëllim të parashtrojnë, të analizojnë e të shtjellojnë në mënyrë analitike teorike, nëpërmjet argumenteve të shumta, si edhe të ilustrimeve praktike kuptimin e politikave qeverisëse, studimin e modeleve të tranzicionit, zhvillimin institucional, perspektivat afatshkurtëra dhe afatgjata në qëndrueshmërinë të zhvillimit shoqëror. Analizimi i të gjithë faktorëve që ndikojnë në performancën e institucioneve të vendit dhe realizimin e një punimi i cili mund të jetë një kontribut i vlefshëm në spektrin juridiko-administrativ. Ky

¹ Etika në Administratën Publike: analizë e ligjit vendas për etikën Çani , EM., - academia.edu

² Terminologjia në administratën publike Stavileci , E., - Gjuha jonë, 2009 - ceeol.com

studim është i ideuar në një bibliografi të gjerë të temës objekt studimi. Punimi është ideuar si një model i pavarur autentik kërkimoro-shkencor me një spektër të gjerë fushëveprimi dhe argumentimi, duke përfshirë grupe të ndryshme interesi, duke përdorur metoda kërkimore shkencore. BE-ja nuk është vend i regresit social, siç mendojnë disa . BE-ja, është bastioni i modeleve tona sociale, grupi i shteteve ku liritë dhe demokracia, ta papërsosura siç janë gjithmonë, janë më të fortat dhe të mbrojturat në botë dhe këto praktika natyrisht janë shtjelluar dhe analizuar në mënyrë analitike dhe empirike në këtë punim doktorat.

Në fokus të punimit janë edhe disa përfundime konkrete dhe të qarta, rekomandime për të gjithë aktorët e interesuar, si për shërbimet në vendet e BE-së, edhe në Republikën e Shqipërisë. Objektivi për realizimin e një natyralizimi të aquis dhe një administrimi të një administrate koherente, produktive dhe që ka primare profesionalizmin e saj, nxitëse për politikëbërjen e BE-së. Nëpërmjet këtij punimi kemi sjellë raste konkrete të funksionimit dhe të administrimit të institucione të ndryshme administrative të cilat kanë impakt të ndjeshëm publik. Në punimin i është kushtuar rëndësi dhe kemi realizuar analiza, ilustrime e praktika të ndryshme e që nëpërmjet tyre kemi sjellë në vëmendje rolin e madh e produktiv që luan për zhvillimin e vendit një administratë publike cilësore, e aftë nga ana profesionale, me koncepte moderne në administrimin e institucioneve të vendit. Kjo, në këtë punim doktorat, është parë dhe është trajtuar si mënyra e duhur, e sigurtë për një administrim të qëndrueshëm, bashkëkohor, produktiv e të dobishëm. Sfidat e administratës publike në Shqipëri ngelen ende të mëdha, megjithatë integrimi në BE është i realizueshëm. BE, duke parë, se jo të gjithë duhet të ndjekin të njëjtën rrugë, në anëtarësi, arriti të deklarojë parimin e ritmeve dhe objektivave të diversifikuara, për të lejuar ata që duan, të shkojnë më larg e më shpejt.*

Fjalët kyçe: *Bashkimi Europian, siguri, harmonizim, zhvillim, drejtësi, integrim, prosperitet, menaxhim i përbashkët, vende anëtare, administrim, sfida ,aquis,Shqipëri.*

**Shif Deklarata e Romës: <http://www.consilium.europa.eu/it/press/press-releases> / 2017/03/25-rome-declaration.*

ABSTRACT

The European Union is a tangible reality. This union is by now well-established and irreversible. The European Union today strives hard to improve everyone's life. A prosperous Europe for all its citizens alike, guaranteeing social equality and co-ordinated and efficient institutions. This European unity which now celebrates its sixtieth anniversary is taken so much for granted that the lay person tends to focus on its potential "flaws", forgetting what it has offered and still does, despite the numerous challenges it has faced during its journey. The management system and the functioning of its institutions, the possibility of management in the Republic of Albania is the focus of my doctoral thesis. The public administration has to do with the public institutions, with the administrative structures as the bodies responsible for taking and executing decisions, so that the people may be the end-users of the public service they are rightly entitled to. For this reason this thesis has been and still remains highly relevant. This thesis has tried to address issues pertaining to the main institutions in EU, in Tirana and other countries in the region part of the EU. What is the use of the EU? Without the European Union, its rules and treaties, Europe would suffer from a lack of political, social and economic stability, and various conflicts which in the past have plagued its existence and caused a series of wars right in the heart of it. The European Union today is an economic power with a sizable GDP able to impose on the global economy. Today, the EU with a population of well over 500 million people plays an important role in world developments. The dissertation is structured in several chapters, which were intended to present, analyze and elaborate on theoretically and analytically, through a plethora of arguments, as well as practical illustrations the meaning of governing policies, the study of transition patterns, the institutional development, the short-term and long-term perspectives on the sustainability of societal development. The analysis of all the factors that affect the performance of our country's institutions and the realization of a dissertation that can be a modest yet valuable con-

tribution to the legal-administrative spectrum. This study was conceived along the lines of an independent authentic scientific-research model with a wide scope and argumentation, including various interest groups and using scientific-research methods.

The EU is not a place of social regress, as many think. On the contrary, it is a bastion of social progress, the group of nation-states where freedom and democracy, in their imperfect state as they always are, are among the strongest and the most well protected in the world and such realities are, of course, elaborated on and analyzed analytically and empirically in this doctoral thesis.

The focus of this thesis concerns some concrete and clear conclusions, recommendations to everyone interested in learning about the services in EU countries as well as about the services in Republic of Albania.

The objective of realizing a naturalization of the aquis and the management of a coherent, productive and highly professional administration, conducive to the EU policymaking. Through this study we have bring ample and concrete cases of the functioning and management of various administrative institutions which have a significant public impact.

In our study we have analyzed the important role that a professional public administration with modern concepts regarding the running of public institutions plays in the development of the country. This constitutes the focal point of our thesis and is seen and treated as a proper and safe way for a sustainable, contemporary and productive administration.

The challenges that the public administration in Albania faces are numerous, however the integration in EU is achievable. The EU being fully aware of the fact that not everyone should follow the same path towards becoming full member state, proclaimed the principle of diversified rhythms and objectives so as to allow those states who can and want to go farther and faster.*

Key words: *European Union, safety, development, justice, integration, member state, challenges, aquis, Albania.*

**<http://www.consilium.europa.eu/it/press/press-releases/2017/03/25-rome-declaration>*

Familjes sime

FALENDERIME

Me shumë kënaqësi shpreh falenderimet e mia të sinqerta për të gjithë ata që më ndihmuan, konsultuan dhe më mbështetën për realizimin e punimit tim të doktoraturës.

Së pari, falenderoj udhëheqësen shkencore të këtij punimi doktoral, i cili me kontributin e tij shkencor e metodik, më ka qëndruar pranë, më ka konsultuar, më ka ndihmuar dhe nxitur gjatë gjithë periudhës së punës për realizimin e këtij punimi.

Falenderime shkojnë për të gjithë kolegët e mi të Departamentit, të cilët direkt ose indirekt janë bërë pjesë e punës sime disavjeçare në realizimin e këtij punimi.

Falenderime të veçanta u shkojnë drejtuesve të shkollës doktrale për mbështetjen e vazhdueshme në të gjitha fazat e ndjekjes së studimeve.

Në këtë hap tepër të veçantë dhe të rëndësishëm për karrierën time profesionale e shkencore, falenderoj Zotin dhe mbështetien e familjes time, e cila më ka inkurajuar gjatë gjithë veprimtarisë sime për përgatitjen e këtij punimi doktoral.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

| | |
|--------------------------|----|
| Abstrakt..... | 3 |
| Falenderime..... | 8 |
| Lista e shkurtimeve..... | 13 |

KREU I PARË

HYRJE NË BASHKIMI EUROPIAN, ADMINSTRIMI I TIJ DHE SHQIPËRIA

| | |
|---|----|
| 1.1 Hyrje..... | 14 |
| 1.2 Konteksti i studimit..... | 14 |
| 1.3. Qëllimi, Objektivat dhe metodologjia e studimit..... | 19 |
| 1.4. Struktura, kufizimet e analizës dhe konsiderata etike..... | 21 |

KREU I DYTË

QEVERISJA NË BASHKIMIN EUROPIAN

| | |
|--|----|
| 2.1 Qeverisja në Bashkimin European..... | 25 |
| 2.1.1 Kompetenca të Bashkimit European..... | 26 |
| 2.1.2 Personaliteti juridik i BE-së..... | 27 |
| 2.1.3 Qytetaria e Bashkimit European..... | 28 |
| 2.1.4 Detyrat të Bashkimit European..... | 29 |
| 2.2 Zhvillimi historik i politikës së përbashkët para Traktatit të Maastrichtit..... | 31 |
| 2.3. Traktatet..... | 34 |
| 2.3.1 Traktati themelues i ECSC..... | 35 |

| | |
|--|----|
| 2.3.2 Metoda komunitare dhe ndërqeveritare e veprimit institucional..... | 37 |
| 2.3.3 Parimi i subsidiaritetit..... | 41 |
| 2.4 Vendimmarrja, Këshillimi dhe miratimi në nivel BE-je..... | 42 |
| 2.4.1 Instrumente ligjore të Be-së..... | 43 |
| 2.4.2 Bashkëvendimi..... | 45 |
| 2.4.3 Këshillimi dhe miratimi i vendimeve..... | 46 |

KREU I I TRETË

TEORITË BASHKËKOHORE NË ADMINISTRIMIN PUBLIK

| | |
|--|----|
| 3.1 Administrata publike si koncept..... | 49 |
| 3.2 Administrata publike dhe evolucioni për transformim | 51 |
| 3.2.1 Transparenca dhe Decentralizimi..... | 53 |
| 3.2.2 Modelet organizative në organet publike..... | 56 |
| 3.3 Administrata e BE-së..... | 58 |
| 3.3.1 Nënpunësit publikë..... | 60 |
| 3.4. Gjykata europiane e auditëve..... | 61 |
| 3.4.1 Metodologjia e auditimit..... | 62 |
| 3.4.2 Politika të auditimit..... | 63 |
| 3.4.3 Llojet e auditimit dhe zyra e antimashtrimit european(OLAF) | 69 |
| 3.5. Institucione të konsoliduara..... | 70 |
| 3.5.1 Praktikiteti i procedurave të institucioneve..... | 77 |
| 3.5.2 Legjitimiteti ndërshtetëror dhe sovraniteti..... | 79 |
| 3.6 Problematikat institucionale të BE-së.Roli i Komisionit European dhe Këshillit të BE-së..... | 80 |
| 3.6.1 Vullneti politik nga shtetet përbërëse të BE-së..... | 81 |

| | | |
|-------|--|----|
| 3.6.2 | Format dhe teknikat e bashkpunimit dhe rezultateve midis tyre..... | 85 |
| 3.6.3 | Zhvillime institucionale të BE-së..... | 90 |
| 3.6.4 | Efikasiteti dhe Demokratizimi i Institucioneve..... | 92 |
| 3.6.5 | Forma e integritit e diferencuar..... | 94 |

KREU I KATËRT

INTEGRIMI NË BASHKIMIN EUROPIAN

| | | |
|-------|--|-----|
| 4.1 | Koncepte nga politika për koordinimin e veprimit të jashtëm të Bashkimit Evropian.... | 97 |
| 4.2 | Zhvillimi i politikës për koordinimin e veprimit të jashtëm të Bashkimit Evropia pas traktatit të Maastrichtit..... | 100 |
| 4.2.1 | Traktati i Maastrichtit..... | 102 |
| 4.2.2 | Traktati i Amsterdimit..... | 107 |
| 4.2.3 | Traktati i Nices..... | 109 |
| 4.2.4 | Politika e Jashtme dhe e sigurisë - Traktati i Lisbonës..... | 111 |
| 4.2.5 | Nënkryetari i Komisionit Evropian dhe Përfaqësuesi i lartë për koordinimin e veprimit të jashtëm të Bashkimit Evropian..... | 112 |
| 4.3 | Anëtarësimi në BE dhe vendet e Ballkanit Perëndimor..... | 114 |
| 4.3.1 | Politika e afrimit..... | 116 |
| 4.3.2 | Proçesi i stabilizim-asociimit..... | 117 |
| 4.4 | Shqipëria dhe rruga për anëtarësim në Bashkimin Evropian..... | 118 |
| 4.4.1 | Shkëmbimi ekonomik Shqipëri - BE..... | 119 |
| 4.4.2 | Përfitimi i Shqipërisë nga Asistenca teknike dhe financiare e BE-së..... | 120 |
| 4.4.3 | Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim e Shqipërisë(SKZHI)..... | 123 |
| 4.5 | Administrata publike në Shqipëri..... | 126 |

| | |
|--|-----|
| 4.5.1 Pritshmëritë dhe motivimi për në BE i administratës publike Shqiptare..... | 129 |
| 4.5.2 Strategji të reja komunikimi për integrimin në BE..... | 130 |
| 4.5.3 Administrata publike në Shqipëri në vitet 1990 - 2020..... | 133 |

KREU I PESTË

ASPEKTE KONKRETE TË ADMINISTRIMIT DHE TË RREGULLIMIT LIGJOR NË BE DHE SHQIPËRI

| | |
|--|------------|
| 5.1 Ndikimi nga unifikimi i së drejtës civile në administrimin europian..... | 129 |
| 5.1.1 Krijimi i një të drejte civile të unifikuar në Europë..... | 130 |
| 5.1.2 Përgatitja e Kodit Civil Europian..... | 133 |
| 5.2 E drejta e pronësisë intelektuale..... | 135 |
| 5.2.1 E drejta e autorit dhe pronësia industriale..... | 139 |
| 5.2.2 Pronësia industriale..... | 142 |
| 5.3 Rregullimi ligjor ndërkombëtar i pronësisë intelektuale..... | 145 |
| 5.3.1 Këndvështrimi i Bashkimit Europian lidhur me të drejtën e pronësisë intelektuale.... | 150 |
| 5.4 Administrimi i organizatave sindakale në Shqipëri..... | 145 |
| 5.4.1 Rregullimi ligjor i organizatave sindakale në Shqipëri | 154 |
| 5.5 Organizata sindakale në Bashkimin Europian..... | 158 |
| 5.5.1 Rëndësia e organizatave sindikale..... | 160 |
| 5.6 Roli i gjykatës në reformën administrative në Shqipëri dhe efikasiteti i saj..... | 162 |
| 5.6.1. Gjykata administrative kontrolluese e ligjshmërisë..... | 164 |
| 5.6.2 Organizimi the gjykimi administrativ | 165 |
| Përfundime..... | 170 |
| Rekomandime..... | 177 |
| BIBLIOGRAFIA..... | 181 |

LISTA E SHKURTIMEVE

BE- Bashkimi European

KM- Këshilli i Ministrave

BME- Bashkimi Monetar European

SHBA- Shtetet e Bashkuara të Amerikës

KE- Këshilli European

KEE- Komuniteti Ekonomik European

KEQÇ- Komuniteti European për Qymyr dhe Çelik

KEM- Komuniteti European i Mbrojtjes

PE- Parlamenti European

L.II.B- Lufta e Dyte Botërore

BRSS- Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike

OKB- Organizata e Kombeve të Bashkuara

NATO- Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut

KPS- Komiteti Politik dhe i Sigurisë

GJEDNJ(ECHR) - Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut

KPJ- Këshilli për Punë të Jashtme

SHJE- Shërbimi i Jashtëm European

AEM- Agjencia Europiane e Mbrojtjes

PEMS- Politika Evropiane e Mbrojtjes dhe Sigurisë

PPMS- Politika e Përbashkët e Mbrojtjes dhe e Sigurisë

PPJS- Politika e Përbashkët e Jashtme dhe Sigurisë

KÇPMJ- Këshilli për Çështje të Përgjithshme dhe Marrëdhënie me Jashtë

EUISS- Instituti European për Studime të Sigurisë

FAO- Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë

POCs- Rrjetet e Pikave Kombëtare të Kontakteve

KREU I

HYRJE

NË BASHKIMI EUROPIAN ADMINSTRIMI I TIJ DJHE SHQIPËRIA

1.1 KONTEKSI I STUDIMIT

Ky punim është një vazhdim i thelluar i studimeve të mia dhe ka për qëllim që të japë një informacion doktrinar në fushën e njehsimit të praktikave më të mira ligjore dhe administrimin e mirë të qeverisjes.³

Kjo e drejtë është pjesë e fushës së madhe të së drejtës në tërësi dhe asaj administrative në veçanti dhe vendos në qendër të saj rregullimin ligjor në aspekte konkrete të unifikimit të së drejtës civile në hapësirën e BE-së, sjelljen në një formë të re të raporteve midis individit dhe shtetit duke krijuar një standartizim të qëndrueshëm në këtë fazë të integritit të Shqipërisë në BE. Studimi i së cilës është jo vetëm me interes për doktrinën por edhe një nevojë e diktuar nga zhvillimet e këtyre integritimeve.⁴

Forma e administrimit dhe e funksionimit të institucioneve dhe administratës së BE-së, mundësia reale e administrimit edhe në Republikën e Shqipërisë përbëjnë objektivat e punimit tim doktoral.

Tema e trajtuar në këtë dizertacion është objekt i një spektri të gjerë dhe me ndikim të drejtëpërdrejtë në jetën e individit dhe shoqërisë, ndaj studimi ka synuar të dalë në konkluzione të pavaruara në mes të administratës publike si një praktikë dhe administrimin publik si një fushë akademike.⁵

³ Public diplomacy, Snow, N., - Oxford Research Encyclopedia of International Studies, 2020 - oxfordre.com

⁴ Historical institutionalism and the study of law, Smith, R., - The Oxford Handbook of Law and Politics, 2008 - oxfordhandbooks.com

⁵ Research methods for public administrators Rassel, G., Leland, S., Mohr, Z., O'Sullivan, E., - 2020 - Routledge

Ka qenë e vështirë të shkohej drejt një unifikimi mbi modelet e përzgjedhura për realizimin e objektivave të institucioneve përkatëse por pavarësisht kësaj, Institucionet e Bashkimit European së bashku me organizatat ndërkombëtare kanë arritur të vendosin disa standarte ndërkombëtare të cilat duhet të mbajnë parasysh legjislatorët kombëtare gjatë hartimit të ligjeve, me synim qeversijen e mirë.

Këto standarte jo vetëm realizojnë rritjen e shërbimeve kombëtare të ofruara nga administrata publike por ndihmojnë gjithashtu edhe në procesin e efikasitetit, duke garantuar në të gjitha rastet të drejtat e qytetarit, rritjen e besueshmërisë dhe transparencës në këto shërbime të institucioneve si dhe sigurimin e zbatimit të ligjit.⁶

Çështja e zhvillimit dhe rritjes së kapaciteteve në administratë është konsideruar si mjaft aktuale edhe është në qendër të diskutimeve ku pavarësisht përpjekjeve të bëra, ngelet ende shume për tu kryer dhe në këtë drejtim ky punim synon të jetë prezent.⁷

Që në ditët e para të tranzicionit politiko- ekonomik të Shqipërisë, qytetarët Shqiptarë kanë kërkuar të gjithë një zëri integrimin në BE për më tepër mirëqenie dhe institucione si ato të BE-së dhe SHBA-së. Në Shqipëri, fillesat e këtyre institucioneve bashkëkohore shënohen pas viteve '90 ndërsa rregullimi dhe mbikqyrja e tyre disa vite më vonë. Thënë këtë, për realizimin e këtij punimi kam hasur në vështirësi të konsiderueshme.

Në këtë studim, kemi pasqyruar punën kërkimore si metodë produktive e frytdhënëse e bashkëpunimit institucional kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën juridiko-administrative. Kemi shtjelluar teoritë, analizat dhe studimet kërkimore që kanë treguar e tregojnë përparësitë e BE-së në procesin e europianizimit, por edhe problematikat që paraqiten gjatë aplikimit të detyrimeve ndërkombëtare në procesin integruar të vendit tonë. Në këtë punim studimor, ka qenë e rëndësishme të pasqyrohej një vështrim i përgjithshëm historiko-teorik, i cili më pas ka ardhur duke u detajuar drejt çështjeve kryesore të problemit, të mbështetura në literaturën historike të vendit të BE-së, ndërkombëtare si edhe në burimet e intervistave e në

⁶ The future of public administration and law in 2020 Rosenbloom, DH., O'Leary, R., Chanin, J., - Public Administration Review, 2010 - JSTOR

⁷ Quantitative methods in public administration: Their use and development through time Groeneveld, S., Tummers, L., Bronkhorst, B., - International Public ..., 2015 - Taylor & Francis

literaturë. Vështrimi teorik i këtij punimi, ka sjellë e ka përcjellë rëndësinë që kanë këto qasje teorike në përmirësimin e administratës publike në Republikën e Shqipërisë, sukseset që kanë arritur këto teori me kontributin e tyre duke u zbatuar në shumë shtete që hasin në të njëjtat problematika e zhvillime bashkëkohore. Punimi është përqendruar më shumë në rëndësinë që paraqet ndërtimi i institucioneve, rritja e kapaciteteve profesionale të administratës publike, ballafaqimi me procesin e integritit europian në vendet anëtare të BE-së dhe në Shqipëri.⁸

Në funksion të shtjellimit dhe të analizës cilësore të reformave në institucionet e administratës publike, janë trajtuar në mënyrë të qartë dhe të përmbledhur gjetjet dhe ku besojmë ja kemi arritur të identifikojmë problematikat konkrete.⁹ Në fushën e administrimit në vend, kemi sjellë përfundimet që do ta çonin në një stad cilësor funksionimin e kësaj administrate. Mendojmë gjithashtu se unifikimi i shumë praktikave që ndërthurin institute në të drejtën private me atë administrative dhe të punës me të drejtën e BE-së dhe të drejtën ndërkombëtare janë në qendër të këtij disertacioni me bindjen se janë e ardhmja e një bote të drejtë efikase dhe elemente kryesorë të një qeverisjeje të mirë.

Administrata publike në Shqipëri, ashtu si dhe administrata e Bashkimit Europian kanë sfida të vazhdueshme për të realizuar një qeverisje sa më të drejtë dhe efikase.¹⁰

Sot njerëzimi mbarë, ka sfida c pritshmëri nga më të lartat dhe kjo po kërkojë gjithnjë e më shumë një qeverisje të mirë, bazuar në efikasitet dhe performancë. Një qeverisje solide ka garantie për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të dëshiruar nga komuniteti.¹¹

Mendoj që punimi doktoral kërkimor shkencor i prezantuar, paraqet një interes të veçantë jo vetëm për fushën ku është fokusuar por dhe në aspektin shkencor, doktrinar dhe gjyqësor për interpretimin dhe zbatimin me korrektësi të arritura nga njohja dhe unifikimi i praktikave

⁸ EU administrative conditionality and domestic downloading: the limits of Europeanization in challenging contexts Elbasani, A., - 2011 - papers.ssrn.com

⁹ Research methods for public administrators Rassel, G., Leland, S., Mohr, Z., O'Sullivan, E., - 2020 - Routledge

¹⁰ Government transfers and political support Manacorda, M., E Miguel, Vigorito, A., - American Economic Journal ..., 2011 - aeaweb.org

¹¹ The principle of sustainability: transforming law and governance, Bosselmann, K., - 2016 - books.google.com

dhe përfundimeve të tij, por ai shërben në të njëjtën kohë edhe si një burim i rëndësishëm për studiuesit e të drejtës, juristët e studentet e fakulteteve juridik, shkencave administrative, nëpunësve si dhe për çdo person që merret me zbatimin e tij në praktikë.¹²

Interpretimet doktrinar në mungesë të përcaktimeve të qarta ligjore, por edhe problemet që ndeshen në praktikë nuk mund të ezaurohen plotësisht në këtë punim, jam i ndërgjegjshëm se kjo punë hulumtuese e arritur nuk është as shteruese edhe as e fundit.

Kur vendosa të trajtoja, të analizoja këtë temë të punimit tim doktoral, kisha bindjen e plotë se po studioja dhe do të shtjelloja një nga fushat më të rëndësishme të doktrinës e jurispru- dencës gjyqësore. E quajta interesante, sepse kjo fushë përfshinte mjaft koncepte të reja, por në të njëjtën kohë këto koncepte janë mjaft të vështira e sqarimi i tyre kërkon vullnet dhe punë të vazhdueshme.¹³

Zgjedha këtë fushë të re e moderne, sepse së fundmi kjo ka marrë një shtrirje e ndikim të madh, edhe në kontekstin shqiptar. Administrimi Publik, ka qenë dhe është kryesor në qeveri- sjen e një vendi, si edhe me shumë rëndësi për produktivitetin e qeverisjes. Bashkimi Euro- pian është forma më e mirë e zgjedhur nga popujt për qeverisjen e komuniteteve europiane. Një shembull i suksesshëm në tërësi, por konkret për popujt që e krijojnë janë Shtetet e Ba- shkuara të Amerikës.¹⁴ Bashkimi Europian (BE) është unik për nga forma dhe kjo, pasi ven- det e saj anëtare mbeten të pavarura dhe sovrane. BE-ja nuk është një sistem federal i qeveri- sjes, por nuk është as thjesht një organizatë ndërqeveritare si Kombet e Bashkuara. Vendet anëtare të BE-së kanë bërë disa lëshime të sovranitetit të tyre dhe kështu BE-ja ka arritur të fitojë forcë shumë më të madhe kolektive e ndikim sesa, kur shtetet mund të kenë vepruar individualisht. Popujt europianë kanë lëshuar sovranitetin e tyre për marrjen e vendimeve të përbashkëta, nëpërmjet institucioneve të përbashkëta të tilla si : Parlamenti Europian i zgjed-

¹² The attitudinal, behavioral, and performance outcomes of work engagement: A comparative meta-analysis across the public, semipublic, and private sector Borst, RT., Kruijen, PM., Lako., CJ.,- ... Administration, 2020 - journals.sagepub.com

¹³ Land, R., Meyer, JHF, Baillie , C., - 2010 - dro.dur.ac.uk

¹⁴ American empire and the origin of public administration Roberts , A., - ... on Public Management and Gover- nance, 2020 - academic.oup.com

hur nga qytetarët e BE-së dhe Këshillit Evropian, i cili përfaqëson qeverinë kombëtare. Së bashku ata vendosin mbi bazën e propozimeve të bëra nga Komisioni Evropian, prej të cilit përfaqësohen interesat e BE-së si një e vetme. Bashkimi Evropian ka krijuar një partneritet politik dhe ekonomik midis të 27-të vendeve europiane.¹⁵ BE-ja ka dhënë një gjysmëshekulli paqe, stabilitet, prosperitet dhe ka ndihmuar për të rritur standardet e jetesës, ka krijuar një monedhë të përbashkët europiane.

Ajo është duke ndërtuar në mënyrë progresive një treg të vetëm në mbarë Europën, në të cilën njerëzit, mallrat, shërbimet, kapitali të lëvizin lirisht si brenda një vendi.

BE-ja u krijua si pasojë e Luftës së Dytë Botërore. Hapat e parë janë për të nxitur bashkëpunimin ekonomik me synimin se vendet që tregtojnë me njëri-tjetrin janë edhe të ndërrarura ekonomikisht e kështu kjo do të shmangë konfliktin.

Që atëherë BE-ja ka zhvilluar në një treg të madh të vetëm me euron, si monedhën e vet të zakonshme.

Ajo që filloi si një bashkim ekonomik, thjesht ka evoluar në një organizatë që përfshin të gjitha fushat qeverisëse, nga ndihma e zhvillimi tek politikat mjedisore.

BE-ja ka bërë e po bën një punë të palodhur për një Europë të re. "Të bashkuar në diversitet". Kjo moto e BE-së ka prekur jetët e individëve të këtij kontinenti dhe përditë bëhet më shumë konkrete. Pavarësisht nga forma ose perkufizimi, roli i BE-së është bërë më influent.

Prirje e plotë e vendit tonë për t'u bërë pjesë e BE-së, por që në praktikë ka treguar edhe vështirësi.

Institucionet shqiptare janë angazhuar për t'u bërë anëtare në Bashkimin Evropian në tridhjet vitet e fundit ku përpjekjet kanë qenë dhe janë evidente.

Shqipëria është një vend i lirë me sistem qeverisjeje të bazuar në ndarjen e tre pushteteve dhe i mbështetur në një prej sistemeve më tradicionale të së drejtës euro-atlantike dhe si vend kandidat për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian ka krijuar dimension tjetër të së drejtave sociale, ekonomike, ligjore etj.

¹⁵ From 6 to 27 members - European Commission - europa.eu/eucom/europa.eu > ... > Neighbourhood - Enlargement

*1.2. QËLLIMI , OBJEKTIVAT DHE METODOLOGJIA E STUDIMIT.*¹⁶

Punimi, sjell një pasqyrë të shkurtër të institucioneve kryesore, organeve të tjera si edhe agjencive që janë të përfshirë në punën e Bashkimit Evropian.¹⁷ Qëllimi është që t'ju ofrohet si një udhëzues i dobishëm shkencor për vendimmarrje në këtë përafrim të Republikës së Shqipërisë me Bashkimin Evropian, me institucionet dhe me veprimtarinë e gjithanshme të tij.

Shumë pyetje mund të ngrihen si të dalin nga ndërveprimi dhe kërkesa për hapësirat e BE-së, të tilla si:

- Si punon BE? Sa e njohim procesin?
- Kush është përgjegjës dhe për çfarë?
- Cilat janë ndikimet në institucionet shtetërore, rajonale, individëve, anëtarëve të BE-së, kandidatëve dhe vendeve të tjera?
- A humbet shtëtesia e vendit anëtar?
- A ka filluar administrata shqiptare të ndërveprojë si ajo e BE-së?
- A ka përfitim maksimal, si edhe për shtetet e tjera BE-ja?
- Si duhet Shqipëria të natyralizojë qëndrimin e saj ndaj institucioneve të BE-së?
- Si mund të punojnë së bashku?
- A është formimi i administratës elementare parësor në veprimtarinë produktive të BE-së?
- Dallon statusi i nëpunësit evropian nga ai vendas?

Historia e zhvillimit nuk ka shumë hapësirë në këto tema të referuara, të cilat kanë synuar të parashtronjë administrimin publik, rregullat (acquis) dhe unifikimin e praktikave.¹⁸

¹⁶ Research methods for public administrators Rassel, G., Leland, S., Mohr, Z., O'Sullivan, E., - 2020 - Routledge

¹⁷ Institutions and bodies | European Union - europa.eu/europa.eu > european-union > about-eu > institutions-b...

¹⁸ The European administrative space (EAS), Torma . A., - European Integration Studies, 2011 - 193.6.1.94

Kapitujt kanë synuar të pasqyrojnë me metodologji studimore qeverisjen dhe jetësimin e praktikave të njehsuara të saj. Titujt janë hartuar duke u bazuar mbi faktet e deritanishme dhe kanë për objektiva të shërbejnë formimit dhe produktivitetit të mirëmenaxhimit publik dhe njehsimit të praktikave ligjore.

Supozimi kryesor i punimit është se raportet informale të administratës publike bëhen të mundura nga papërshtatshmëria e legjislacionit, por dhe nga përgatitja për punën në zyrat e administratës shtetërore dhe garancitë që vijnë nga statusi evropian, nga bashkëpunimi organik e institucional me BE-në.¹⁹

Nisur nga ky supozim, studimi ka synuar :²⁰

- Të identifikojë dhe të bëjë të qartë ligjin dhe praktikën e Bashkimit Evropian duke e zbatuar atë të njehsuar nga Administrata në Republikën e Shqipërisë;
- Të eliminojë frazat dhe shprehjet e paqarta, praktikave ligjore jo të qarta, boshllëqet dhe eliminimi i praktikave të vjetëruara dhe krijimi i një mendësie pozitive evropiane, të cilat janë pjesë e analizës së punimit;
- Praktikave ligjore të punësimit dhe njohja me sistemet, qeverisjen, agjencitë dhe organizatat më produktive në botë;
- Arsenali i metodave për identifikimin e gjetjeve dhe rekomandimeve ka përfshirë një metodologji të gjerë të analizës qeverisëse botërore në funksion të administrimit publik, ballafaqimit krahasues të legjislativioneve, njohjen e burimeve, praktikave më të mira, konsultimeve, përvojës, risive dhe ato hulumtuese²¹.

¹⁹ Identification of research hypotheses and new knowledge from scientific literature
Shardlow, M., Batista, R., -Navarro... - BMC medical ..., 2018 - bmcmedinformdecismak

²⁰ Oxford Handbook of Nutrition and Dietetics 3e ,Webster-Gandy, J., Madden, A., Holdsworth, M., - 2020 - Oxford University Press

²¹ Interdisciplinary research: Process and theory ,Repko, AF., Szostak, R., - 2020 - SAGE Publications, Incorporated

Duke iu drejtuar një tematike të gjerë të administrimit publik dhe administratorëve publikë duke interpretuar se nocioni “administratë publike”²² është më i gjerë se sa nocioni administratë shtetërore, sepse ajo përfshin në të përveç veprimtarisë së administratës shtetërore edhe veprimtarinë e institucioneve publike, të cilat nuk kanë karakter shprehimor të organeve shtetërore, si private, parteritet publik - privat, ente të tjera të përcaktuara nga ligji dhe ushtrojnë punë të karakterit publik.²³

1.3. STRUKTURA , KUFIZIMET E ANALIZËS DHE KONSIDERATA ETIKE.

Punimi është realizuar t’u vijë në fokus dhe është bashkëpunuar me:

- Studentë të shkencave juridike dhe të administrimit publik;
- Institucioneve shtetërore, publike dhe enteve që merren me zbatimin e procedurave publike;
- Institucione që veprimtari të tyre kanë integrimin dhe performancën euroatlantike të administratës publike;
- Publikun, studiues, grupe të ndryshme të interesit dhe aktorëve të tjerë të interesuar.

Punimi doktoral është strukturuar në këtë mënyrë:

- Përveç hyrjes, analizës së qeverisjes, që përbën edhe substancën e punimit – është konceptuar në disa kapituj të tjerë , dhe konkretisht:
- Qeverisja në Bashkimin Europian;
- Teoritë bashkëkohore në administrim publik;
- Integrimi në BE;²⁴

²² Philosophy and public administration: An introduction, Ongaro , E., - 2020 - books.google.com

²³ Non-governmental organizations and development , Lewis, D ., Kanji, N., Themudo NS., - 2020 - Routledge

²⁴ Harvard, VJ., Hamburger, J., Emanuel, JP., - 4th Annual Harvard ... , 2020 - scholar.harvard.edu

- Aspekte konkrete të administrimit dhe rregullimeve ligjore në BE dhe Shqipëri.
- Përfundime, Rekomandime, dhe Bibliografia.

Seicili nga këta kapituj ka një strukturë ku gjejnë pasqyrim metodologjik dhe metodat më bashkohore të studimit: Kuptimi, organizimi qeverisës, të drejtat dhe përgjegjësitë, performanca, formësimet moderne, lidhja me publikun, gjetja, evidentimi e nxitja e risive në unifikim janë tipare dalluese për seicilin kre të punimit doktoral.

Kufizimet e analizës: ²⁵Analiza ka në fokus, pra shtjellon në mënyrë analitike perceptimin, realizimin dhe karakteristikat e një administrate evropiane e njësuar, si një administratë funksionale qendrore e vendore.

Në analizën dhe metodologjinë e bërë është preferuar një koncept i gjerë, pra aktet dhe institucionet që prekin gjithë shoqërinë, ose kategori të gjera të tyre. Debati për qeverisjen evropiane, i nisur nga Komisioni në Librin e Bardhë ²⁶në korrik 2001, ka qenë i lidhur drejtpërdrejt me të gjitha rregullat dhe procedurat, praktikat që ndikojnë në realizimin e kompetencave brenda Bashkimit Evropian. ²⁷

Qëllimi ka qenë që të miratoheshin forma të reja qeverisjeje, të cilat e afrojnë Bashkimin Evropian me qytetarët evropianë, e bëjnë më efektiv dhe përforcojnë demokracinë shtetin e së drejtës dhe qeverisjen efikase në Europë, si edhe konsolidojnë performancën e institucioneve. Bashkimi Evropian ka reformuar institucionet e veta, në mënyrë që të realizonte programin e zhvillimit të mirartuar konform praktikave në institucionet e BE-së.

Qeverisje duhet të përqendrohet në gjetjen dhe në zbatimin e politikave më të dobishme e më afatgjata që lidhin organizatat në tërë zonën e evropiane.

Komisioni dhe Parlamenti Evropian janë duke bërë një strukturim cilësor në legjislacionit aktual evropian, duke e bërë atë më të qartë dhe më të konsoliduar.

²⁵ Methodology: Foundations of inference and research in the behavioral sciences, De Groot, AD., Spiekerman, JAA., - 2020 - Walter de Gruyter GmbH & Co KG

²⁶ European Governance A White Paper - europa.europa.eu › rapid › press-release_DOC-01-10_en

²⁷ EU law: text, cases, and materials, Craig, P., De Búrca, G., - 2020 - books.google.com

Bashkimi European ka kontribuar në debatin për qeverisjen e mirë nëpër botën dhe ka luajtur rol të rëndësishëm në rritje në përmirësimin e funksionimit të institucioneve ndërkombëtare në kuadër të OKB-së dhe jo vetëm.²⁸

Temat e shtjelluara paraqesin në gjuhë të qartë dhe të thjeshtë për shkollën e Administrimit Publik, por jo vetëm atë që përgatit punonjësit e ardhshëm, kryesisht për institucionet qeveritare, entet publike e private, por edhe organizatat joqeveritare etj.²⁹

Puna kërkimore ka pasqyruar një lidhje midis teorisë dhe praktikës, si një nga kushtet më të rëndësishme për arritjet e këtij studimi do të jenë në gjendje të krijojnë një këndvështrim të ri mbi njohuritë në menaxhim publik, drejtësi, ekonomi, etj.³⁰ Punimi do të sjelli raste praktike të unifikimit dhe zbatimit në realitet për jetuesit në BE dhe Shqipëri si mundësi aplikimi nga administrata në shërbim të komunitetit dhe arritjes së standarteve sa më efektive të kësaj administrate.

Kjo do të jetë në përputhje me kriteret dhe parimet e BE-së. Këto parime si ai ndarjes së pushtetit, ekuilibri institucional, autonomisë, lualajiteti kushtetues, transparencë institucionale dhe njohja e publikut kanë qenë dhe standartet udhëheqëse dhe baza orientimi të këtij punimi kërkimor.³¹

Njohja me parime teori dhe të reja bashkëkohore në administrim publik dhe sfidat që sjell koha në menaxhim publik si ai mos ndarjes së funksioneve dhe besnikëria kushtetuese ku institucionet në tërësi e kanë detyrim të zgjidhin problemet dhe jo ti krijojnë ato.³²

²⁸ Redesigning and reforming European regional policy: The reasons, the logic, and the outcomes, McCann, P., Ortega-Argilés, R., - International Regional ..., 2013 - journals.sagepub.com

²⁹ Law for states: International law, constitutional law, public law Goldsmith, J., Levinson D., - Harv. L. Rev., 2008 - HeinOnline

³⁰ Qualitative research methods Hennink, M., I Hutter, I., Bailey, A., - 2020 - books.google.com

³¹ Implications for educational practice of the science of learning and development, Darling-Hammond, L., Flook, L., - Applied ..., 2020 - Taylor & Francis

³² Responsible research and innovation: From science in society to science for society, with society Owen, R., P Macnaghten, R., Stilgoe, J., - Science and public policy, 2012 - academic.oup.com

Konsiderata etike,³³ i tërë ky punim, nëpërmjet tezave dhe hipotezave të ngritura është i lidhur ndërmjet strukturës së tij, duke përdorur metodat shkencore të shkrimit dhe kërkimit humltues sjell një zgjidhje në praktike në të mirën publike, synimi për të cilin nisi ky studim.

Gjatë gjithë këtij punimi shkencor u jemi referuar vetëm fakteve, teorive e praktikave të njohura nën kujdesin e udhëheqesit shkencor, larg ndikimeve të ditës, por në asnjë rast pa pretenduar se kjo fushë e gjerë dhe mjaft komplekse ka qenë shteruese.

³³ Ethical standards in sport and exercise science research: 2020 update, Harriss, DJ., MacSween, A., - International journal of ..., 2019 - research.tees.ac.uk

KREU II

BASHKIMI EUROPIAN DHE FUNKSIONIMI I TIJ

2.1. QEVERISJA NË BASHKIMIN EUROPIAN

Bashkimi European është një familje e vendeve demokratike të Evropës ku vendet punojnë së bashku për të përmirësuar jetën e qytetarëve të tyre dhe për të ndërtuar një botë më të mirë.

Edhe pse shpesh ka probleme që me apo pa arsye i delegohen këtij bashkimi³⁴. Mund të themi me bindje se BE-ja është sot në fakt një histori suksesi e prekshme.

Në më shumë se gjysmë shekulli ajo ka arritur paqe dhe prosperitet në Evropë, një monedhë të përbashkët evropiane (euro) dhe një "treg të vetëm" pa kufij, të mallrave, njerëzve, shërbimeve dhe të lëvizjes lirisht të kapitalit.

BE-ja është bërë një fuqi e madhe tregtare, me një GDP prej 14600 miliardë euro³⁵. Rreth 20% të eksportit botëror. Pra leader absolute përse i përket ekonomisë edhe pse popullsia e saj përbën vetëm 6.9% të popullsisë globale³⁶.

Suksesi i Bashkimit European është barazia, unanimiteti dhe kooperimi ku çdo vend partner i vogël apo i madh qoftë ky ka të drejta të barabarta në vendimarrje, këto të drejta të plota, të arritura i detyrohet shumë mënyrës të pazakontë në të cilën po punon.

Ata kanë lënë sovranitetin e tyre në mënyrë që të fitojnë një forcë më të madhe dhe me ndikim në botë. BE-ja është në fakt unike si formë e organizimit të njohura këto në sistemet e së drejtës. BE do të thotë sovranitet në praktikë, janë shtetet anëtare që bëjnë bashkimin, të

³⁴ Thomson, R., Torenvlied, R., - British Journal of Political Science, 2011 - JSTOR

³⁵ GDP boterore është 77301958 miliardë pra 18.8% të GDP-se boterore e përben BE.

³⁶ https://europa.eu/european-union/about-eu/figures/economy_it

cilët delegojnë disa të drejta vendim- marrëse në institucionet e përbashkëta që ata kanë krijuar, në mënyrë që vendimet mbi çështje specifike të interesit të përbashkët mund të bëhen në mënyrë demokratike dhe produktive në nivel evropian.

E Drejta e BE-së përbëhet nga traktatet themeluese (legjislacioni parësor) dhe dispozitat e akteve të miratuara nga institucionet komunitare në lidhje me zbatimin e këtyre traktateve d.m.th. rregullore, direktiva etj. (legjislacioni dytësor).³⁷ Në një kuptim më të gjerë, e Drejta e BE-së përfshin të gjitha rregullat e rendit ligjor komunitar,³⁸ duke përfshirë parimet e përgjithshme të së drejtës, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian, të drejtën që rrjedh nga marrëdhëniet e jashtme të BE-së dhe e drejta shtesë që përfshihet në konventa e marrëveshje të ngjashme, të lidhura ndërmjet shteteve anëtare dhe që kanë për qëllim zbatimin e dispozitave të traktateve.

Të gjitha këto rregulla të së drejtës përbëjnë një pjesë të asaj që njihet si ligjet ose Acquis³⁹ të BE-së.⁴⁰

2.1.1 Kompetenca të Bashkimit Evropian:

Kompetencat e BE-së ato janë kompetencat që i janë dhënë Bashkimit Evropian në disa fusha të shoqërore nga shtetet anëtare.⁴¹ Ka tri lloje kompetencash, të cilat varen nga mënyra e atribuimit⁴²:

³⁷ Regulations, Directives and other acts | European Union europa.eu > european-union > law > legal-acts_en

³⁸ G De Búrca - Harv. Int'l LJ, 2010

³⁹ Acquis communautaire - Wikipedia en.wikipedia.org > wiki > Acquis_communautaire

⁴⁰ EU's 'acquis' - EUR-Lex eur-lex.europa.eu > summary > glossary > acquis

⁴¹ European Public Law: The Achievement and the Brexit Challenge, Birkinshaw, P.J., - 2020 - Kluwer Law International BV

⁴² Castaño-Muñoz, J., Colucci, E., Smidt - H., Review of Research in Open and ..., 2018 - erudit.org

Kompetenca të qarta: ⁴³ janë përcaktuar qartë në traktate; Kompetenca të nënkuptuara: kur komuniteti evropian ka kompetenca të qarta në një fushë të veçantë (p.sh. transporti) si edhe kompetenca në të njëjtën fushë në lidhje me marrëdhëniet e jashtme si rasti për bisedime për të arritur marrëveshje ndërkombëtare ; ⁴⁴: Kur BE nuk ka kompetenca të qarta ose të nënkuptuara për të arritur një qëllim të përcaktuar nga Traktati në lidhje me tregun e përbashkët. ⁴⁵

Neni 308⁴⁶ i Traktatit themelues të Bashkimit Evropian lejon që Këshilli Evropian të marrë me unanimitet masat që i konsideron si efikase.

Kompetencat e Bashkimit Evropian (BE) janë marrë dhe merren përmes vullnetit të lirë të shteteve të tij përbërëse si anëtare me të drejta të plota. Referuar mënyrës së atribuimit, kompetencat e tij, mund të klasifikohen në disa kategori.

2.1.2 PERSONALITETI JURIDIK I BE-SË

Nga 1 Dhjetori 2009 personaliteti juridik i takon BE-së. Çështja e personalitetit juridik të Bashkimit Evropian⁴⁷ është ngritur në lidhje me marrëdhëniet ndërkombëtare, sidomos në lidhje me tagrin për të lidhur traktate apo për t'u bërë palë në marrëveshje apo konventa.

Bashkimi Evropian nuk ka kompetenca të institucionalizuara për bërjen e traktateve, domethënë nuk e ka cilësinë institucionale për të lidhur marrëveshje me vendet jo anëtare. Megjithatë, ai ndjek objektivat e veta në nivel ndërkombëtar, qoftë kjo përmes lidhjes së mar-

⁴³ Key Competences for Lifelong Learning - EUR-Lex - europa.eu/eur-lex.europa.eu › legal-content › TXT › PDF

⁴⁴ Zaganjori, Xh., Koncepti “E drejte Europiane”. Shkolla e Magjistraturës, Tiranë 2009

⁴⁵ External competence - European Parliament - europa.eu/www.europarl.europa.eu › RegData › etudes › note join

⁴⁶ EUR-Lex - 12002E308 - EN - EUR-Lex - europa.eu/eur-lex.europa.eu › legal-content › TXT › uri=CELEX:...

⁴⁷ Neni 47 i TBE. L'articolo 47 del trattato sull'Unione europea (TUE) riconosce esplicitamente la personalità giuridica dell'Unione europea rendendola un'entità indipendente.

rëveshjeve të Këshillit të Bashkimit Evropian apo përmes deklaramit të qëndrimeve të veta në arenën ndërkombëtare, sidomos në lidhje me PPJS-në.

Traktati i Lisbonës i njeh personalitetin juridik Bashkimit Evropian duke i njohur kështu të drejtën për të hyrë në marrëdhënie juridike me të tretët.⁴⁸

Për t'u bërë palë në organizata ndërkombëtare, për të qenë subjekt i së drejtës ndërkombëtare dhe i gjykatave ndërkombëtare.

Dhënia e personalitetit juridik bëhet në përputhje me kompetencat e BE-së duke përfshirë kompetencat e tij dhe, ose të shteteve anëtare për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare.

2.1.3 QYTETARIA E BASHKIMIT EVROPIAN

Nënshtetësia evropiane është krijuar me Traktatin e Bashkimit Evropian, i nënshkruar në Mاستriht në vitin 1992.⁴⁹ Qytetaria e BE-së është në varësi të shtetësisë së njërit nga shtetet përbërëse të saj. E thënë me fjalë të tjera, dhe korekt, kushdo që zotëron shtetësinë e një shteti anëtar, është dhe qytetar i Bashkimit Evropian⁵⁰. Qytetaria⁵¹ e BE-së është plotësoese apo komplementare e shtetësisë së njërit nga 27 shtetet anëtare. Kushdo shtetas që zotëron shtetësinë e një shteti anëtar, është në të njëjtën kohë dhe qytetar i Bashkimit Evropian."

Liri për të qarkulluar dhe për të banuar në Bashkimin Evropian; E drejtë për të votuar dhe për t'u zgjedhur në zgjedhjet vendore dhe në Parlamentin Evropian, në shtetin anëtar ku banon; Mbrojtje diplomatike dhe konsullore në një vend të tretë nga autoritetet e çdo shteti anëtar, kur shteti anëtar, shtetësinë e të cilit ai ka, nuk është i përfaqësuar nën 23 TBE⁵². E drejtë e

48 Zaganjori, Xh. (2004). Vendi i së Drejtës Nderkombetare në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Jeta Juridike, 2,

49 EU citizenship | European Commission ec.europa.eu > ... > EU citizenship

50 https://europa.eu/european-union/topics/eu-citizenship_it

51 Mehmetaj, J., - 2016 - uet.edu.al

52 Ish nën 20 i traktatit të KE-së

peticionit dhe ankimit tek Avokati i popullit European. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdamit (1999), statusi i nënshtetasit evropian jep edhe të drejtat e mëposhtme:

E drejtë për t'iu drejtuar institucioneve evropiane në njërën prej gjuhëve zyrtare dhe për ta marrë përgjigjen me shkrim në të njëjtën gjuhë; E drejtë për të njohur dokumentet e Parlamentit European, Këshillit European dhe Komisionit Evropian, në varësi të disa kushteve të caktuara⁵³. E drejtë për të mos u diskriminuar kundrejt shtetasve të tjerë të BE-së, në bazë të kombësisë⁵⁴ dhe për të mos u diskriminuar në bazë të gjinisë, racës, fesë, aftësive të kufizuara ose orientimit seksual;⁵⁵

Nocioni i Qytetarisë së Bashkimit Evropian nuk e zëvendëson shtetësinë e Shteteve Anëtare, por i shtohet asaj. Kjo i jep qytetarit të thjeshtë një ndjenjë më të thellë dhe më konkrete përkatësie në Bashkimin Evropian.

Traktati i Lisbonës sjell dy ndryshime themelore për qytetarinë evropiane: Iniciativa qytetare për të propozuar ligje dhe kompetenca të reja të BE-së mbi masat për mbrojtjen sociale, të lidhura këto me të drejtën e lëvizjes dhe lejeqëndrimin.

Ndryshimet e tjera janë simbolike dhe një nga këto është pikërisht përfshirja e termit qytetar në dispozitat e parimeve demokratike .⁵⁶

2.1.4 DETYRA TË BASHKIMIT EUROPIAN

Bashkimi European ka për detyrë të mbështetë në mbarë Bashkimin European⁵⁷: zhvillim harmonik të barazpeshuar dhe të qëndrueshëm të aktiviteteve ekonomike; si dhe barazi mes meshkujve dhe femrave; rritje e qëndrueshme jo inflacioniste;

⁵³ Neni 15 TFBE

⁵⁴ Neni 18 TFBE

⁵⁵ Meksi, E., - Gjeopolitika, 2008 - ceeol.com

⁵⁶ Titulli i II TBE

⁵⁷ The EU - what it is and what it does [op.europa.eu › webpub › com › eu-what-it-is](http://op.europa.eu/webpub/com/eu-what-it-is)

nivel të lartë konkurrueshmërie dhe konvergjencë të performancës ekonomike; nivel të lartë mbrojtjeje dhe përmirësim të cilësisë së mjedisit, rritjen e standardit dhe të cilësinë e jetës, kohezionin ekonomik dhe social, si dhe solidaritetin ndërmjet shteteve anëtare.

¹⁸¹ Bellamy, R., Weale, A., - Journal of European Public Policy, 2015 - Taylor & Francis

¹⁸² Mayring , P., - 2014 - ssoar.info

Ky vullnet politik duhet të jetë veçanërisht e rëndësishme si Konferenca Ndërqeveritare e v. 1996¹⁸³. Kjo varet shume nga rezultatet që do të dalin me zgjedhje të rëndësishme në disa Shtete Anëtare: Gjermani dhe Itali, zgjedhjet parlamentare janë në fakt planifikuar për vitin 2017. Rezultatet e Brexit ishin tronditëse dhe të papritura, zgjedhjet në shtetet e planifikuara anëtare ku po rritet fryma kundërshtuese e zhvillimit me tej të BE-së kjo edhe llogjikisht me zgjerimet e njëpasnjëshme të Bashkimit Evropian, problemeve të Euro-s dhe stabilitetit ekonomik si dhe problemet në rritje me politikën e jashtme e të sigurisë së BE-së. Në të gjitha rastet është i mirëqënë fakti për reformimin e një BE-je efikase dhe funksionale. Përveç në rastet e konsensusit midis forcave të brendshme politike në integrimin evropian, që duket të jetë rasti për shembull në Gjermani do ishte shume e mirepritur ngritja e këtij me mirekuptim dhe në vendet e tjera. Në vendet kandidatë Shqipëria vlen për tu cituar si me përqindje shumë të lartë në kërkesën e saj në anëtarësimin në BE.

Mungesa aktuale e vullnetit politik. Kjo mungesë e vullnetit politik manifestohet qartë nga dy arsye: E para është mungesa e projektit të përbashkët politik mes shteteve anëtare për të ardhmen e institucioneve të Bashkimit Evropian.

Shumëkush mund të dallojë në këtë drejtim në mënyrë skematike kryesore dy kategori të shteteve: një - anëtarët fillestare dhe Spanja – janë pak a shumë të favorshme për një zhvillim të integritit të komunitetit. Për vende të tjera, në radhë të parë në qoftë se nuk janë të interesuar vetëm në një treg ose përfitime financiare të komunitetit dhe të cilat për shkak të mungesës së një rënie në integrimin e tanishme do të ishte dëshira e tyre ideale për të stabilizuar institucionet aktuale që duket se ata mendojnë të jetë një e keqe më të vogël dhe që janë krejtësisht me qëndrime dyshuese ndaj ndonjë zhvillimit të metejshëm të integritit të BE-së. Ky copëtim vetëm mund të rritet me zgjerimet e ndryshme siç tregohet edhe nga ftoftësia e anëtarëve të rinj të BE-së.

¹⁸³ http://www.europarl.europa.eu/summits/tor1_en.htm

Këta anëtarë nuk janë pak a shumë të interesuar për zhvillimet institucionale të Bashkimit Europian, por shfaqen dukshëm veçanërisht të shqetësuar nga problemet institucionale.¹⁸⁴

Dikush mund të ngrejë pyetjen dhe të hamendesojë se si vendet e Evropës Qëndrore dhe Lindore që vijnë për të hyrë BE-e vërtetë do të jenë të gatshëm për humbje të konsiderueshme të sovranitetit të tyre.

Marrëveshja ndërmjet Shteteve Anëtare është më shumë dhe më e vështirë për tu arritur, si dhe të zhvillohet në ndërtimin e komunitetit dhe më të përparojë në rrugën e integritit dhe ku më shumë sulme ndaj sovranitetit janë ndjerë me të vërtetë.

Kjo është ajo që shpjegon paqartësitë e Traktatit të Bashkimit Europian që kombinon teknikat e integritit - aftësitë në zhvillim të komunitetit, bashkimit ekonomik dhe monetar, të zhvillimit institucional etj.

3.6.2 FORMAT E BASHKËPUNIMIT DHE REZULTATEVE NË DHE MIDIS TYRE

Format e teknikat e bashkëpunimit dhe rezultateve në dhe midis :

Këshillit Europian dhe politikës së jashtme, sigurisë, kooperimi janë në një brishtësi institucionale. Me rregullim institucional hedhja e një hapi cilësor do pasqyronte një kontradiktë themelore që karakterizon institucionet aktuale të Bashkimit Evropian dhe kushteve për evolucionin e tyre. Situata aktuale institucionale sot shfaq disa problematika. Më kryesore është kontradikta në mes të natyrës së brendshme të kompetencave të ushtruara dhe kuadrit institucional për llojin ndërkombëtar të ushtrimit të këtyre kompetencave.¹⁸⁵ Përveç aftësive për realizimin e tregut të përbashkët apo një treg të vetëm, kompetencat e Bashkimit rezultojnë kryesisht nga transfertat shtetërore të kompetencave dhe për këtë arsye janë të tipit të brendshëm. Sa për aftësitë e brendshme kështu që është se të dy fuqitë normative - ish-fuqitë

¹⁸⁴ Bache, I., Bulmer, S., George, S., Parker, O., Burns, C., - 2020 - books.google.com

¹⁸⁵ Canaj, E., Vasjari, A., - Mediterranean Journal of Social Sciences, 2013 - mcses.org

e brendshme legislative dhe rregullative aktualisht ushtrohet në formën e rregullave të Komunitetit - dhe kompetencat ekzekutive: politikat monetare ekonomike etj .

Këto transferta nuk janë të reja pasi ishin identifikuar që në fillim nga Gjykata e Drejtësisë dhe nga studiuesit serioze, por ato janë gjithnjë e më të rëndësishme, siç është paraqitur, pavarësisht parimit të subsidiaritetit¹⁸⁶.

Forma aktuale institucionale e BE-së, është e llojit ndërkombëtare, si më e përshtatshme për natyrën e kompetencave të ushtruara: nëse komunitetet europiane janë kryesisht të veçantë, ato megjithatë - ndryshe nga Bashkimi Evropian ende nuk e përfitojnë një personalitet ligjor ndërkombëtar. Organizata ndërkombëtare si i tillë do të mbetet e varur nga shtetet anëtare që janë mjeshtra si të sistemit institucional, përmes kontrollit të procesit të vendimmarrjes, dhe evoluimin e saj përmes procesit të rishikimit të traktateve përbërëse.

Pamjaftueshmëria e kornizës dhe formës institucionale zbulon si në efikasitetin e sistemit institucional dhe sistemin e demokracisë përfaqësuese.

Gjykata e Drejtësisë në parimn e autonomisë së të drejtës komunitare, parimin e ngritur nga disa gjykata të brendshme kushtetuese është e konsoliduar tashmë ligjërisht.¹⁸⁷

Mbetet politikisht si "deficit demokratik". Njohja ndërkombëtare ishte problem i panjohur në organizatat klasike ndërkombëtare dhe lindi vërtetë me Bashkimin Evropian, për shkak në rëndësinë e pushtetit të komunitetit normativ dhe e kompetencave të ushtruara.¹⁸⁸

3.6. 3 ZHVILLIME INSTITUCIONALE TË BE-së.

Zhvillimet dhe evolucioni institucional është e karakterizuar nga konflikti mes formës institucionale dhe forcën e shteteve anëtare.¹⁸⁹ Forma institucionale rritet në drejtim të federal-

186 Draetta, U., & Parisi, N., (Eds.). (2010). Elementi di diritto dell'Unione Europea. Parte speciale. Il diritto sostanziale. Giuffrè editore.

187 Sarmiento, D., - Common Market L. Rev., 2013 - HeinOnline

188 Bellamy, R., Weale, A., - Journal of European Public Policy, 2015 - Taylor & Francis

189 Bruff, I., - Rethinking Marxism, 2014 - Taylor & Francis

izimit në kuptimin e brendshëm të Bashkimit Evropian dhe jo ndërkombëtar i termit. Edhe pse kjo ndoshta nuk do të marrë formën e shtetit klasik federal,

Bashkimi Evropian është në prag të një hapi cilësor që do të thotë kalimi i Federalizmit Ndërkombëtar në një lloj të federalizmit të brendshëm e pershkruar në nivel institucional, kalimi i një qasje ndërkombëtare në një formë kushtetuese.

Si në fakt u tha nga Jacques Delors në fjalimin e lamtumirës Parlamentit Evropian, "zgjimi politik i Europës" domosdoshmërisht përfshin "thelimin e institucioneve demokratike", e cila mund të arrihet vetëm në sajë të një qasje federale në çështjet institucionale¹⁹⁰.

Duke pasur parasysh këtë formë institucionale është e natyrshme dhe gjen rezistencën e shteteve që mbeten xheloz për sovranitetin e tyre, edhe pse ajo do të jetë më formale se e vërtetë, veçanërisht në fushën monetare. Kush diskuton se nuk duhet lejuar braktisja e sovranitetit janë me të vërtetë në kushte të vështira pasi zemra e sovranitetit është përfshirë.

Kjo rezistencë e krijuar nga shtetet në realitet nuk ka gjasa të pengojë reformën institucionale. Diskutimi në mes të llogjikës institucionale dhe sovranitetit të shteteve anëtare të duket një situatë që do vazhdojë, në qoftë se balanca e pushtetit nuk do të ndihet i obliguar të evoluojnë me kalimin e kohës.

3.6.4 EFIKASITETI DHE DEMOKRATIZIMI I INSTITUCIONEVE

Përshtatja institucionale. Përshtatja me institucionet e Komunitetit të cilat, edhe pse nuk ka gjasa në rregullim të defektit, është i përfshirë në zbatimin e politikave ekonomike dhe monetare dhe zgjerimin e Bashkimit Evropian. Rrugët që mund të realizohet kjo janë dy, alternative apo kumulative. Reforma institucionale që premtion të jetë integrimi veçanërisht ngjan e vështirë dhe atë integritit të diferencuar e cila duket e mundshme.¹⁹¹

¹⁹⁰ http://www.geocities.ws/osservatore_europeo/futuribile/fi01it.htm

¹⁹¹ Muço, K., Much., V., - Review of Management & Economic ..., 2019 - search.ebscohost.com

Mungesa e një projekti të përbashkët institucional ndërmjet Shteteve Anëtare, reforma institucionale mund të arrihet vetëm nga metoda tradicionale e cila është ilustruar sidomos në Mاستriht, domethënë se kompromisi mund të marrë marrëveshjen e të gjitha shteteve, dhe kjo është natyrisht burim i paqartësive dhe kontradiktat ku Traktati i Bashkimit European është shembulli më i mirë. Kjo metodë e përfshirë në vetë procesin e shqyrtimit i jep rezultatet sipas rastit. Sfidat e reformës. Normalisht aq reale sa duhet të jetë riorganizimi institucional, reforma kërkon vetëm një kusht që kjo duhet të përparojnë vetëm nëse institucionet e BE-së janë në rrugën e efikasitetit dhe demokracisë.

Qëllimi i efikasitetit dhe performancës së institucioneve kryesore të Bashkimit European për realizimin dhe përmbajtjen në kryerjen e reformës, gjithashtu kjo has sot në vështirësinë e saj aktuale në performim efikasiteti.¹⁹²

Problemi themelor i Këshillit Evropian në këtë drejtim është ai i Presidencës së saj dhe rotacionin e saj çdo 6 muaj në mesin e shteteve anëtare.

Lufta në lindjen e mesme ka treguar kufijtë e presidencës së Bashkimit Evropian nga një shtet i vogël dhe rrotullimin e presidencës, e cila është tashmë e vështirë për të kuptuar në Bashkimin Evropian prej anëtarëve, dhe do të humbnin gjithë kuptimin në një Union të 30 shteteve, secili prej tyre do mbante presidencën në çdo 15 vjet.

Dy zgjidhje janë të mundshme në këtë pikë:

- a. Presidenca politike, me Presidentin e BE-së të zgjedhur për 4 vjet, mund ose nuk mund të kryesojë në të njëjtën kohë nga Komisioni Evropian, i cili për momentin duket e pamundur,
- b. apo presidencën kolektive ushtruar në vit nga 3 ose 4 shteteve.

Tre pyetje praktike të Këshillit të Bashkimit European jashtë presidencës është e ndarë me Këshillin Evropian. E para është zgjerimi i votimit me shumicë të cilësuar është e nevojshme për të zgjeruar Bashkimin European, për të lehtësuar vendimmarrjen duke shmangur pengesat dhe lehtësimin për kompromis.

¹⁹² Naqellari, A., Qurku, R., - Journal of Educational and Social Research, 2014 - mcser.or

Ky zgjerim është edhe më e mundshme që shumica e kualifikuar shoqërohet me "kodin e mirësjelljes" ndërmjet shteteve anëtare që të vendosin kryesisht me konsensus.

Çështja e dytë është pesha e votave në mënyrë që të mbajë një ekuilibër në mes të shteteve të mëdha dhe të vogla. Zgjerimi i Bashkimit mund në fakt të rrisë çekuilibër aktuale në favor të shteteve të vogla, pra, do të jete e patolerueshme. Zgjidhja e mundshme do të ishte futja e një shumicë të dyfishtë të shteteve dhe popujve të cilën Parlamenti Evropian është kundër si institucion që përfaqëson popujt e shteteve anëtare.

Çështja e tretë është ajo e funksionit të përgjithshëm koordinues.

Problemi thelbësor i Komisionit Evropian mbetet ajo e homogjenitetit për shkak të anëtarëve të saj në numër tepër të shumtë. Në pamundësi dhe mungesë për të kufizuar numrin e Komisionerëve që shfaqet rreptësisht e nevojshme dhe që do të ishte ideale, por kjo duket vështirë të rezultojë e realizueshme. Rritja e kompetencave të kryetarit të saj dhe një ristrukturim të brendshëm me komisionin, për shembull, krijimi i ndihmës komisionerëve, duket e domosdoshme. Në Parlamentin Evropian nuk është problemi numri i madh i anëtarëve: aktualisht përbëhet nga 751 anëtarë në një Bashkimin Evropian duke sjellë së bashku 27 shtete. Duket, pra, e domosdoshme për të vendosur një numër maksimal të vendeve¹⁹³.

E njëjta Çështja e anëtarësimit kërkohet nga Gjykata e Drejtësisë dhe Gjykata e Shkallës së Parë, por në terma krejt të ndryshme. Ndërsa një rritje e numrit të gjyqtarëve në të vërtetë do të jetë në gjendje të ndikojnë në mos pasje homogjeniteti dhe për këtë arsye ligji të jete në përputhje gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë, kjo nuk do të paraqesë të njëjtën gjë dhe shqetësim në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe vendimet e të cilit janë objekt i ankesës para Gjykatës së Lartë¹⁹⁴.

¹⁹³ https://europa.eu/european-union/about-eu/institutions-bodies/european-parliament_it

¹⁹⁴ http://www.europarl.europa.eu/atyourservice/it/displayFtu.html?ftuId=FTU_1.3.10.html

Për më tepër do të jetë pozitive në këtë gjykatë pasi kjo do të lejojë atë për të përmbushur numrin në rritje të ankesave drejtuar nga zhvillimi gradual të juridiksionit të Tribunalit me zgjerimin e Unionit.

Gjithashtu mund të jetë e parashikuar për të njëjtin qëllim krijimin e "gjykatave rajonale", emërimi i Ndhmës Relatorit, përdorimin e gjyqtarit të vetëm ose krijimin e dhomave të specializuara. Efiksiteti dhe Demokratizimi i institucioneve. Debati mbi demokratizimin e institucioneve të Komunitetit tradicionalisht varet nga dy elemente: fuqitë e Parlamentit Evropian dhe të drejtat themelore. Fuqia e parë e pjesëmarrjes të Parlamentit Evropian në vendimet e Komunitetit. Pushteti legjislativ i Kuvendit është zhvilluar në mënyrë progresive që nga fillimi i integritit evropian, por pa cënuar balancën institucionale dhënë fillimisht nga traktatet themelore të sipercituara. Që nga zgjedhja e tij me votim të përgjithshëm ajo dallon për një fuqi të vërtetë të bashkë-vendimit me Këshillin, shtrirë kjo në të gjitha fuqitë normative dhe buxhetore të Bashkimit Evropian.

Kompleksiteti ekstrem i procedurës së vendimit të përbashkët, si të vërtetë ka atë të procedurës së bashkëpunimit e cila i parapriu asaj, duke i dhënë Parlamentit pushtet të vërtetë për bashkë-vendim. Në qoftë se ne mundet në këtë drejtim të presë me një zgjatje të procedurës së vendimit të përbashkët, ajo ende duket e pamundur që Parlamenti të marr fuqinë e vërtetë të përgjithësuar të bashkë-vendimit, Shtetet Anëtare janë të ndarë në këtë pikë.

Dy çështje janë të lidhura ngushtë me pushtetin normativ të Parlamentit Evropian¹⁹⁵.

E para është ajo e hierarkisë së Komunitetit .

Kjo hierarki do të zëvendësojë sistemin aktual

bazuar në bazën ligjore të vendimit, burimi i mosmarrëveshjeve ndër-institucionale dhe procesit gjyqësor, një qetësues i sistemit, për shembull, dallimi në mes të normave "kushtetuese", apo primare, standardeve "ligjore" apo Parimeve dhe normave rregullatore të zbatimit të veprimeve.

¹⁹⁵ https://europa.eu/european-union/about-eu/institutions-bodies/council-eu_en

Çështja e dytë është thjeshtimi i procedurave vendimmarrëse që kanë komplikuar gradualisht për të arritur një shkallë të ngushtë të surrealizmit.¹⁹⁶

Fuqia e dytë ajo e rolit të pjesëmarrjes së Parlamentit Evropian në emërimin e Komisionit. Parlamenti mori në Mاستriht të drejtën të konsultohet për zgjedhjen e Presidentit dhe miratimin e Komisionit përpara marrjes së detyrës¹⁹⁷. Ai tani pretendon të drejtën për të zgjedhur Presidentin e Komisionit të propozuar nga Këshilli dhe të drejtën e shkarkimeve individuale të anëtarëve të tij. Shtetet janë sigurisht shumë të ndarë mbi këtë çështje.

Të drejtat themelore paraqesin problemin tradicional të dyfishtë të zhvillimit të një karte apo katalogu të të drejtave të BE-së dhe anëtarësimi tij apo komunitete të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Një dhe të tjera duket shumë e panevojshme aq të drejta sa më themelore janë plotësisht të mbrojtura nga Gjykata e Drejtësisë me anë të teknikës është edhe jane parimet e përgjithshme të ligjit fleksibël dhe efektiv.

Për më tepër, zhvillimi i një karte të drejtave themelore mund të ndodhin "në minimum", e cila do të ishte një hap mbrapa në krahasim me mbrojtjen e tanishme dhe aderimin në Konventën Evropiane, për të cilat Gjykata e Drejtësisë vetëm ka dhënë një mendim negativ, mund të çojë në çështje më shumë ligjore dhe teknike si mbrojtje shtesë

3.6.5 FORMA E INTEGRIMIT TË DIFERENCUAR

Të drejtat themelore megjithatë kanë një aspekt simbolike në raport me shtetësinë e Bashkimit Evropian dhe shuhen si një themel demokratik të kandidatëve për anëtarësim dhe mund të mbajë te kthjellët vëmendjen e negociatorëve.

a) - Vështirësia për reforma.

¹⁹⁶ Ramalingam, B., - 2013 - books.google.com

¹⁹⁷ <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/IT/TXT/?uri=URISERV%3Axy0026>

Vështirësia për Reformat institucionale varet nga procedurat e rishikimit të traktateve themeluese e Bashkimit Europian. Kjo procedure është e ndarë në tri faza .¹⁹⁸

Vetëm një shtet edhe sa do i vogel, mund të bllokojë rishikimin, rreziku në zhvillim nëse diskutohet dhe për kerkesat e vendeve për anëtarësim dhe zgjerimet e hërëpas`hershme.

Kjo është sigurisht një vështirësi që shpjegon metodën e përdorur për kompromis në rishikimin e traktateve dhe ndryshimet në minimum dhe në përputhje me rrethanat të cilat janë pengesa për reformën institucionale të momentit.

Ky ngre çështjen e rishikimit të një procedure per të mundësuar ndryshimin.

b) Integritime të diferencuara.

Integritimi diferencuar apo Bashkimi Europian me gjeometri të ndryshuesh e mbulon dy realitete krejt të ndryshme nga njëri-tjetri.

E para është shpejtësi evropiane që Profesor JL Quermone Bashkimin e përkufizon si "ndjekja e një qëllimi të përbashkët së bashku me një afat kohor të diferencuar" ndërmjet Shteteve Anëtare dhe për këtë arsye ka dy komponente¹⁹⁹:

a. të ndërtimit të përbashkët të gjitha shtetet dhe një pjesëmarrje me nivele të shteteve të reja anëtare, ose nga e vjetra në përparimin e ndërtimit evropian, si dhe mundësitë e tyre.

Se i njëjti autori se dyti e përkufizon si "kërkimi për një marrëveshje të përbashkët minimale objektive me politikat e përbashkëta të ofruara për zgjedhjen e lirë të shteteve që marrin pjesë në ushtrimin e plotë të sovranitetit të tyre" është krejtësisht e ndryshme²⁰⁰.

Ajo nuk është e bazuar në fakt më shumë në mundësitë objektive të pjesëmarrjes së shteteve anëtare, por të shënojë mungesën e marrëveshjes ndërmjet tyre në mbarim të integritimit evropian. Ky integritim i diferencuar, siç është përcaktuar, është parë shpesh si një mënyrë për

¹⁹⁸ Ruffert , M., - Common Market L. Rev., 2011 - HeinOnline

¹⁹⁹ L., Quermone, J. (2005). *Le système politique de l'Union européenne* (pp. 158-p). Montchrestien.

²⁰⁰ Po aty

të rruajtur themelet e integritit evropian duke siguruar dinamizmin e Bashkimit Evropian. Ajo ende ngre problemet e probabilitetit dhe pasojat e saj.

Mundësia e integritit të diferencuar

Integrimi i diferencuar duket edhe më shumë si pak e shmangshme tashmë ekzistonte dhe ajo do ekzistojë sërish. Integrimi i diferencuar është tashmë një realitet në të dy aspektet e tij.

Disa ilustrime të Bashkimit Evropian në disa shpejtësi të parë mund të përmendet: të gjitha traktatet e pranimit kanë përfshirë në radhë të parë masat kalimtare të dhëna për anëtarët e rinj, në mënyrë për t'i dhënë atyre kohë për t'u përshtatur me standardet e BE dhe përfshijnë e *acquis communautaire*; masat mbrojtëse që mund të ndihmojnë shtetet anëtare në rast krize të rëndë dhe supozimet e përcaktuara në Traktatin e BE-së në përjashtim të detyrimeve të tyre dhe të ofruara për të rivendosur rregullat komunitare me dorë sa më shpejt të tjera, mund të konsiderohet si një regjim përkohshëm të diferencuar; bashkimi ekonomik dhe monetar, që nuk mund të integrohen si vetëm shtetet që kanë respektuar kriteret e konvergencës së famshme, më në fund po ashtu përfshin një pjesëmarrje në faza të shteteve në kohë të ndryshme.

Ka edhe disa shembuj të hartës të BE-së:

-e para dhe aktualisht më e madhe dhe më serioze është politika sociale të përcaktuara në Traktatin e Protokollit mbi politikën sociale të BE-së, e cila është në një regjim të plotë përjashtimi në Britani të Madhe;

-e dyta përbëhet nga klauzolave të quajtur "zgjedhur nga" që përfitojnë të njëjtin Mbretërinë e Bashkuar dhe Danimarka dhe që i japin atyre mundësinë për të mos përfshirë në fazën e tretë të bashkimit ekonomik dhe monetar;

-i treti është sistemi Schengen me interes vetëm për shtetet anëtare të caktuara të Bashkimit Evropian dhe për këtë arsye mbetet ende jashtë zonës së BE-së.

Problemi nuk është se për ekzistimin e integritit të diferencuara ai është prezent por ajo e përgjithësimi të saj.²⁰¹ Forma e integritit të diferencuar është e pashmangshme.²⁰²

Përgjithësimi i integritit diferencuar duket e pashmangshme për të paktën dy arsye themelore: rëndësia e problemeve institucionale në BE për shkak të pamundësisë të reformës institucionale dhe vështirësive - dhe pamjaftueshmërise nga reforma e parashikueshme institucionale;

Zgjerimet e ardhshëm të Bashkimit Evropian, siç tregohet nga përvoja e zgjerimeve të mëparshme dhe të gjithë kandidatët për anëtarësim.

Pasojat nga forma e integritit të diferencuar. Këto pasoja janë të dyfishta, praktike dhe teorike.²⁰³ Pasojat praktike janë sigurisht pasojat institucionale të cilat nuk mund të arrijnë të kenë efikasitetin e integritit diferencuar. Ajo në fakt mund të vetëm të çojë në komplikim të mëtejshëm të sistemit institucional në të cilat ka kompozime dhe janë kushtet ku Këshilli dhe Parlamenti Evropian do të ushtrojnë kompetencat e tyre.²⁰⁴

Kompleksiteti dhe vështirësitë janë defekte aktuale të cilat duhet të trajtojnë në vend. Integrimi i diferencuar mund të japi pasoja të cilat shkojnë kundër objektivave të përshtatjes institucionale. E njëjta mënyrë të arsyeshme mund të shihet nëse ajo është institucionalisht e mundur në qoftë se përvoja ka treguar se është e mundur me një ose dy shtete në disa zona, puna e tij duket shumë më problematike në rast të një numri të gjerë shtete relativisht të mëdha në disa fusha të ndryshme

Pasojat teorike. Ndryshe nga shumë mendime Bashkimi Evropian nënkupton marrëveshjen e të gjitha shteteve anëtare në temën e integritit evropian, harta e Bashkimi Evropian duket krejtësisht në kundërshtim me nocionet e BE-së dhe komunitetit. Kjo është arsyeja pse ajo

²⁰¹ Metaj , K., - doktoratura.unitir.edu.a, Tiranë 2016

²⁰² De Witte , B., - Common Market Law Review, 2018 - kluwerlawonline.com

²⁰³ From capacity to sovereignty: Legislative politics and differentiated integration in the European Union Winzen . T., - European Journal of Political Research, 2016 - Wiley Online Library

²⁰⁴ The institutions of the European Union Hodson, D., Peterson, J., - 2017 - books.google.com

tani duket e refuzuar në shume mënyra.²⁰⁵ Kjo nuk do të thotë se në të kundërtën kjo nuk do të zbatohet. Qëllimi mund të duket pesimist i cili sugjeron se në aspektin e zhvillimit institucional të Bashkimit Evropian është e dëshirueshme dhe e mundshme janë të lidhura anasjelltas.²⁰⁶ Megjithatë ekziston një kontroll se e vërteta e parë që ligji institucional i Bashkimit Evropian, si ligji në përgjithësi është kryesisht një produkt social, si e tillë mund të pasqyrojnë vetëm shoqërinë që prodhon dhe ajo rregullon. Gjithashtu, çdo gjë që mendojnë se “krijuesit e sistemeve”, rezultatet e Konferencës Ndërqeveritare zbuluan nivelin e integritimit social

të arritur nga Bashkimi Evropian në fillim të shekullit XX.²⁰⁷ Llogjika institucionale mund vërtetë të përkulet për shkak të realiteteve sociale. Megjithatë në fund duhet të mbizotërojë deri në atë masë që përshtatja institucionale, çfarëdo forme e saj, duhet në lartësinë ku problemet apo sfidat e Bashkimit Evropian, gjatë shekullit XXI të tejkalohen²⁰⁸.

Forma e integritimit të diferencuar ishte e pashmangshme dhe kjo u promovua dhe nga Deklarata e Romës 2017.²⁰⁹

²⁰⁵ Gjuraj, T., Gurakuqi, R., Tarifa, F., Mato, E.,... - 2014 - uet.edu.al

²⁰⁶ Converging towards NAFTA: an analysis of FTA investment chapters in the European Union and the United States Fontanelli, F., Bianco - Stan., G., J. Int'l L., 2014 - HeinOnline

²⁰⁷ Intergovernmental conferences - Consilium.europa.eu www.consilium.europa.eu › documents-publications › i..

²⁰⁸ Kurpas, S., Crum, B., Schoutheete, P., Keller, J., Dehousse, F., Andoura, S., & Bribosia, H., (2007). The Treaty of Lisbon: implementing the institutional innovations. *Joint Study Ceps. EGMONT. EPC Study*.

²⁰⁹ The Rome Declaration - Consilium www.consilium.europa.eu › press-releases › 2017/03/25

KREU IV

INTEGRIMI NË BE

4.1 BASHKIMI EUROPIAN- KONCEPTE NGA POLITIKA E PËRBASHKËT E JASHTME DHE E KONSOLIDIMIT

Europa dëshiron para botës të prezantohet e bashkuar dhe të luajë rolin që i takon. Kjo është arritur në sektorin ekonomik.²¹⁰

Megjithatë, në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë, vendet anëtare të BE-së e kanë të vështirë të heqin dorë nga kompetencat dhe t'ia dorëzojnë ato Brukselit. Në këtë aspekt ministrat e jashtëm të vendeve anëtare të BE-së më tepër kanë dëshirë të jenë vetë në skenën politike. Në vitin 1970, zyrtarizohet Bashkëpunimi Politik midis vendeve të atëhershme evropian. Mirëpo, për një politikë të përbashkët as që mund të diskutohej. Nuk ka pasur synime të përbashkëta në fushën e politikës së jashtme evropiane dhe as instrumente për politikë të jashtme. Para së gjithash, mungonte një gjë: identiteti evropian.

"Nëse unë dua të flasë me Evropën atëherë kë duhet ta thërras" pati thënë atëbotë, me 1973, ish- sekretari amerikan Kissinger.

²¹⁰ The European Union: economics and policies AM El-Agraa - 2011 - books.google.com

Mirëkuptimi midis vendeve të BE-së në këtë fushë kërkohej të përmirësohej përmes bashkëpunimit.

Mekanizmat e ndryshme të krijuara ndër vite, që prekin politikën e jashtme të BE-së, janë vlerësuar si joefektive për përmbushjen e plotë të këtij kuadri.

Në Mاستriht, shefat e shteteve dhe qeverive të vendeve anëtare të BE-së në Samitin e Mاستrihtit, u morën vesh për një politikë të përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, por megjithatë kjo së pari mbeti në letër, pasi nuk u krijua ndonjë instrument për punë efektive në këtë sektor të rëndësishëm të jetës politike. Por, ishte paraparë që kjo të ndryshonte me themelimin e postit të Përfaqësuesit të lartë njëkohësisht dhe ënkryetari i Komisionit European përgjegjës për koordinimin e veprimit të jashtëm të Bashkimit Evropian .²¹¹

Bashkimi Evropian, një organizëm i veçantë në llojin e tij, nuk funksionon në nivel politik, sipas skemave klasike tashmë të njohura në nivel Konfederate apo Federate (si SHBA-të, Gjermania, Zvicra apo Rusia), në të cilat politika e jashtme është kompetencë ekskluzive federale dhe roli i shteteve (njësive) federative është i limituar. Ndonëse në një gamë të gjerë të fushave të ndryshme politike, vendet anëtare të BE-së, kanë një mekanizëm vendimmarrje të përbashkët, duke thjeshtëzuar në mënyrë të konsiderueshme ndërtimin e kompromisit, politika e jashtme nuk funksionon sipas këtij realiteti. Në fushën e politikës së jashtme, ku dominon koncepti i sovranitetit dhe i pavarësisë, përparësi marrin interesat historike dhe gjeopolitike të secilit prej kombeve . Situta evolutive e zhvillime botërore kërkon një përballje efektive të sfidave politike, kjo kërkon një mbështetje efektive nga të gjithë vendet anëtare, me mbështetje ndaj institucioneve të Brukselit që kanë më tepër një rol thjeshtëzues. Vizionet politike të vendeve anëtare janë të ndryshme, duke gjeneruar diferencime e mospërputhje. Dallime në shtetet pro në parim proevropian, janë më këmbëngulës mbi sovranitetin dhe pavarësinë në veprimet e saj diplomatike.²¹² Britania, pro-atlantiste dhe euroskeptike

²¹¹ High Representative/Vice President - European External ...eeas.europa.eu › headquarters › headquarters-homepage

²¹² The Fouchet Plan: De Gaulle's Intergovernmental Design for Europe Teasdale , A., - LEQS Paper, 2016 - papers.ssrn.com

është angazhuar me vështirësi në mekanizmat veprues të BE-së dhe po perparon aktualisht në procedurat shkeputjes nga BE-ja, pas referendumit në këtë vend.²¹³ Gjermania, ndryshe nga dy të parat, është duke projektuar konceptin federalist të BE-së, në të cilën synohet konfigurimi i një Evrope politike.²¹⁴ Konfigurimet e propozuara, ndonëse shfaqen si domosdoshmëri politike për fuqizimin e rolit diplomatik të BE-së, të ndikimit dhe besueshmërisë së saj, në skenën ndërkombëtare. Kjo varet gjerësisht nga konsensusi dhe gjetja e një vullneti politik të përbashkët që do të përcaktojë mundësitë reale drejt një Evrope federale. Për sa kohë kemi të bëjmë me një vullnet politik të munguar, zëri diplomatik i BE-së, është përfaqësuar nga përcjellja e interesave kombëtare, që do të dominonte mbi atë evropian. Kriza aktuale evropiane po riportretizon sërish të njëjtën skemë funksionimi.²¹⁵

4.2 ZHVILLIMI I POLITIKËS PËR KOORDINIMIN E VEPRIMIT TË JASHTËM TË BASHKIMIT EUROPIAN PAS TRAKTATIT TË MASTRIHTIT.

Intensiteti i zhvillimit të ngjarjeve dhe shpejtësia e ndryshimeve të cilat ndodhën në skenën ndërkombëtare në vitin 1989, gjegjësisht në fillim të viteve 90-ta të shekullit të kaluar sollën deri tek kthesat radikale në marrëdhëniet ndërkombëtare. Rënia e komunizmit në Evropën Lindore, ç'integrimi i Bashkimit Sovjetik, rënia e Paktit të Varshavës, Bashkimi i Gjermanisë dhe fundi i politikës së aparteidit në Afrikën Jugore, shënuan fillimin e një faze të re në marrëdhëniet ndërkombëtare.²¹⁶

“Lufta e Ftohtë kishte filluar në një kohë kur Amerika priste një periudhë paqeje dhe përfundoi në një moment kur Amerika po përgatitej për t'i bërë ballë një periudhe të re konflikti të zgjatur” (Henry Kissinger)²¹⁷.

²¹³ Britain and the Crisis of the European Union Baker, D., Schnapper, P., - 2015 - Springer

²¹⁴ German Europe Beck, U., - 2013 - books.google.com

²¹⁵ The New European community: decisionmaking and institutional change RO Keohane - 2018 - Routledge

²¹⁶ Cehuliq, L., Euroatlantizmi”, Kolegji Victory, Prishtinë, 2010, fq.129

²¹⁷ Kissinger, H., Diplomacia”, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1999. fq.762

Vendosja e një politike të jashtme dhe e një mbrojtje të përbashkët kthehet në një domosdoshmëri të pashmangshme.²¹⁸ Efektet e jashtëzakonshme të tregut të brendshëm dhe hapjes së KEE-së për shtetet e lindjes, gjë që u dukë qartë pas ndryshimeve të përmbyesjes së sistemeve politike në Evropë, krijuan një nevojë më të madhe në fillim të viteve 90-ta për struktura dhe procedura vendimarrëse frytdhënëse, për më shumë transparencë dhe për legjitimitet më të madh demokratiko- parlamentar.²¹⁹ Pas revizionit qenësor të Traktatit të Romës, që i ishte bërë me Aktin Unik Evropian, ky proces reformues jo vetëm juridik, por edhe i mbarë KEE-së, vazhdoi duke u kurorëzuar në fillim të viteve 90-ta në Konferencën Ndërqeveritare të Mاستrihtit.²²⁰ Traktati i Mاستrihtit shënoi periudhën e tretë reformuese. Me të ndryshohet karakteri i KEE-së në BE, pra nga një komunitet ekonomik në një union monetar me elemente edhe të një unioni politik në krijim. U kalua në një shkallë më të lartë integruese, pra në Bashkimin Ekonomik dhe Politik të Evropës. Me fjalë tjera, në këtë periudhë të zhvillimit të integritimit institucional evropian Tregu i Përbashkët Evropian u shndërrua në Tregun e Përbashkët Evropian, ku u krijua një union monetar dhe u vendosën bazat e bashkimit politik të Evropës. Post shtyllës së parë ekzistuese KEE-së, apo të ashtuquajturave.

"Tri Bashkësi Evropiane" (KEQC; KEE, Euroatom), Traktati i Mاستrihtit inauguroi edhe dy shtylla të tjera të Bashkimit Evropian:

- shtyllën e dytë, apo atë të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë;
- shtyllën e tretë, apo të punëve të brendshme dhe të drejtësisë.

Me politikë të përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, Bashkimi Evropian synonte kështu të pajisej edhe me identitetin e vet politik dhe të mbrojtjes, që i mungoi deri në fillim të viteve të 90-ta.²²¹ Në traktat përcaktohej se, përveç objektivave për ruajtjen e vlerave të përbashkëta,

218 Soin , R., *Evropa Politike*", Papirus, Tiranë, 2008, fq.127

219 Qendra Ndërkombëtare e Kulturës - Arbnori „Historia e Bashkimit Evropian", Tiranë, 2010. fq.17

220 Reka , B., & Sela, Y., *Hyrje në të Drejtën e Unionit Evropian- e drejta kushtetuese dhe e drejta institucionale e UE-së "*, 2011, Tetovë, fq.83.

221 Reka, B., & Ibrahimimi, A., *Studime Evropiane"* , Tetovë, 2004, fq.62

interesave dhe ruajtjes së paqes dhe sigurimit kombëtar, zhvillimit të demokracisë dhe shtetit të së drejtës, PPJS-së do të merrej dhe me forcimin e sigurimit të BE-së dhe të shteteve anëtare me të gjitha format²²². Këto objektiva do të realizoheshin nëpërmjet bashkëpunimit sistematik midis vendeve anëtare, për çështje të politikës së jashtme dhe të sigurisë si dhe nëpërmjet aksioneve të përbashkëta që do të realizoheshin në fushat ku shtetet anëtare kanë interesa të përbashkëta të rëndësishme.

Traktati e zgjeroi PPJS-në edhe në atë të mbrojtjes së përbashkët ²²³. Perspektiva e zgjerimit të BE-së me demokracitë e reja të Evropës Qendrore dhe Lindore duhej t'i vendoste një objektiv tjetër rishikimit të traktateve.²²⁴

4.2.1 TRAKTATI I MASTRICHTIT

Një ndër çështjet problematike të integrimit evropian tradicionalisht ishte ndërtimi i PPJS-së, si pjesë përbërëse e integrimit politik.

Traktati mbi BE-në (Mastrihtit) ishte një përparim në aspektet të asaj se PPJS u miratua dhe hapa konkrete drejt unionit politik u ndërmorrën.

Dy faktorë ishin vendimtarë në nxitjen e anëtarëve të BE-së për thellimin e integrimit në zhvillimin e politikës së jashtme: evoluimi i procesit eurointegruës dhe ndryshimet sistematike në rendin ndërkombëtar që nga viti 1989. Pengesë e rëndësishme në bashkëpunimin në fushën e politikës së jashtme ishte pikëpamja tradicionale ndaj politikës së jashtme, që konsiderohej si përgjegjësi kryesore e shteteve. Prandaj, shqetësimi i madh për vendet anëtare të BE-së, ishte se thellimi në këtë fushë do të ketë potencial për të ndikuar në kompetencat dhe sovranitetin e shteteve anëtare. Me fjalë tjera, çdo arritje në nivelin supranacional konform zhvillimit të politikës së jashtme, do të konsiderohet si humbje e kompetencave në nivel nacional. Kjo ishte pjesërisht arsyeja se pse integrimi në zhvillimin e politikës së jashtme ka

222 Xharo, K., - Polis, 2015 - ceeol.com

223 Canaj, E., & Bana, S., E Drejta e Bashkimit Evropian", Tiranë, 2011, fq.42

224 Paul Jacque, J., drejta Institucionale e Bashkimit Evropian", Botimet Papyrus, 2010, Tiranë, fq.15

qenë i dhimbshëm dhe mbeti kryekëput ndërqeveritar.²²⁵ Llogaritej së Evropa kishte dalë nga zona e turbulencës së kohës para Mاستrihtit, që karakterizohej si një periudhë me shumë paqartësi në historinë e integritit evropian. ²²⁶ Me Traktatin e Mاستrihtit Komuniteti Evropian qartë shkoi përtej objektivave origjinale ekonomike: krjimit të tregut unik dhe ambiciet e tija politike erdhën në ballë.

Në këtë kontekst, Traktati i Mاستrihtit u përshtatet pesë qëllimeve kryesore:

- forcimit të legjitimitetit demokratik të institucioneve;
- përmirësimin e funksionimit të institucioneve;
- vendosjen e unionit ekonomik dhe monetar;
- zhvillimin e dimensionit social të unionit;
- realizimin e Politikës së përbashkët e jashtme dhe e sigurisë (PPJS-së).²²⁷

Në titullin e këtij traktati dhe sidomos në pjesën e tij normative përcaktohej se termi “*Bashkësi Ekonomike Evropiane*”, do të zëvendësohej nga termi “*Bashkim Evropian*”. Ishin dy synime kryesore të hartuesve të Traktatit të Mاستrihtit, edhe atë: përmbyllja e procesit të integritit ekonomik evropian dhe vënia e bazave për një integrim politik evropian.²²⁸ Traktati i Mاستrihtit futi dy instrumente të rinj për implementimin e Politikës së përbashkët e jashtme dhe e sigurisë . Zhvillimin dhe konsolidimin e demokracisë dhe principit të sundimit të ligjit, si dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.²²⁹

225 A. Stivachtis , Y., *The States of European Integration* , Ashgate Publishing Ltd. Hampshire, UK, 2007, fq.3

226 Reka, B., & Ibrahimimi , A., *Studime Evropiane*", Tetovë, 2004, fq.185

227 http://europa.eu/legislation_summaries/institutional_affairs/treaties/treaties_maastricht_en.htm
(20.02.2015)

228 Reka , B., & Sela , Y., *Hyrje në të Drejtën e Unionit Evropian*", Tetovë, 2007, fq.89

229 Petrushevka , T., *Voved vo Pravoto na Evropska Unija*", Skopje, 2011 , fq.124

Traktati i Mاستrihtit themeloi një strukturë të rë institucionale e cila mbeti deri në hyrje në fuqi të Traktatit të Lisbonës. Struktura institucionale u kompozua në “tri shtylla”.²³⁰

Neni J 4.2. i Traktatit të Mاستrihtit përcaktonte: -Bashkimi kërkon nga BPE të përpunojë dhe implemtojë vendimet dhe veprimet të cilat kanë implikime në fushën e mbrojtjes. Traktati i Mاستrihtit për herë të parë vendosi një lidhje formale midis BE-së dhe BPE-së. Neni J 4.1. specifikonte se Politikës së përbashkët e jashtme dhe e sigurisë e BE-së duhet të përfshijë të gjitha çështjet lidhur me sigurinë e Bashkimit, përfshirë këtu inkuadrimin eventual të politikës së përbashkët të mbrojtjes, e cila me kohë mund të çojë në mbrojtjen e përbashkët. Me vendosjen e politikës së përbashkët të mbrojtjes dhe mbrojtjen e përbashkët brenda Politikës së përbashkët e jashtme dhe e sigurisë, traktati e bëri të qartë se Bashkimi i dimensioneve ekonomiko- tregtare dhe politiko diplomatike do duhej të kompletohej nga dimensionet e mbrojtjes, pra konform institucioneve të mbrojtjes.²³¹ . Së pari, Komisioni mund të propozojë veprime pranë shteteve anëtare. Kjo do të ndihmonte sigurimin e konsistencës së veprimeve të Komunitetit dhe shtyllës së Politikës së përbashkët e jashtme dhe e sigurisë.

Mirëpo, pjesa më e madhe e propozimeve akoma inicohej nga shtetet anëtare, duke ilustruar në një farë mase se Komisioni nuk është forca motorike e Politikës së përbashkët e jashtme dhe e sigurisë , krahasuar me rolin që e luante në shtyllën e parë. E dyta, dy procedura u shtuan: Këshilli mund të dakordohej për “*pozicionet e përbashkëta*” ose „*veprimet e përbashkëta*”. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë se pozicionet e tyre nacionale janë konform të dy formave të vendimeve. Së treti, shumica e kualifikuar e votave, u përfshi në procesin e vendimarrjes: Traktati i Mاستrihtit aprovoi për Politikës së përbashkët e jashtme dhe e sigurisë aktivitetet të financohen nga buxheti i Komunitetit.²³² Neni J.1. i Traktatit të Mاستrihtit promovonte se Politikës së përbashkët e jashtme dhe e sigurisë , përfshinte të gjitha fushat e

230 http://europa.eu/legislation_summaries/glossary/eu_pillars_en.htm (21.02.2015)

231 Edwards , G., & Pijpers, A.,*The Politics of European Treaty Reform*", London, 1997, fq.306

232 E.Smith , K.,*European Union Foreign Policy in Changing Eorld*" , Polity Press Ltd. Cambridge, UK, 2003, fq.37-38.

politikës së jashtme dhe të sigurisë, zhvillimin brenda për brenda BPE dhe nuk u ndal këtu .²³³

Takimi i ministrave të jashtëm dhe të mbrojtjes të aleancës në Berlin dhe Bruksel në qershor të vitit 1996, aprovoi kornizën politiko-ushtarake të konceptit të Task Forcës së përbashkët të komminuar .²³⁴

Kjo do t'i ofronte BPE-së sigurimin e aftësive, të cilat shtetet anëtare të BPE-së dhe BE-së nuk mund t'i siguronin vet, ndërsa ruajtja e vendimmarrjes, kontrollit politik mbi sigurinë dhe mbrojtjen evropiane .²³⁵

4.2.2 TRAKTATI I AMSTERDAMIT

Qëllimet e konferencës ndërqeveritare të BE-së, të mbajtur në vitin 1996, që i parapriu aprovimit të Traktatit të Amsterdimit, ishin më modeste në krahasim me ato të Mastrohtit. Synohej të çohet më përpara reforma e filluar e BE-së në Mastroht, por pa ndryshime radikale.²³⁶

Traktati i Amsterdimit u nënshkrua në vitin 1997, kurse hyri në fuqi më 1 maj të vitit 1999. Jo vetëm më pak ambicioz në synimet e hartuesve të tij, por edhe për nga struktura, Traktati i Amsterdimit duket se ishte më i thjeshtë se ai i Mastrohtit.²³⁷

Para së gjithash kapaciteti i Politikës së përbashkët e jashtme dhe e sigurisë për të vepruar u rihforcua përmes përgatitjes së më tepër instrumenteve koherente, si dhe vendimmarrjes sa më

233 Kolliker , A., Flexibility and European Unification-The logic of differentiated integration", Roëman&Little. field Publishers,inc.USA,2006, fq.233

234 <http://www.nato.int/docu/comm> (26.02.2015)

235 Moens A., & Cohen, L., & Sens , G., NATO and European Security-Alliance Politics from the end of the Cold War to the Age of Terrorism", Praeger Publishers, USA 2003 , fq. 70

236 Reka,, B., & Sela , Y., Hyrje në të drejtën e Unionit Evropian- e drejta kushtetuese dhe institucionale e UE-së", Tetovë, 2011, fq.87

237 Po aty

efikase. Traktati futi instrumentin e ri të politikës së jashtme ndaj atyre ekzistuese “*veprimet e përbashkëta*” dhe “*pozicionet e përbashkëta*”, të emërtuara si “*strategjitë e përbashkëta*”.

Këshilli Evropian, institucioni që përcakton parimet dhe udhëzimet e PPJS-së, tanimë ka të drejtën që të definojë, në bazë të konsensusit, strategjitë e përbashkëta në fushat ku shtetet anëtare kanë interesa të përbashkëta të rëndësishme.

Këshilli është përgjegjës për implementimin e strategjive të përbashkëta përmes aksioneve të përbashkëta dhe pozicioneve të përbashkëta, të miratuara me shumicë të kualifikuar.²³⁸

Kjo përfshirje i reflektohet integritetit territorial të Bashkimit. Si e tillë, ajo do të ju jepte fund absurditeteve të tilla si: tendencave të unionit që të lëshojë deklarata mbi ngjarjet e shumta rreth e përqarkë globit, por nga ana tjetër paaftësia për të reaguar kur integriteti territorial i një shteti anëtarë sfidohet.²³⁹ Struktura e “*shtyllave*” të Traktatit të Mastroitit nuk u ndryshua, por traktati demonstroi një ndërgjegjësime në rritje për nevojën e konsistencës në marrëdhëniet e jashtme. Neni C. u ndryshua dhe tanimë parashikonte detyra të reja të përbashkëta të Këshillit dhe Komisionit në bashkëpunim, për të siguruar qëndrueshmëri. Neni J. 4. theksonte se Këshilli mund të kërkojë nga Komisioni që të paraqesë propozime për PPJS-në, për të siguruar zbatimin e aksioneve të përbashkëta. Traktati sqaroi dallimin midis veprimeve të përbashkëta dhe pozicioneve të përbashkëta dhe futi një instrument të ri “*strategjitë e përbashkëta*”, pa e përkufizuar atë në mënyrë të qartë. Neni J.2. përcakton listën e instrumenteve të Politikës së përbashkët e jashtme dhe e sigurisë (PPJS-së).²⁴⁰

Ndryshimi më kualitativ i Traktatit të Amsterdimit ishte krijimi i funksionit të Përfaqësuesit të Lartë për Politikës së përbashkët e jashtme dhe e sigurisë, i cili njëherit ishte edhe Sekretar Gjeneral i Këshillit Evropian.

238 <http://europa.eu/legislation> (27.02.2015)

239 Koutrakos, P., *Trade, Foreign Policy and Defence in EU Constitutional Law*, Hart Publishing, Oxford, 2001, fq.26-27

240 Peterson, J., & H. Sjursen, *A Common Foreign Policy for Europe- Competing Visions of the CFSP*, Routledge, London, 1998 fq.71-72

Ky ndryshim ishte fundamental, për herë të parë PPJS do të mbështetej nga aktori permanent dhe gjithashtu do të kishte “*fytyre*”.²⁴¹

Kjo përfaqësonte përpjekjen e Unionit që të jetë më proaktiv në kushtet e politikës së jashtme, duke konsideruar llojet e opsioneve që do të jenë të disponueshme në skenare të ndryshme dhe për të shmangur dallimet e dëmshme gjatë krijimit të opinionit përgjatë situatave të krizave.²⁴²

Parlamenti Evropian vendosi i kontrollin mbi financimin.²⁴³

Një faktor i rëndësishëm kontekstual për tu cilësuar ngelet ajo për zhvillimin e bashkëpunimit aktiv franko-britanik në sferën e PPMS ishte kriza Kosovare.²⁴⁴ Deklarata e St.Malos inkurajonte për inkuadrim progresiv të politikës së përbashkët të mbrojtjes në mënyrë që të sigurojë Bashkimin me kapacitetet e aksionit autonom, për të mundësuar që BE-ja të luaj rolin e plotë në skenën ndërkombëtare dhe që të bëjë zërin e tij të ndëgjohet në punët botërore.²⁴⁵

Deklarata shihej si “*revolucionare*”, duke kthyer prapë mbrojtjen dhe sigurinë në rrjedha të politikës evropiane dhe për ngritjen e debatit të shëndosh mbi rolin e Politikës së përbashkët e jashtme dhe e sigurisë në arenën ndërkombëtare, duke bërë kështu që të ketë ndikim të rëndësishëm mbi ndryshimet që do të pasonin me Traktatin e Nicës, mbi dispozitat mbi mbrojtjen dhe sigurinë, si dhe kontributin në momentumin për të mbajtur politikën në qendër të procesit legal dhe politik që çoi në draft Traktatin Kushtetues dhe më vonë në Traktatin e Lisbonës.

241 Keukeleire , S., & MacNaughtan , J., *The Foreign Policy of the European Union* , Palgrave Macmillan, 2008 fq.54,

242 Lynch, P., & Neuwahl , N., & Ress , E., *Reforming the European Union from Maastricht to Amsterdam* , Pearson Education Ltd.2000 fq.175

243 Bindi , F., *The Foreign Policy of European Union-Assessing Europe's Role in the World* , Brookings Institution Press, Washington D.C. , 2010, fq.35.

244 Gross, E., & E.Juncos , A., *EU Conflict Prevention and Crisis Management* , Routledge, 2011, fq.59

245 Milzoë ,K., *National Interests and European Integration* , Palgrave Macmillan, 2012 fq. 135

Evoluimi i PPSM-së përbënte parakusht që Bashkimi të luaj rol të plotë në skenën ndërkombëtare.²⁴⁶

Këshilli Evropian i Këlnit (3-4 qershor 1999), lançoi “*Paktin e Stabilitetit për Evropën Jug-Lindore*” dhe miratoi “*Strategjinë e parë të Përbashkët*” ndaj Ruisë.

“*Pakti i Stabilitetit*” pasoi konfliktin në Kosovë dhe u konceptua si instrument i ri për të lehtësuar stabilizimin e rajonit, më së tepërmi në aspektin ekonomik.²⁴⁷

Principi bazik ishte se shtetet e rajonit duhet të bashkëpunojnë mes veti në pikëpamje ndaj integritetit të tyre në komunitetin euro-atlantik, si dhe anëtarësimin e mundshëm në të ardhmen, në BE. “*Strategjia e Përbashkët*” ndaj Ruisë ishte ambicioze në përmbajtje dhe qëllime, por më vonë u bë e qartë se është e vështirë implementimi i saj²⁴⁸.

Këshilli Evropian i Helsinkit (10-11 dhjetor 1999), miratoi dy progres-raportet e Presidencës mbi zhvillimin e kapaciteteve menaxhuese ushtarake dhe jo ushtarake të Bashkimit, si pjesë e forcuar e PPMS.²⁴⁹

4.2.3 TRAKTATI I NICËS

Traktati u nënshkruajt më 26 shkurt të vitit 2001, dhe ishte kulmi i njëmbëdhjetë muajsh negociatave që u zhvilluan gjatë një Konferencë Ndërqeveritare, që u hap në shkurt të vitit 2000. Hyri në fuqi më 1 shkurt 2003, pasi u ratifikua nga pesëmbëdhjetë shtete anëtare të BE-së.²⁵⁰

246 The handbook of international crisis communication research Schwarz, A., MW Seeger, C Auer - 2016 - Wiley Online Library

247 An alternative stability pact for the European Union Arestis, P., McCauley, K., Sawyer, K., - Cambridge Journal of ..., 2001 - academic.oup.com

248 Mahncke, W., & Ambos, A., & Reynolds Ch., “European Foreign Policy- from Rhetoric to Reality”, Presses Interuniversitaires Europeennes, Bruksel 2004, fq.142

249 <http://consilium.europa.eu/uedocs/cmsUpload/Helsinki%20European%20Council%20-%20Annex%20IV%20of%20the%20Presidency%20Conclusions.pdf> (05.03.2015)

250 http://europa.eu/legislation_summaries/institutional_affairs/treaties/nice_treaty/nice_treaty_introduction_en.htm (05.03.2015)

Nënshkrimi i Traktatit të Nicës shënon fundin e konferencës ndërqeveritare që filloi më 14 shkurt të vitit 2000.

Qëllimi i konferencës ishte adoptimi i mënyrës së funksionimit të institucioneve evropiane, me çka do t'i mundësohej BE-së që të pranojë shtete të reja anëtare. Traktati i ri e trasojë rrugën për zgjerimin e madh për të cilin në përgjithësi mendonte Unioni, në aspekt të arritjes së paqes së qëndrueshme, stabilitetit dhe prosperitetit për të gjitha vendet demokratike në Evropë. Ky traktat shënoi fazën e parapërgatitjes së zgjerimit të BE-së dhe aderimit të vendeve nga Evropa Qëndrore dhe Lindore, Mesdheu dhe Baltiku²⁵¹. Çështjet e PPJS-së nuk ishin shqetësim kryesor i Traktatit të Nicës. Megjithatë, u krijua mundësia për të kodifikuar dispozitat e inicuar në Konferencën e Këlnit 1999. Këto ishin kryesisht në fushën e PEMS. Risi e veçantë që përfshinte çështjet e PPJS dhe PEMS ishte krijimi i një strukture të rëndërqeveritare, pra Komitetit Politikë dhe të Sigurisë, i cili në mënyrë efektive do të zavendësojë Komitetin Politikë, i cili kishte operuar që nga ditët e para të BPE-së. Komiteti Politikë dhe i Sigurisë takohej dy herë në vit, në nivel drejtorësh politikë. Qëllimi i tyre ishte të monitorojë zhvillimin dhe implementimin e PPJS/PEMS.²⁵²

Në fushën e "*shtyllës së dytë*" dhe të "*tretë*" të BE-së, ndryshimet e bëra me Traktatin e Nicës nuk janë revolucionare, çka edhe nënkuptohet kur kemi parasysh bashkëpunimin ndërqeveritar të shteteve anëtare në fushën e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë (shtylla e dytë) dhe në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme (shtylla e tretë). Ndryshimet më të mëdha në shtyllën e dytë kanë të bëjnë me Politikën së përbashkët e jashtme dhe e sigurisë të BE-së.²⁵³

Këto dispozita rregullojnë politikën e përbashkët të mbrojtjes, e cila mund të dërgojë deri në mbrojtjen e përbashkët, gadishmerinë e të gjithë apo të një pjese të forcave ushtarake, nën një

251 Ibrahim, A., Politicki Institucii na Evropska Unija: Evropska Komisija", Logos-A, Skopje, 2003, fq.78

252 Bretherton, Ch., & Vogler, J., "The European Union as a Global Actor", second edition, Routledge, 2006, fq. 170-171.

²⁵³ High Representative/Vice President - European External ...eeas.europa.eu > headquarters > headquarters-homepage

komandë. Përmes ndryshimeve të këtyre dispozitave, politika e përbashkët e mbrojtjes, në pjesë të madhe është lëndë e bashkëpunimit të ngushtë të unionit me bashkimin euro-perëndimorë ²⁵⁴.

Në periudhën misid Amsterdimit dhe Nicës (1999-2003), qëndrimet politike të anëtareve të mëdhaja të BE-së në lidhje me këtë çështje u theksuan. Intervenimi i NATO-s në Kosovë, 1999 dhe bombardimi i ish-Jugosllavisë, si dhe epërsia e SHBA-ve, e cila në atë periudhë erdhi më tepër në shprehje, bëri që të miratohen vendime të rëndësishme mbi çështjen e mbrojtjes së përbashkët të anëtareve të BE-së ²⁵⁵.

Ndryshimi i radhës në shtyllën e dytë të BE-së, pas Nicës, ka të bëjë me fushën e politikës së përbashkët të jashtme të BE-së. Dispozitat e nenit 24. mbi marrëveshjet ndërkombëtare me vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare, parashikonte që Këshilli mundet të vendos për marrëveshjet e këtyra.

Këshilli deri atëherë vendoste në bazë të unanimitetit, ndërsa përmes Traktatit të Nicës u fut dallimi midis vendimarrjes unanime dhe asaj me shumicë të kualifikuar, kështu që vendimet që do të merreshin me unanimitet ose shumicë të kualifikuar do të mvareshin nga rëndësia e çështjes për të cilën duhej vendosur..²⁵⁶

4.2.4 POLITIKA E PERBASHKËT E JASHTME DHE E SIGURISË –

TRAKTATI I LISBONËS ²⁵⁷

Duke veprur si një aktor i vetëm i politikës së jashtme, BE-ja arriti të krijojë PPJS-në që ishte një ndër qëllimet kryesore të saja për shumë vite. Në kushtet e ekonomisë, ajo ka qenë në

²⁵⁴ Ilic-Gasmi , G., Reforme Evropke Unije-Institucionalni aspekti", Beograd, 2004, fq.269

²⁵⁵ Ilic-Gasmi , G., Reforme Evropke Unije-Instti", Beograd, 2004, fq.270itucionalni aspek

²⁵⁶ Po aty

²⁵⁷ Feedback , The Lisbon Treaty's provisions on CFSP/CSDP - European ...www.europarl.europa.eu › RegData › etudes › IDAN

gjendje që të vendos tregun unik përmes futjes së unionit ekonomik dhe monetar, si dhe përmes ratifikimit të monedhës së vetme e cila e ka ngritë Bashkimin në një ndër fuqitë ekonomike ndërkombëtare. Megjithatë, BE-ja ka qenë vazhdimisht objekt i kritikave që integrimi i saj ekonomik nuk mund të shoqërohet me një vullnet të përbashkët politikë që konsiderohet vendimtar, si një rezultat i pritjes për të parë Unionin duke rrëmbyer një rol sa ma efektiv në politikën globale. Rrjedhimisht, BE-ja ka ndjerë në mënyrë intensive thirrjen për të patur një identitet evropian si dhe një performancë të unifikuar në politikën ndërkombëtare.²⁵⁸

Siç kishte qenë rregull me zgjerimet e mëparshme, zgjerimit të vitit 2004, i paraprinë negociatat mbi përshtatjen e traktateve në mënyrë që së pari të forcohet BE-ja, para se vendet e reja anëtare t'i bashkohen klubit. Valët shokuese të shkaktuara nga 11 shtatori (2001), luftrat në Afganistan (2001) dhe Irak (2003), siguruan nxitje të mëtejshme për të forcuar projektin evropian në përgjithësi, si dhe kapacitetet e tij të politikës së jashtme²⁵⁹.

Si pasojë e kësaj droje ndër qytetarët evropian, pas tentimeve të pasuksesshme për ta shpëtuar nga vdekja kushtetutën e parë supranacionale evropiane, Këshilli Evropian, në qershor të vitit 2007, përfundimisht hoqi dorë nga ideja e kushtetutës europiane duke aprovuar mandatin për një traktat reformues të Bashkimit Evropian.²⁶⁰

Evropa nuk është i njëjti vend që ishte 50 vite më parë. Në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur, Evropa është duke u përballur më çështje të reja: globalizimin, ndërrimet demografike, ndryshimet klimatike, nevojën për burime të qëndrueshme të energjisë dhe kërcënimeve të reja të sigurisë.

Këto janë sfidat me të cilat përballet Evropa e shek.21. Vendet e BE-së nuk mund t'i përbushin ato vetëm, por duke vepruar si një, Evropa mund të japë rezultate dhe për t'iu

258 <http://lup.lub.lu.se/luur/doenload?func=doenloadFile&recordOid=1325521&fileOid=1325522>
(08.03.2015)

259 Keukeleire, S., & Mac Naughtan, J., *The Foreign Policy of the European Union*, Palgrave Macmillan, 2008, fq.61

260 Reka, B., & Sela, Y., *Hyrje në të Drejtën e Unionit Evropian- e drejta kushtetuese dhe institucionale e UE-së*, Tetovë, 2011, fq.171

përgjigjur shqetësimeve të publikut. Për këtë, Evropa ka mjete koherente, kështu ajo mund të funksionojë siç duhet dhe për t'iu përgjigjur ndryshimeve të shpejta në botë. Kjo d.t.th. përbrenda disa rregullave bazë për të punuar së bashku.

Traktati i Lisbonës (nënshkruar në Lisbonë, më 13 dhjetor të vitit 2007) përcakton se çfarë mund dhe nuk mund të bëjë BE-ja dhe çfarë mjatesh mund të përdorë ajo.

Ajo ndryshon strukturën e institucioneve të BE-së dhe se si ata punojnë.

Si rezultat, BE-ja është më demokratike dhe vlerat e saj themelore janë shërbyer më mirë. Ky traktat është rezultat i negociatave në mes të vendeve anëtare të BE-së në një konferencë ndërqeveritare në të cilën Komisioni dhe Parlamenti janë të përfshira gjithashtu. Traktati është ratifikuar nga secili prej vendeve anëtare të BE-së. Traktati i Lisbonës hyri në fuqi më 1 dhjetor, 2009²⁶¹. Traktati i Lisbonës është frymëzuar gjerësisht nga Traktati Kushtetues. Shumica e reformave institucionale dhe të politikave të parashikuara në Traktatin Kushtetues janë përfshirë në Traktatin e Lisbonës, por të paraqitura në një formë ndryshe.

Traktati i Lisbonës :

- reformon institucionet e BE-së dhe përmirëson procesin e vendimarrjes në BE;
- forcon dimensionin demokratik të BE-së;
- reformon politikat e brendshme të BE-së;
- forcon politikat e jashtme të BE-së.²⁶²

Ndryshimet më të rëndësishme konform Traktatit të Lisbonës janë:

- shfuqizimi i sistemit të “tri shtyllave” dhe bashkimi i tyre në një;

261 http://ec.europa.eu/archives/lisbon_treaty/take/index_en.htm (08.03.2015)

262 http://europa.eu/legislation_summaries/institutional_affairs/treaties/lisbon_treaty/ai0033_en.htm (09.03.2015)

- unioni fiton subjektivitet juridik (kjo nënkupton aftësinë për të hyrë në raporte kontraktore, posaçërisht për të qenë pjesë e konventave ndërkombëtare ose për të qenë pjesë e organizatave ndërkombëtare);
- funksioni i Presidentit të Këshillit Evropian;
- krijimi i pozicioni “Përfaqësues i Lartë i Bashkimit për politikën e jashtme dhe të sigurisë.”²⁶³

“*Tri shtyllat*” u prishën nëpërmjet Traktatit të Lisbonës, duke riuatuar Komunitetin Evropian në Bashkim Evropian. BE-ja merr kështu përsipër personalitetin juridik të KE-së. Në këtë mënyrë BE-ja si subjekt i së drejtës ndërkombëtare mund të nënshkruaj në emër të saj traktate dhe marrëveshje ndërkombëtare dhe nëpërmjet Shërbimit të Jashtëm Evropian, mund të lidhë marrëdhënie diplomatike me shtetet e tjera dhe të kërkojë anëtarësim në organizatat ndërkombëtare²⁶⁴.

Presidenti i Këshillit Evropian- një zë i fuqishëm dhe koherent i BE-së. Traktati i Lisbonës krijoi pozicionin e Presidentit të Këshillit Evropian që udhëheq me takimet e 28 shefave të shteteve apo qeverive anëtare.

Presidenti i Këshillit Evropian zgjidhet nga shtetet anëtare me mandat 2.5 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.²⁶⁵

Presidenti i Këshillit Evropian:

- kryeson dhe udhëheq me punën e Këshillit Evropian;
- siguron përgatitje dhe kontinuitet të punës së Këshillit Evropian, në bashkëpunim me Presidentin e Komisionit;
- kërkon të lehtësojë unitetin dhe konsensusin në kuadër të Këshillit Evropian;

²⁶³ <http://www.robert-schuman.eu/en/dossiers-pedagogiques/traite-lisbonne/fiche1.pdf> (10.03.2015)

²⁶⁴ Reka , B., & Holl , O., & Sela , Y., *Institucionet dhe Politikat e Unionit Evropian*", Tetovë, 2010 , fq.41

²⁶⁵ <http://fpc.state.gov/documents/organization/139287.pdf> (10.03.2015)

➤ paraqet raport deri tek Parlamenti Evropian pas cdo takimi të Këshillit Evropian.

Presidenti i Këshillit Evropian, në nivelin dhe kapacitetin e tij, garanton përfaqësimin e jashtëm të unionit në çështjet e PPJS-së, duke mos qenë në kundërshtim me kompetencat e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për politikë të jashtme dhe të sigurisë (neni 15.6.)²⁶⁶. Veprimi i BE-së në arenën ndërkombëtare udhëhiqet në bazë të postulateve, të cilat inspiron krijuarimin e saj, zhvillimin dhe zgjerimin. BE-ja ka për qëllim që t'i promovojë në të gjithë botën: demokracia, sundimi i ligjit, universaliteti dhe pandashmëria e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, respektimi i dinjitetit njerëzor, postulatet e barazisë dhe solidaritetit, si dhe respektimi i parimeve nga Karta e OKB-së dhe e drejta ndërkombëtare.

BE ka kërkuar zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare, si edhe ndërtimin e partneritetit me vendet e treta, me organizatat ndërkombëtare regjionale ose globale, të cilat i ndajnë postulatet e lartë përmendura (neni 21.1.). Këshilli Evropian përcakton interesat strategjike të unionit, specifikon qëllimet dhe i formulon drejtimitet e përgjithshme të PPJS.

Këshilli dhe Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit garantojnë respektimin e këtyre rregullave (neni 24.3).²⁶⁷ Shtetet anëtare pjesëmarrëse në organizata dhe konferenca ndërkombëtare (ku nuk marrin pjesë të gjitha shtetet anëtare), i informojnë shtetet tjera anëtare dhe Përfaqësuesin e Lartë të BE-së, ²⁶⁸për secilën çështje të interesit të përbashkët.

Shtetet anëtare të cilat janë anëtare të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, i përputhin veprimet e tyre dhe tërësisht i informojnë vendet jo anëtare dhe Përfaqësuesin e Lartë, dhe gjatë kryerjes së funksioneve të tyre në Këshillin e Sigurimit i mbrojnë qëndrimet dhe interesat e unionit (nenet 32-33-34).²⁶⁹

266 "Dogovor od Lisabon"- konsolidirana verzija, Konrad Adenauer Stiftung- R.Makedonija,2011, fq.45

267 "Dogovor od Lisabon"- konsolidirana verzija, Konrad Adenauer Stiftung- R.Makedonija,2011, fq.46

²⁶⁸

High Representative/Vice President - European External ...eeas.europa.eu › headquarters › headquarters-home-page

269 "Dogovor od Lisabon"- konsolidirana verzija, Konrad Adenauer Stiftung- R.Makedonija,2011, fq.47

Traktati i Lisbonës ndau Këshillin për Çështje të Përgjithshme dhe Marrëdhënie me Jashtë duke krijuar Këshillin për Çështje të Përgjithshme dhe Këshillin për Punë të Jashtme.²⁷⁰

Nëse njëri shtet anëtar është pjesë e ndonjë agresioni në territorin e saj, vendet tjera anëtare janë të obliguara që t'i garantojnë ndihmë dhe përkrahje me të gjitha mjetet që i kanë në dispozicion, në përputhje me nenin 51 të Kartës së OKB-së (neni 42 T.Lisbonës)²⁷¹.

Një risi e rëndësishme konsiston në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, e cila bëhet ligjërishit e detyrueshme nga Traktati i Lisbonës (neni 6, paragrafi 1). Karta ishte miratuar dhe ishte shpallur solemnisht në vitin 2000 nga Këshilli Evropian i Nicës, por mbeti fillimisht pa detyrim ligjor. Përmbajtja e saj orientohet te Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut²⁷². Karta përmban të drejtat dhe liritë, në gjashtë tituj: dinjiteti, liritë, barazia, solidariteti, të drejtat e qytetarit dhe drejtësia.²⁷³

Traktati i Lisbonës parashikon një mekanizëm për tërheqje vullnetare dhe të njëanshme nga Bashkimit Evropian (neni 50). Një shtet anëtar që dëshiron të tërhiqet njofton synimin e saj në Këshillin Evropian, i cili siguron udhëzimet për përfundimin e një marrëveshjeje që përcakton masat për tërheqjen e saj. Çdo shtet i cili është tërhequr nga BE-ja mund të aplikojë për tu ribashkuar duke kaluar nëpër procedurën e pranimit edhe një herë.²⁷⁴

4.2.5 NËNKRYEATARI I KOMISIONIT EUROPIAN ,PËRFAQËSUESI I LARTË PËRGJEGJËS PËR KOORDINIMIN TË VEPRIMIT TË JASHTËM TË BE-SË .²⁷⁵

²⁷⁰ High Representative/Vice President - European External ...eeas.europa.eu › headquarters › headquarters-homepage

²⁷¹ "Dogovor od Lisabon"- konsolidirana verzija, Konrad Adenauer Stiftung- R.Makedonija,2011, fq.63

²⁷² Reka,B., & Sela , Y., Institucionet dhe Politikat e Unionit Evropian", Tetovë, 2010 , fq.43

²⁷³ http://ec.europa.eu/justice/fundamental-rights/charter/index_en.htm (10.03.2015)

²⁷⁴ http://europa.eu/legislation_summaries/glossary/ëithdraëal_clause_en.htm (10.03.)2015

²⁷⁵ High Representative/Vice President - European External ...eeas.europa.eu › headquarters › headquarters-homepage

Roli i Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për politikë të jashtme dhe të sigurisë u krijua nga Traktati i Amsterdami (1999).²⁷⁶ Një dekadë më vonë, Traktati i Lisbonës e zgjeroi rolin e Përfaqësuesit të Lartë duke i shtuar përgjegjësi të reja të rëndësishme. I quajtur nga kjo pikë e më tej, “ Nënkyetari i Komisionit përgjegjës për koordinimin e veprimit të jashtëm të Bashkimit Evropian”,²⁷⁷ ky post gjithashtu u zgjerua duke përfshirë edhe rolin e nënkryetarit të Komisionit Evropian. Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit është i ngarkuar me koordinimin dhe realizimin e politikës së jashtme dhe të sigurisë së BE-së, e njohur si PPJS dhe PPMS. Roli i Përfaqësuesit të Lartë të BE-së është i gjerë . Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit emërohet nga ana e Këshillit Evropian (në të cilën marrin pjesë udhëheqësit e vendeve dhe të qeverive të shteteve anëtare), përmes procesit të votimit me shumicë të kualifikuar të votave, me mandat pesë vjeçar.²⁷⁸ Si dhe paraqet qëndrimin e Bashkimit në kuadër të organizatave dhe konferencave ndërkombëtare.²⁷⁹ Gjatë ushtrimit të funksionit, Përfaqësuesi i Lartë i BE-së fiton përkrahje nga Shërbimi i Jashtëm Evropian,²⁸⁰shërbim ky që bashkëpunon me shërbimet diplomatike të vendeve anëtare dhe përbëhet nga zyrtarë të sektorëve kompetent të Sekretariatit Gjeneral të Këshillit dhe Komisionit, si dhe nga personeli që përcaktohet nga shërbimet diplomatike nacionale të vendeve anëtare²⁸¹. Përfaqësuesi i Lartë i BE-së rregullisht konsultohet me Parlamentin Evropian për aspektet kryesore dhe vendimet themelore nga fusha e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sig-

276 Reka , B., & Holl, O., & Sela , Y., "Institucionet dhe Politikat e Unionit Evropian", Tetovë, 2010, fq.27

277 European Commission | Choose your language | Choisir une ...ec.europa.eu

278 http://www.eeas.europa.eu/high-representative-about/index_en.htm (11.03.2015)

279 EU High Representative Aggestam, L., Hedling , E., - European security, 2020 - Taylor & Francis

280 High Representative/Vice President - European External ...eeas.europa.eu › headquarters › headquarters-homepage

281 „Dogovor od Lisabon- konsolidirana verzija" , Konrad Adenauer Stiftung ,R.Macedonia, 2011, fq.55

urisë, si dhe jep informacion se si këto politika zhvillohen. Ai garanton se qëndrimet e Parlamentit Evropian në mënyrë të përshtatshme do të merren parasysh.²⁸²

Sot BE-ja është një nga aktorët më të rëndësishëm dhe më të gjerë politik në sistemin ndërkombëtar.²⁸³

Edhe pse roli i këtyre aktorëve joshitetorë është rritur ndjeshëm, koncepti i fuqisë globale vazhdon të jetë i lidhur ndaj shtetit-komb i cili ka fuqi të mjaftueshme, zakonisht atë të forcës ushtarake, për të kontrolluar sjelljen e shteteve tjera në arenën ndërkombëtare.

BE-ja është entitet unik, shpesh i referuar si "*sui generis*" dhe është sigurisht akter ndërkombëtar. Sidoqoftë, duke patur parasysh ndryshimet e shpejta në agjendën ndërkombëtare bëhet diskutabile nëse BE-ja është apo mund të jetë fuqi globale në të ardhmen e afërt.

Që të jetë fuqi globale është e domosdoshme që të dominojë në fusha të ndryshme përfshirë këtu atë politike, ushtarake, ekonomike dhe sociale, për të tërhequr, transformuar dhe të frenojë aktorët e tjerë ndërkombëtarë.

Arsyetimi parimor mbi këtë perceptim qëndron lidhur me strukturën institucionale të BE-së, veçanërisht niveli i pamjaftueshëm i integritetit, posaçërisht në lidhje me mungesën e koherencës në politikën e jashtme, pra që shtetet anëtare të flasin me një zë në arenën globale,²⁸⁴ dhe përpjekjet për një qëndrim të përbashkët në Kombet e Bashkuara.²⁸⁵

4.3 ANËTARESIMI NË BE - VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

Vend kandidat nënkuptohet, ai vend të cilit BE-ja i ka përcaktuar situatën e tij të anëtarësimit, kjo si një status i veçantë që e vendos një vend të caktuar në situatë integrimi e kon-

282 Po aty, neni 38

283 Meunier, S., & McNamara, K., Making history, European Integration and Institutional Change at Fifty- The state of European Union", vol.8, Oxford University Press, 2007, fq.267

284 Boening, A., & Frederik Kremer, J., & van Loon, A., Global Power Europe- theoretical and institutional approaches to the EU's external relations- Vol.1", Springer-Verlag Berlin, Heidelberg, 2013, fq.3

285 Buonanno, L., & Nugent, N., Politikat dhe Proceset e Politikave të Bashkimit Evropian", Universum Press, 2013, Prishtinë, fq.339

vergjencë për fillimin e bisedimeve që duhet të shpien drejt një anëtarësimi të plotë drejt BE-së. Shqipëria ka aplikuar për marrjen e këtij statusi.²⁸⁶

Vendimi për marrjen e statusit të vendit kandidat merret nga Këshilli mbi bazën e mendimit paraprak të dhënë nga Komisioni Europian. Kriteret përkatëse u elaboruan në Këshillin Europian të Kopenhagenit në 1993, kukriteret bazë që duhet të përmbushin vendet që synojnë anëtarësimin në BE-së janë:²⁸⁷

- institucione efikase dhe të qëndrueshme që garantojnë demokracinë;
- shtetin e së drejtës;
- respektimin e të drejtave të njeriut dhe minoriteteve;
- ekonomi funksionale tregu;
- si edhe adoptimi i *acquis communautaire*(legjislacionit të BE-së).

Në nenin 70-të MSA-së parashikohet që Shqipëria duhet të përafrojë gradualisht legjislacionin e saj me atë të Komunitetit Evropian duke nisur nga momenti që kjo marrëveshje është nënshkruar nga palët.²⁸⁸ Ky është një proces i gjatë, i vështirë dhe i kushtueshëm, pasi kërkon angazhimin maksimal të kapaciteteve njerëzore të administratës shqiptare, bashkëpunim te nivelit cilesor me ekspertë të fushave përkatëse, si edhe ngritjen e strukturrave të reja shtetërore. Sipas legjislacionit dhe qëndrimit të mbajtur nga BE-ja dy janë statuset për vendet që kanë aplikuar në BE. Vende kandidatë dhe potencial shtete kandidatë të cilat janë:²⁸⁹

Shtetet kandidatë: Shqipëria, Republika e Maqedonisë së Veriut, Serbia, Mali i Zi dhe Turqia.²⁹⁰

286 Grabbe, H., - Common, J., Mkt. Stud., 2014 - HeinOnline

287 EUROPEAN COUNCIL IN COPENHAGEN 21-22 JUNE 1993 ...www.consilium.europa.eu > cms_Data > docs > pressDataPDF

288 Albania - EUR-Lex-lex.europa.eu > legal-content > TXT > PDFPDF

289 Candidate Countries - European Commission - europa.eu > environment > enlarg > candidates

290 Candidate Countries - European Commission - europa.eu > environment > enlarg > candidates

Potencial shtete kandidate: Bosnia - Herzegovina; Kosova (nën rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (UN Security 1244/99)).²⁹¹

4.3.1 *POLITIKAT E AFRIMIT*

Çdo vit Komisioni European miraton një dokument i quajtur i strategjisë vjetore për të shpjeguar politikën e tij mbi zgjerimin e BE-së, si dhe raportet e përparimit mbi zhvillimet politike dhe ekonomike në vendet kandidate dhe në vendet kandidate potenciale.

Raporti së fundi do të sigurojë një vlerësim:

Sa vendet kandidate kanë implementuar legjislacionin e Bashkimit Evropian?!

Sa vendet potencialisht kandidate kanë adoptuar standardet e BE-së dhe sa janë plotësuar kushte të tjera specifike të BE-së të rena dakort ndërmjet paleve?

Ndër të tjera raportet e progresit do të përfshijnë të dhëna të rëndësishme statistikore për vendet kandidate dhe potencialisht kandidate.²⁹²

Statistikat është një nga fushat që vlerësohet nga Komisioni. Në varësi të rrethanave vendeve kandidate mund t'u kërkohej të vendosin një proces reformash në mënyrë që ta harmonizojnë legjislacionin e tyre me Acquis Communautaire.²⁹³

Statusi i Vendit Kandidat jepet nga Këshilli European mbi bazën e një mendimi nga Komisioni European i cili hartohet pas marrjes së një kërkesë për anëtarësim të paraqitur nga vendi në fjalë.

Megjithatë Statusi i Vendit Kandidat nuk jep automatikisht të drejtën për t'u anëtarësuar në BE. Komisioni e shqyrton me kujdes kërkesën në dritën e kriterëve të anëtarësimit (kriteret e Kopenhagenit), ndërsa procesi i anëtarësimit nis me vendimin e Këshillit European për të çelur bisedimet e anëtarësimit. Para aderimit ndihmë financiare.

²⁹¹ Candidate and potential candidate countries - europa.eu.ec.europa.eu › documents › KS-30-10-627-EN.PDF

²⁹² Progress Report on the Action Plan on Economic ... - Open Datadata.consilium.europa.eu › ST-9042-2019-INIT › pdf

²⁹³ 52002DC0700 - SL - EUR-Lex - EUR-Lex eur-lex.europa.eu › legal-content › TXT

Proçesi i anëtarësimit mbështetet në Strategjinë e Paraanëtarësimit e cila parashikon instrumente të tilla si ndihma financiare.²⁹⁴ Anëtarësimi varet nga përparimi i arritur nga vendi kandidat i cili matet rregullisht dhe ndiqet nga Komisioni. BE-ja ofron ndihmë financiare për këto vende për të ndihmuar në procesin e bashkimit.

Këtë asistencë të para anëtarësimit që është financiar dhe është kanalizuar përmes një instrumenti të ri për para anëtarësit i quajtur programi (IPA).²⁹⁵

4.3.2 PROCESI I STABILIZIM - ASOCIIMIT²⁹⁶

Ky proces synon vendet aspirante për në BE të jenë në statusin e vendit kandidat.²⁹⁷

Politika e Bashkimit Europian ,ka synuar qartë strategjinë e tij në drejtim të vendeve të Ballkanit Perëndimor . Strategjia ka qenë e pastër dhe natyrale drejt “bashkimit” të kontinentit. BE-ja në vendet e Ballkanit ka gjetur një pritshmëri të lartë nga politika rajonale por dhe qytetarët e këtyre shteteve ku dallim bën Shqipëria me një kërkesë shumë të lartë për anëtarësim . Be-ja nëpërmjet Proçesit të Stabilizimit dhe Asociimit i nisur së pari në Samitin e Zagrebit në nëntor 2000, ka konkretizuar këtë strategji.²⁹⁸

Vendet e Ballkanit të përfshira në këtë proces të MSA-së janë Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova sipas përkufizimit që jep rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së.²⁹⁹ Ky proces synon të

²⁹⁴ Instrument for Pre-accession Assistance (IPA II) - European ...ec.europa.eu › info › sites › info › files › eu_budget

²⁹⁵ Albania - financial assistance under IPA II | European ...ec.europa.eu › ... › Funding by Country

²⁹⁶ Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit - Dapdap.gov.al › images › DokumentaStrategjik › Marreveshj

²⁹⁷ Stabilisation and Association Process - European Commissionec.europa.eu › ... › Glossary

²⁹⁸ Stabilisation and Association Process - Europa.baeuropa.ba › ...

²⁹⁹ The Western Balkans - European Parliament - europa.euwww.europarl.europa.eu › ftu › pdf › FTU_5.5.2.pdf

sigurojë paqe dhe stabilitet në rajon duke ofruar mbështetje për fuqizimin e demokracisë dhe të shtetit ligjor dhe zhvillimin e një ekonomie tregu. MSA-ja ka synim të zhvillimi i bashkëpunimit rajonal, ekonomik, social, politik për shembull përmes një zone të tregtisë së lirë dhe përmes dialogut politik, si dhe përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së si dhe rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të administratave të këtyre shteteve.³⁰⁰ BE-ja po hedh hapa konsolidues në qëllimin e marrdhenieve rajonale, ku efektet janë të dukshme, këto shtete tani janë drejtuar nga e arrdhmja dhe kanë lënë mbrapa periudhën e konfliktualitetit, Be-ja po ndikon reforma të qënishme në këtë drejtim dhe me politikë dhe praktikat e saj të brendshme, vendet e Ballkanit do të njohin ecurinë e këtij anëtarësimi.

Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Serbia janë shtete kandidate të mundshme për t'u anëtarësuar në BE. Samiti i Selanikut i dha një shtysë më të madhe procesit të Stabilizimit dhe Asociimit në vitin 2003, duke përfutur elementet e procesit të anëtarësimit.³⁰¹

Samiti u mbështetet në: Marrëdhëniet kontraktore përmes Marrëveshjeve të Stabilizim-Asociimit (MSA), dhe gjeti lidhje me këtë, vlerësimi i kërkesës për anëtarësim i paraqitur prej vendeve kandidate, do të mbështetet në rezultatet e pranuar si dhe me zbatimin e dispozitave nga ana e tyre sidomos të atyre që kanë të bëjnë me fusha si; Marrëdhëniet tregtare në nivel rajonal të kësaj hapësire të Ballkanit, dhe me Bashkimi Europian, ku ky u ofron preferenca tregtare këtyre vendeve;³⁰²

Një mekanizëm përkrahës financiar u krijua si Instrumenti i Asistencës të Paraanëtarësimit (IPA) për periudhën 2007-2013 (që mundësoi kalimin nga programi CARDS për periudhën 2000-2006).³⁰³

³⁰⁰ Cannes European Council (6/95): Annexes to Conclusions www.europarl.europa.eu/summits/can2_en

³⁰¹ Eu-Western Balkans Summit Thessaloniki, 21 June 2003 europa.eu/rapid/press-release_PRES-03-163_en

³⁰² The Thessaloniki Summit: a milestone in the European ... ec.europa.eu/commission/presscorner/detail

³⁰³ Historiku - Integrimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin ... integrimi-ne-be.puneteshtete.gov.al

BE-ja përkrah ende, vendet e Ballkanit Perëndimor që kanë statusin e vendit kandidat nga disa aspekte të Procesit të Stabilizim dhe Asociimit.³⁰⁴

4.4 SHQIPERIA DHE RRUGA PËR ANËTARËSIM NË BASHKIMIN EUROPIAN

Shqipëria prezantoi aplikimin e saj për anëtarësim në Bashkimin Evropian me 28 Prill 2009. Me 16 nëntor 2009 Këshilli i Bashkimit Evropian i kërkoi Komisionit të paraqesë opinionin e tij mbi këtë kërkesë, në përputhje me procedurën e parashikuar përkatëse³⁰⁵.

Marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë kanë filluar me vendosjen e sistemit shumë partiak të Qershorit 1991. Në vitin 1992 një marrëveshje Tregtisë dhe Bashkëpunimit mes BE dhe Shqipërisë hyri në fuqi. Vendi u bë i pranueshëm për financim në kuadrin e programit asistencës financiare të BE –së në dhjetor 1991.

Bashkëpunimi ekonomik është rritur në vitin 1999 kur Shqipëria filloi të përfitojë nga Preferencat e Tregtisë Autonome nga BE.³⁰⁶

Që nga viti 2000 prodhimet dhe ekonomia shqiptare kanë përfituar asistencë dhe shuma financiare të mëdha nga BE. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë u nënshkrua në qershor 2006 dhe hyri në fuqi në prill 2009.

Ajo ka zëvendësuar Marrëveshjen e Përkohshme mbi Tregtinë dhe aspektet e lidhura me tregtinë, e cila pati hyri në fuqi në dhjetor 2006. Takimet dhe dialogut politik në nivel ministror mes BE-së dhe Shqipërisë janë mbajtur rregullisht që nga viti 2001.

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit shënon një fazë cilësisht të re në marrëdhëniet dypalëshe që sjell detyrime të rëndësishme të reja dhe angazhimin për vendin në fushat e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, lëvizjes së lirë të punëtorëve, të drejtës së vendosjes

³⁰⁴ Historiku - Integrimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin ...integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al > ..

³⁰⁵ në nenin 49 të Traktatit të Bashkimit Evropian

³⁰⁶ Marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe BE-së - Shërbimi i Veprimit ...eeas.europa.eu > delegations > albania

dhe të lëvizjes së lirë të kapitalit, shërbimeve si edhe në transport, në fushën audiovizuale e të telekomunikacionit.³⁰⁷ Për më tepër Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit parashikon bashkëpunim të ngushtë mes BE-së dhe Shqipërisë në një numër të gjerë të politikave të BE - se. Nje bashkëpunim i hollesishem do të përqëndrohet kryesisht në përparësitë që lidhen me acquis të BE-së në fushat përkatëse me Shqipërinë dhe për kryerjen që gradualisht të njehsojë acquis të BE- në legjislacionin e saj dhe për të bashkëpunuar me BE-në në objektivat e politikës së përbashkët.

Shqipëria po zbaton detyrimet e saj sipas Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit që nga fillimi i Marrëveshjes së Ndërmjetme.

Shqipëria ka kontribuar në funksionimin e shëndoshë të institucioneve të ndryshme të përbashkët. Komiteti i Përbashkët i themeluar në bazë të Marrëveshjes së Përkohshme u takuan në 2006, 2007 dhe 2008, dhe Palët që lidhen e tij të punës u takuan në 2007, 2008 dhe 2009. Mbledhjet e Këshillit të Stabilizim Asociimit u zhvillua në maj 2009 dhe maj 2010.

Mbledhja e parë e Stabilizim-Asociimit u mbajt në mars 2010. Në nëkomitet, takimet janë mbajtur në vitin 2009 dhe 2010 dhe vitet në vijim. Këto vlerësime i pohon dhe progres raporti i fundit i Komisionit European.³⁰⁸

Shqipëria merr pjesë në dialogun shumëpalësh ekonomik, ndërmjet Komisionit European dhe vendet kandidate potenciale , me kontekstin e mbikqyrjes së para-pranimit. Që nga viti 2006 ai përgatit një Program vjetor Ekonomik dhe Fiskal (EFP), e cila synon përgatitjen e vendeve kandidate potenciale për pjesëmarrje të mbikqyrjes shumëpalëshe ekonomike dhe koordinim të politikës procedurat aktualisht në fuqi në BE si pjesë e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar . Partneritet të parë European me Shqipërinë u miratua nga Këshilli në vitin 2004. Në shkurt të vitit 2008 Këshilli miratoi një partneritet të ri european me Shqipërinë.

³⁰⁷ Marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe BE-së - Shërbimi i Veprimit ...eeas.europa.eu › delegations › albania

³⁰⁸ Projektplan i kombëtar për integrimin evropian 2020 – 2022 punetejashtme.gov.al › [pkie_shqip_24.12.2019.doc](#)

Në kuadrin e dialogut për liberalizimin e vizave Shqipëria ka bërë progres të rëndësishëm në fusha të ndryshme të udhërrëfyesit. Prandaj, Komisioni paraqiti një propozim për heqjen e detyrimit të vizave për qytetarët e Shqipërisë më 27 maj 2010 e cila ishte subjekt i përm-bushjes së kritereve të pazgjdhura³⁰⁹.

Një marrëveshje mbi ripranimin mes Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë është në fuqi që nga viti 2006. Shqipëria u bë anëtare e plotë e Komunitetit të Energjisë të Evropës Juglindore .³¹⁰

Traktati synon krijimin e një tregu të integruar rajonal të energjisë për energji elektrike dhe gaz natyror si pjesë e shumicës së BE-se. Në shumë drejtime të strategjive sektoriale tani përfshijnë plane të veprimit konkrete në realizimin e aktiviteteve konkrete në secilin sektor brenda periudhës përkatëse. Shqipëria ka plotësuar kënaqshëm agendën e saj të MSA-së.

Shqipëria tashmë është një vend kandidat për në Bashkimin Evropian.³¹¹

4.4.1 SHKËMBIMI EKONOMIK SHQIPËRI-BE

Bashkimi Evropian është deri tani partneri më i rëndësishëm tregtar i Shqipërisë.

Në vitin 2009 p.sh me BE-ne llogariten të jetë kryer rreth 80% të vëllimit total të tregtisë së jashtme për Shqipërinë. Eksportet e Shqipërisë në BE arritën në rreth 86% të eksporteve totale të vendit në 2009, duke qenë i një vlerë prej 600,000,000 €. Eksportet kryesore të Shqipërisë janë metalet dhe mineralet, tekstile dhe këpucë, produkte bujqësore të përpunuara dhe pije si dhe ato të materialeve të ndërtimit. Në vitin 2009, 73,1% të totalit të importeve të Shqipërisë erdhi nga BE-ja³¹². Eksportet e BE-së në Shqipëri përfshijnë malora nën regjimin

³⁰⁹ Propozimi u miratua nga Parlamenti Evropian më 7 tetor dhe nga Këshilli më 8 nëntor 2010 dhe tashmë është në fuqi.

³¹⁰ shqipëria dhe procesi i negociatave me bashkimin evropian www.eupolicyhub.eu › Activities

³¹¹ Albania - Consilium.europa.eu www.consilium.europa.eu › policies › enlargement › al...

³¹² Muco, K., *L'analisi del modello di sviluppo albanese nel periodo post-comunismo: il cambiamento economico e la specializzazione*. Diss. Università degli Studi dell'Insubria, 2015. p.97-98

e përpunimit aktiv si tekstile dhe këpucë, prodhimet metalike, mobilje dhe mallrave elektronike të cilat janë gati tërësisht ri eksportim për Shtetet Anëtare të BE-se. Mallra të tjera të importuara të një rëndësie të BE-së janë makineri dhe pajisje, energji elektrike, farmaceutike si dhe ato të duhanit dhe të cigareve. Defiçiti tregtar i Shqipërisë me BE-në arriti në 1.571 € milion në vitin 2009.

Shqipëria u bashkua me OBT-në vitin 2000 dhe ka qenë një anëtar i CEFTA-s që nga viti 2007³¹³.

Këto rritme të bashkëpunimit tregëtar janë rritur dhe gjatë vitit të fundit dhe ku aktualisht ekonomia Shqiptare ka dimensionuar rolin e saj të lidhur ngushtë me atë të vendeve të BE-së.

4.4.2 PËRFITIMI I SHQIPËRISË NGA ASISTENCA TEKNIKE DHE FINANCIARE E BE- së.

Shqipëria përfiton nga asistencë financiare e BE-së që nga viti 1991. Në përgjithësi që nga 1999 dhe deri 2010 BE-ja ka realizuar projekte me vlerë mbi 565.700.000 € në Shqipëri.

Nga viti 1999 deri 2006 Shqipëria përfitoi ndihmën e BE-CARDS me vlerë 259.600.000 €. Që nga viti 2007, CARDS ka qenë zëvendësuar me Instrumentin e programit të Para-Aderimit (IPA), sipas të cilës Shqipëria ka marrë një asistencë me vlerë 306.100.000 € nga viti 2007 në 2010.³¹⁴ Programi CARDS në Shqipëri ka mbështetur stabilizimin demokratik, qeverisjen e mirë dhe ndërtimit të institucioneve, kapacitetet e administratës dhe të drejtësisë dhe të punëve të brendshme, zhvillimi ekonomik dhe social, mjedisit si dhe pjesëmarrjen e Shqipërisë në Programet Komunitare.

³¹³ European Commission - MEMO/14/439, EU candidate status for Albania, Bruxelles 24/06/2014

³¹⁴ Il programma CARDS è svolto a fornire assistenza comunitaria ai paesi dell'Europa sudorientale in vista della loro partecipazione al processo di stabilizzazione e di associazione con l'Unione Europea. Regolamento (CE) n. 2666/2000 del Consiglio, del 5 dicembre 2000, relativo all'assistenza all'Albania, alla Bosnia-Erzegovina, alla Croazia, alla Repubblica federale di Jugoslavia e all'ex Repubblica iugoslava di Macedonia e recante abrogazione del regolamento (CE) n. 1628/96 e modifica dei regolamenti (CEE) n. 3906/89, (CEE) n. 1360/90 e delle decisioni 97/256/CE e 1999/311/CE

Në 2007-2010 programet IPA janë të përqendruar në fushat kryesore politike, kritere të tilla si, policia reforma gjyqësore dhe infrastruktura e burgjeve, shërbimin civil dhe reformën e administratës publike, parlamenti, të drejtat themelore, si dhe te shoqërisë civile.

Në fushën e kritereve ekonomike dhe kriteret e anëtarësimit në BE, IPA përqëndrohet në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, edukimin, tatimet, statistika, të drejtat e pronësisë intelektuale, infrastrukturës mjedisore, transporti (lokale / rurale rrugë), punësimin dhe përfshirjen sociale dhe sigurine ushqimore .

Shqipëria merr pjesë në tri programe bashkëpunimi ndërkufitar në "kufijtë e brendshëm" në Ballkanin Perëndimor (Mali i Zi, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosova, në një bashkëpunim bilateral program ndërkufitar me një Shtet Anëtar të BE-së (Greqi), dhe në disa programe multilaterale (duke përfshirë Shtetet Anëtare të BE-së).³¹⁵

4.4.3 STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM E SHQIPËRISË (SKZHI)

Ne funksion të realizimit sa më të shpejtë dhe të koordinuar si dhe për të angazhuar të gjitha burimet e saj në mënyrë efektive ka miratuar një strategji.³¹⁶

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim e Shqipërisë 2007-2013 ku në të cilën ndërthuren axhendat më kryesore të Qeverisë Shqiptare të integritit. Për herë të parë harmonizohen në një dokument të vetëm strategjik axhenda për zhvillim ekonomik e social të qëndrueshëm me axhendën e integritit në Bashkimin Europian dhe në strukturat e NATO-s, si dhe me atë të realizimit të Objektivave të Mijëvjeçarit.

Aktualisht është realizuar konsultimi i strategjisë kombëtare për zhvillimit dhe integrim për vitet 2015-2020.

³¹⁵ Projektplani kombëtar për integrimin evropian 2020 – 2022 [punetejashtme.gov.al > pkie_shqip_24.12.2019.doc](http://punetejashtme.gov.al/pkie_shqip_24.12.2019.doc)

³¹⁶ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim - Dapdap.gov.al > dokumenta-strategjikT

SKZHI kristalizon qartë vizionin afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit të vendit bazuar kjo në një proces të hapur e transparent që garanton përfshirjen e gjerë të shoqërisë civile, komuniteteve vendore, komunitetit të biznesit, grupeve të tjera të interesit, strukturave akademike e shkencore të vendit, spektrit politik shqiptar, etj. SKZHI është një dokument praktik i rëndësishëm i vendit tonë në rrugën e arritjes së kritereve për anëtarësim në Bashkimin European. Përmbajtja e Progres Raportit të fundit të Komisionit European dhe agenda për tu plotësuar nga Shqipëria.³¹⁷

Njohja e realitetit faktik dhe dimesinomi i veprimtarise shtetërore në nivel studimor për administratorët e tij në formim por dhe më gjerë vjen e përshkruar në hapësirë të rëndësishme.

Progres raporti është dokumenti i vetëm periodik i dalë nga Komisioni European në bazë të vëzhgimeve të qarta të teknikinëve që bën publike dhe duhet të realizohet nga vendet kandidate dhe potenciale kandidate për anëtarësim në BE. Reporti analitik merr parasysh konkluzionet e Këshillit European në Copenhagen 1993 dhe konkluzionet e Këshillit European të mëvonshëm.

Raporti përshkruan marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe BE-së; Analizat e situatës në lidhje me kushtet politike të vendosura nga Këshilli i Evropës (demokracia, sundimi i ligjit, të drejtave të njeriut, mbrojtja e minoriteteve), vlerëson situatën e vendit dhe perspektivat në lidhje me kushtet ekonomike të vendosura nga Këshilli i Evropës (ekonomia funksionale e tregut, aftësinë për të përballuar presionin konkurrues), trajton çështjen e kapaciteteve të vendit për të miratuar detyrimet e anëtarësimit, dmth ato të legjislacionit të BE-siç shprehet në Traktat, legjislacionin dytësor, si dhe politikat e Bashkimit (acquis të Bashkimit European); Opinionet me disa përshtatje duke pasqyruar elementet e përfshirë "konsensusin e rinovuar për zgjerimin e '2006. Komisioni ka organizuar një numër të misionëve të ekspertëve në Shqipëri dhe ky mendim është përgatitur pas një metodologji të njehsuar. Opinioni pritet së afërmi të shprehet

³¹⁷ Projektplan i kombëtar për integrimin evropian 2020 – 2022 [punetejashtme.gov.al › pkie_shqip_24.12.2019.doc](http://punetejashtme.gov.al/pkie_shqip_24.12.2019.doc)

mbi progres raportin e vitit të fundit mbi negociatat për anëtarësim dhe kjo do i çonte raportet Shqipëri - BE në një fazë të re të avancuar.³¹⁸

4.5 ADMINISTRATA PUBLIKE NË SHQIPËRI

4.5.1 PRITSHMËRITË DHE MOTIVIMI PËR NË BE I ADMINISTRATËS PUBLIKE SHQIPTARE

Faktorët social, psikologjik dhe politik që ndikojnë dhe formësojnë opinoinin publik në tërësi mbi anëtarësimin në Bashkimin Europian. Roli kryesor i administratës publike në vend, si objekt shqyrtimi i këtij kërkimi shkencor. Administrata menaxhon aktivetin e jetës shoqërore dhe e kryen këtë rol nën mbikqyrjen e publikut. Studimi i këtyre dy qasjeve në rastin Shqipëria mundëson të japi nëpërmjet njohjes ndikim konkret në efikasitetin e administratës publike për mirëqeverisje.

Ben Rosamond e përkufizon integrimin europian si një “proces pa mbarim, i thellë, i gjerë, i bashkëpunimit politik, ekonomik dhe i sigurisë ndërmjet kombeve, me synimin kryesor ruajtjen e paqes”³¹⁹.

Veriu i Evropës është quajtur Europë nga grekët në shekullin e shtatë Para Krishtit, duke i dhënë emrin e vajzës së mbretit fenikas të sjellë në Kretë nga rrëmbyesi i saj Zeusi.

Në raportin e BE-së për Shqipërinë theksohet: “Rritja e ndërgjegjësimit

³¹⁸ Key findings of the 2020 Report on Albania - European ...ec.europa.eu › presscorner › detail › country_20_1794

³¹⁹ Rosamond, B., (2000) Theories of European Integration. Basingstoke, 121: Macmillan.

Vizionet janë të mundura e të realizueshme, në mos menjëherë në mënyrë graduale kur ato ngrihen e mbështeten mbi realitetin e prekshëm të kombinuar me një vullnet politik të qartë.³²⁰

Po të shikojmë rezultatet e anketimit në vite arrijmë në përfundimin se po rritet numri i shqiptarëve që mendojnë se integrimi nuk varet nga Brukseli, por nga reformat e brendshme³²¹.

Thirrja e brendshme, bindja e brendshme, mbështetja në faktorët e brendshëm, si më kryesoret na krijojnë mundësinë të hyjmë në kontakt me energjitë e thella që na mbështesin e që na udhëheqin dhe të mos e ndjejmë si më parë frikën, lodhjen, por të arrijmë më shpejt atje, ku i kemi vënë vetes qëllimet dhe objektivat tona. Ndërgjegjësimi i qytetarëve për domosdoshmërinë e integritit sa më shpejt të vendit tonë në BE-e.³²²

Qasja e individit është faktor i rëndësishëm i motivacionit të tij.³²³

Procesi i integritit europian është proces i motivuar i shqiptarëve për të qenë në familjen europiane.

E lidhur kjo me dëshirën e afirmimit të shqiptarëve si komb i barabartë me kombet e Europës, me dëshirën e fortë për zgjidhjen e problemeve ekonomike, me mënyrën që i ka zgjidhur edhe Europa, me dëshirën për të përqaftuar të renë në teknologji, në mënyrën e jetesës e të tjerë.³²⁴

Publiku sot në Shqipëri ka një pritshmëri të madhe për zhvillimin e vendit me tapa të njejtë si vendet anëtare të BE-së si dhe standarte të aplikuara si ato të përcaktuara nga institucionet e BE-së. Parë ajo nga rëndësia e madhe që ka administrata publike e një vendi në qeverisjen e mirë dhe arritjen e performancës së kërkuar at'herë pritshmëria e publikut është shumë e

³²⁰ Migration, citizenship, and the European welfare state: a European dilemma Schierup, CU., Hansen, P., Castles, S., - 2006 - Oxford University Press on Demand

³²¹ Anketimi i zhvilluar nga S., Demaliaj, umsh, Tiranë , 2016.

³²² The inner path of leadership, Jaworski , J., - 2011 - books.google.com

³²³ Human resources motivation—An important factor in the development of business performance Elena , NI., - Annals of the University of Oradea, Economic ..., 2012 - researchgate.net

³²⁴ Çili, H., Papa, E., - uet.edu.al, Tiranë 2007

lartë. Si opinioni publik dhe faktorët që ndikojnë drejtpërdrejt në efikasitetin e administratës janë angazhuar në një stad imperativ.

Kjo vjen kryesisht prej dy faktorëve , së pari presioni në rritje i opinionit publik vendas dhe së dyti angazhimeve të mara nga shteti shqiptar, ndaj Bashkimit Europian dhe instrumentave matës të këtij të fundit me një platformë të qartë kriteresh , afatesh dhe përmbushjesh. Vendi jonë nuk i ka kursyer resurset shpesh herë të kufizuara të tij, për një administratë publike me parime të qarta në menaxhim me synim një rritje të cilësi së mirëqeverisjes, efikasitetit së mirëqeverisjes dhe funksionimit të shtetit të së drejtës.

Në sajë të punës nga administrata publike dhe arritje mund të konstatohen.

Këto arritje janë të një fokusi gjithpërfshirës, si nga kurikulat shkollore për shkollën europiane të së drejtës publike, funksionimit praktik të administratës së BE-së dhe përgatituri opinionin publik me sfidat integruese dhe sfidat që prezanton koha nga globalizmi, integriteti artificiale, klima e faktorë të tjerë social - ekonomikë dhe politikë që sjell konteksti nga BE-ja , rruga për anëtarësim dhe nga vetë anëtarësimi.

Administrata shqiptare ka një legjislacion efikas në tërësi, institucione të përafuara si të BE-së dhe mekanizëm të njëjtë në sfond praktikash si të BE-së. Problematikat e administratës publike në shqipëri përveç faktorëve të njëjtë si në vendet e tjera të Ballkanit ka edhe faktorë me tipik origjinalitete vendase .

Përafrimi i praktikave sjell në një arrdhme jo të largët dhe unifikimin e njëjtë të shërbimeve dhe garancive ligjore për qytetarë shqiptarë, njëjtë si qytetarët e Bashkimit Europian.

Ky është dhe qëllimi kryesor i realizimit të këtij punimi kërkimor shkencor, gjetja dhe realizimi praktikave me ndjeshmëri të lartë të individit me fokus në të drejtë private e ndikuar dhe rregulluar në të drejtën publike me realizimin dhe efikasitetin e administratës publike.

Raste konkrete janë parë dhe do të shtjellohen në vijim të këtij kërkimi dhe po përmendim, elemente të së drejtës civile, si bashkëpronësia dhe rregullimin ligjor të saj, njëjtë si në

shqipëri dhe vendet anëtare të BE-së. Pronësia intelektuale³²⁵ dhe industriale është në fokus dhe shfaq një interes të kërkuesit njëjtë si në rastin e sipërcituar. Po ashtu, një interes shkencor paraqet evidentimi dhe njohja e ecurisë së Kodit Civil European,³²⁶ hapat që ndiqen, procedurat përkatëse ngritja e grupeve të kërkimit në këtë proces si dhe pritshmëritë përkatëse dhe efektet që sjell kodi.

Njohja e mirë e praktikave vendase , mundëson një punë kërkimore me rezultate të qenësishme në shoqërinë shqiptare. Berja publike e këtyre gjetjeve do të bënte të mundur, jo vetëm obligimet, e detyruara nga administrata publike ndaj jo vetëm rezidentëve në Shqipëri, por dhe ka një efekt mbi bashkëkombasit tanë me shtetësi të BE-së dhe vlen të përmendet se konstatohet një popullsi e konsiderueshme me shtetësi dhe të BE-së.³²⁷

Nëse gjetjet do të çmohen dhe vlerësohen si të qenësishme do ishte koha për realizimin e tij si një projekt me rëndësi kombëtare.

4.5.2 STRATEGJI TË REJA KOMUNIKIMI PËR INTEGRIMIN NË BE

Problemi i strategjisë, i metodave dhe i teknikave të komunikimit me publikun dhe me negociatorët europianë – është çelësi i suksesit për përsheptimin e integritimit.³²⁸

Ne si popull i një vendi që aspiron të bashkohet me familjen e madhe europiane dhe që ka hyrë në procesin e integritimit kemi nevojë që “ta zbulojmë” BE-në, historinë e këtij organizmi, thelbin, politikat e integritimit gradual e të gjithanshëm, përfitimet dhe detyrimet e të qenit

³²⁵ Intellectual property rights - European Commission - [europa.eu](http://europa.eu/eucom/europa.eu) > ... > Intellectual property rights

³²⁶ European civil code - [Wikipediaen.wikipedia.org](https://en.wikipedia.org/wiki/European_civil_code) > wiki > European_civil_code

³²⁷ Kombësia, shtetësia, the të drejtat e njeriut, ks udhëheqës, Asimi , J., MAndro, MAndro, A., 2017 Tiranë, - doktoratura.unitir.edu.a

³²⁸ Accelerating the implementation of the SDGs: how multilevel governance supports the implementation of SDG 12 in the EU ,Potter , M.,- 2020 - essay.utwente.nl

anëtar të tij, kushtet e pranimit, mekanizmën e funksionimit të institucioneve të përbashkëta e të tjera.

Komunikimi në çdo rast e kurdoherë është mëndësi, ndjenjë, sjellje.³²⁹

Shkolla ka një rol të rëndësishëm me kurrikulat e saj bashkëkohore europiane.³³⁰

Format dhe metodat për ta realizuar këtë janë të shumëllojshme.³³¹ I kemi mundësitë të bëjmë gjëra të bukura, tërheqëse dhe të dobishme. Kemi dy avantazhe: kapacitetet intelektuale dhe përvojën e vendeve të Europës Lindore (gati pothuajse të gjitha këto vende e kaluan me sukses provën e madhe, betejën e madhe të integritit të plotë europian). Çfarë mund t'u ofrohet shqiptarëve në të ardhmen në këtë drejtim:

-Një punë më të kualifikuar për të përcjellë tek brezi i ri mesazhin e rëndësishëm.

-Përsheptimi apo ngadalësimi i integritit është në dorën tonë, varet nga shqiptarët, nga forcat politike në vendin tonë, nga konsensusi midis tyre, nga zbatimi i reformave në të gjitha fushat.

- Shqiptarët duhet ta kenë të qartë se “mrekullia europiane” u arrit me punë, edhe “mrekullia shqiptare” këtë rrugë do të ndjekë. Integrimi kërkon punë, punë, punë, por nënkupton edhe shpenzime, ka koston e tij financiare dhe kërkon të arrihen standardet.¹¹

- Para se të japim data për pranimin në BE të ulemi e të punojmë seriozisht që procesi të ecë natyrshëm. Kërkohet:

- Të ngrihen qendra informimi për BE-në në të gjithë vendin. Në faqet e internetit pranë tyre të hyjë informacioni i ri që lidhet me zhvillimet dhe ndryshimet në BE. Në Letoni, para anëtarësimit të plotë të saj ekzistonin 32 pika informimi në rajone të ndryshme;

³²⁹ What kind of Europe? Tsoukalis, L., Tsoukalēs, L., - 2003 - Oxford University Press

³³⁰ Çili, H., Papa, E., - uet.edu.al, Tiranë, 2007

³³¹ Roberts, BW., Chernyshenko, OS., Stark, S., - Personnel ..., 2005 - Wiley Online Library

- Të furnizohen bibliotekat me libra që flasin për BE. Të organizohet “Dita e Poezisë europiane” dhe “Dita e prozës europiane”.
- Letërsia europiane do të ndihmojë për të njohur jetën e popujve të BE, psikologjinë e tyre, zakonet dhe traditat, gjuhën dhe historinë. Në lëndën e historisë e veçanërisht të gjeografisë ekonomike të hyjë informacioni i ri.³³²

Të rifreskohen tekstet dhe të botohen libra të vegjël (shtojca). Ndryshimet politike dhe zhvillimet ekonomike janë shumë të shpejta. BE përbëhet nga 27 shtete. Të tjera do të hyjnë së shpejti, të tjera aspirojnë.

- Qytetarët të marrin informacione të herëpashershme për negociatat me BE-në në formën e fletëpalosjeve, të nxiten ata për t’u bërë negociatorë të mirë për të ndihmuar e kontribuar për vendin e tyre;
- Të ngrihet një qendër kombëtare informimi, ku një specialist i çështjeve europiane të jetë në dispozicion për të marrë në shënim pyetje, shqetësime e probleme, të cilave ose u përgjigjet direkt ose me anë të postës elektronike;
- Të organizohen “Ditët e Europës”, “Javët e Europës”, festivali i filmit europian, i muzikës europiane me pjesëmarrjen e sa më shumë qytetarëve.

Motoja e diskutimit për Europën të jetë: “Demokraci-Dialog-Debat”³³³.

Krahas personaliteteve më të rëndësishme politike, në fushën e artit, kulturës e shkencës, në mënyrë të veçantë të atyre që kanë studjuar e punuar në vendet e BE mund të ftohen edhe personalitete nga këto vende, të cilët do të na japin edhe përvojën e tyre, si dhe sa punuan për të hyrë në BE.³³⁴ Çfarë po bëjnë tani dhe si ndihen, cila është e ardhmja e vendeve të tyre:

- Konkurse për vendet e BE-së në fusha të ndryshme: në histori, gjeografi, letërsi, art, muzikë, sport. Konkurs kombëtar “Si të bëhesh negociator i mirë” sipas përvojës polake.

³³² Veloutsou, C., Lewis, Jw., Paton, RA., - International Journal of ..., 2004 - emerald.com

³³³ <http://www.dw.com/sq/europa-juaj-demokraci-dialog-debat/a-2589635>

³³⁴ Sawyer, RK, - 2011 - books.google.com

Fituesit të shpërblehen duke i çuar për vizitë në një nga vendet e BE. Broshura në formën e fjalorit të BE dhe ABC-ja e ligjit të komunitetit. Libër i veçantë shkollor “Integrimi europian” dhe të hyjë sa më parë në kurikulat e shkollës; Sondazhe për problemet e integritit evropian.

Rezultatet të publikohen e të analizohen dhe personat që i kryejnë këto të jenë të kualifikuar e t’i njohin shumë mirë vendet e BE-së, problemet dhe mosmarrëveshjet për çështje të veçanta. Perceptimi i opinionit publik dhe zhvillimet në administratën Shqiptare. Mendimi i opinionit të gjere dhe grupeve të interesit për një përcaktim të qartë të problematikave të diskutuara është realizuar një sondazh, si një pjesë e metodave në këtë punim me synimin për të realizuar një serie tezash mbi studimin, nëpunësit publikë në shoqërinë shqiptare. Qëllimi i këtij anketimi është të sjellë në fokus funksionimin e administratës publike dhe perceptimin e saj në publik, mbi qasjen e integritit të saj në BE. Një shtet për të pasur mirëqenie sociale, në rrugën e realizimit ka në vlerësim edhe ndryshimet e nevojshme në legjislacion. Njerëzit në tërësi mendojnë se administratë publike, ka burimet e duhura kombëtare që të rritë mirëqenien e tyre. Koha e ndryshimeve solli domosdoshmerine për përshtatjen e administratës në vend. Shoqëria shqiptare, si një shoqëri në zhvillim solli zhvillime sociale dhe ekonomike dhe sot vendi ynë aspiro bashkimin me të drejta të plota në BE. ³³⁵

4.5.3 ADMINISTRATA PUBLIKE NË SHQIPËRI NË VITET 1990 - 2020

Shqipëria ka një Administratë publike mbi një shekull që prej krijimit të saj.³³⁶

Deklarata e Pavarësisë e miratuar nga Këshilli Kombëtar më 28 nëntor 1912 miratoi edhe

³³⁵ Gjuraj, T., Gurakuqi, R., Tarifa, F., Mato, E., - 2014 - uet.edu.al

³³⁶ crosscutting public administration reform strategy 2015 - 2020 - Dapdap.gov.al › images › PAR_Strategy_2015-2020_English

akte themelore për funksionim e shtetit të ri të pavarur shqiptar, ku dhe janë fillimet e organeve më të larta të administratës shtetërore .

Me krijimin e tij si një shtet i pavarur krijimi i një administrate shtetërore të qëndrueshme shfaqet si synim madhor.³³⁷

Zhvillimet e njohura në vend në kohë dhe periudha historike na sollën forma të ndryshme të administratës shtetërore në vend, të cilat iu përshtatën pa dyshim formës së qeverisjes, natyrës së shtetit që u krijua.

Zhvillimet e së drejtës administrative, baza ligjore për organizimin dhe funksionimin e administratës publike, janë të shumta nga koha në kohë dhe periudha në periudhë: format e organeve të krijuara, ndryshuara, ose transformuar në keto periudha kanë qenë nga më të shumtat dhe të ndryshmet.

Organizimi i shtetit e forma e qeverisjes ka ndryshuar nga republikane në monarkike apo nga një shtet-diktaturë proletariati në një shtet demokratik pas periudhës së viteve `90, apo nga një shtet i centralizuar në të decentralizuar dhe madje me qasje liberale në ofrimin e shërbimeve për publikun, e ku sot jemi para një administrate ku nevoja për reformimin e shërbimeve është e lidhur me procesin e integritit evropian të vendit që është tashmë prioritet themelor për vendin, dhe kjo gjithashtu analizohet hollësisht në këtë punim.

Me hapjen e vendit pas viteve `90 administrata publike si çdo pjesë tjetër e shoqërisë u përshkrua nga një transformim i plotë. Kjo periudhë është një ridimensionim i rolit të kësaj administrate ndaj është objekt në këtë pjesë të studimit.

³³⁷ Integrimi dhe kriza politike në shqipëri Milo ,P., - Gjeopolitika, 2010 - ceeol.com

Shqipëria, si edhe vendet postkomuniste vuajti nga probleme të një tranzicioni të gjatë nga faktorë vendas, rajonalë dhe globale. Administrata publike u shfaq e dobët a pa mundur të realizonte pritshmëritë publike dhe rritmin në kohës.

Kjo periudhë i takon kohës së kaluar, sot administrata publike në Shqipëri ka pak specifika në problematikë me natyrë vendase dhe ka karakteristikat problematike si në tërë administratat e tjera, nën efektet e një qeverisjeje ekonomike nën presionin e globalizmit dhe zhvillimeve teknologjike të nivelit të avancuar.

Problematika e njëjtë që konstatohet, tregon së paku tre elementë kryesore:

së pari : Rritjen e kapaciteteve të saj njëjtë si në vendet anëtare të BE-së.

së dyti: Administrata publike efikase është mënyra më e mirë e efikasitet dhe mirëqeverisjes dhe kërkohen burime finaciare dhe kërkimore në zhvillimin e saj, të cilat mund të jenë shtetërore, publike dhe jo publike.

së treti: Sistemet sot në botë në fushën e administrimit publik për të mundësuar garancitë nga e drejta publike në shërbim të së drejtës private të individit dhe asaj komunitare kërkon reforma të thella.

KREU V

ASPEKTE KONKRETE TË ADMINISTRIMIT DHE TË RREGULLIMEVE LIGJORE NË SHQIPËRI DHE BE

5.1 NDIKIMI NGA UNIFIKIMI I SË DREJTËS CIVILE NË ADMINISTRIMIN EVROPIAN

Administrimi i BE-së sot është projekti më i madh, i cili synon rregullimin dhe unifikimin e praktikave më të standartizuara. E drejta civile (private) ka një rol parësor në qarkullimin e lirë të vlerave pasurore, që ndryshe njihet si qarkullim i lirë i mallrave dhe shërbimeve.³³⁸

Deetatizmi i të drejtës civile nacionale dhe shkuarja e të drejtës civile drejtë europianizimit, është parakusht që BE të krijojë bazë të fuqishme për mirëqënien e shoqërisë dhe të bashkuar në një territor unik juridik.³³⁹

Krijimi i një të drejte civile të unifikuar në europë.³⁴⁰ Tejkalimi i zbatimit të juridiksioneve të shteteve të ndryshme për zgjidhjen e çështjeve juridike –civile, mund të gjendet në marrëveshjet e ndryshme bilaterale dhe shumë palëshe për zgjidhjen e çështjeve juridiko-civile

³³⁸ Ringnalda , A., - European Review of Private Law, 2009 - kluwerlawonline.com

³³⁹ Europeanisation of civil procedure: Towards common ...www.europarl.europa.eu › thinktank › document

³⁴⁰ Justice and Fundamental Rights | European Union - europa.eu › topics › justice-home-affairs_en

me elementë jo kombëtare ,ose duke bërë të mundur unifikimin e së drejtës civile në një Europë të bashkuar³⁴¹.

Bashkimi European nuk do mund të jetë kurrë funksional pa një të drejtë civile të rregulluar dhe kodifikuar në mënyrë unike për tërë vendet e Bashkimit Evropian.³⁴²

Qarkullimi i lirë i njerëzve, mallrave dhe shërbimeve mundësohen nga krijimi i kësaj hapësire të lirë të vlerave pasurore. Realizimi i kodit civil unik evropian është i kushtezuar nga faktorë të shumtë që vërehen sot në hapësirën e BE-së.³⁴³

5.1.1 KRIJIMI I NJË TË DREJTE CIVILE TË UNIFIKUAR NË EUROPE

E drejta civile dhe administrative janë sot në vëmendje të studiuesve të gjerë në shumë vende me sisteme dhe evoluime të ndryshme të së drejtës në tërësi.³⁴⁴ E drejta civile dhe ajo administrative janë dy degë të vjetra të drejtësisë.³⁴⁵

Por, gjithashtu këto janë dy degë të kundërta si nga objekti edhe metoda e rregullimit të tyre. E drejta civile e karakterizon metoda e barazisë së palëve si dhe të drejtën administrative, kjo krahas me metodën e sanksionimit të subjekteve. E përbashkëta në këto dy fusha të së drejtës konstatohet se edhe njëra edhe tjetra rregullojnë një objekt të njëjtë të jetës shoqërore –marrëdhëniet social ekonomike - me ekzaktësiht e drejta administrative rregullon edhe kjo,një lloj të marrëdhënieve juridike pasurore.³⁴⁶Arësimi shkollor i

³⁴¹ Galgano, F., E drejta private. Tiranë. 2010. fq.22

³⁴² Si funksionon Bashkimi Evropian - Publications Office of the ...publications.europa.eu › resource › genpub

³⁴³ Aliu, A., -UP, Prishtinë ,2014

³⁴⁴ The influence of the EU prospectus rules on private law Busch , D., - Capital Markets Law Journal, 2020 - academic.oup.com

³⁴⁵ The strategic constitution RD Cooter - 2020 - Princeton university press

³⁴⁶ Civil Procedure - European Law Institutewww.europeanlawinstitute.eu › current-projects › civil-...

detyrueshëm ;kujdesi shëndetësor etj,dikur rregulloheshin nga e drejta civile, sot janë tërësi aktesh që kryesisht kanë karakter juridik - administrativ.³⁴⁷

E drejta administrative rregullon shumë fusha që më parë njiheshin si të drejta civile. Ka disa fusha të shkencave juridike ku marrëdhëniet rregullohen në mënyrë të ndërthurur,d.m.th.edhe me dispozitat e njëres degë edhe me dispozitat e degës tjetër.³⁴⁸

Pyetjes se cila është natyra e marrëdhënies pasurore - juridike e rregulluar në këtë kontekst- është e karakterit civil apo atij administrativ. ³⁴⁹ Ka mendime të konsoliduara të disa autorëve,të cilët arrijnë në përfundimin se kjo do të përcaktohet në bazë të asaj se cili parim ka ardhë me më shumë në rastin specifik. ³⁵⁰ E drejta civile në të kaluarën ka rregulluar edhe marrëdhëniet e punës. E drejta e punës sot është degë e pavarur e së drejtës në Shqipëri si dhe në shumë vende të tjera, marrëdhëniet e punës i rregullon e drejta e punës si degë e vecantë e jurisprudencës³⁵¹. Përshtatja e të drejtës civile nacionale, pra decentralizimi i saj dhe krijimi i të drejtës civile të unifikuar,në një territor të bashkuar dhe unik juridik është kusht thelbësor që BE të krijojë një shoqëri të zhvilluar dhe të mirëqënies.³⁵²

Studiuesit, konsiderojnë se evropianizimi i të drejtës civile dhe asaj në tërësi është i mundur,si shembull i sukses`shëm mund ti referohemi dekantionizimit të së drejtës civile në Zvicër dhe në këtë mënyrë mund të jetëzohet edhe denacionalizimi i të drejtave kombëtare

³⁴⁷ From Enlargement to the Unification of Europe - Open Society ...www.opensocietyfoundations.org › publications › from...

³⁴⁸ Environmental principles: from political slogans to legal rules De Sadeleer, N., - 2020 - Oxford University Press

³⁴⁹ Administrative law and policy of the European Union Hofmann, HCH., Rowe, GC., Türk, AH., - 2011 - books.google.com

³⁵⁰ Constitutional & administrative law Barnett , H.,- 2017 - books.google.com

³⁵¹ Në fushën e marrëdhënieve të punës ka një tërësi dispozitash ligjore. Në disa vende marrëdhëniet e punës rregullohen me kod të vecantë p.sh vendi jonë ka kodin e Punës të miratuar në vitin 1995.Kodi i punës i republikës së Shqipërisë, Ligji nr.7961, datë 12.07.1995(i ndryshuar).

³⁵² Commentaries on the Law of Agency J Story - 2020 - books.google.com

në të drejtën private dhe realizohet evropianizimi i të drejtës civile³⁵³. Një rol të rëndësishëm në evropianizimin e të drejtës civile luan edhe niveli edukativ – kulturor i njohjes së të drejtave private shtetërore, sepse në këtë mënyre hapet perspektiva për një të drejtë unike dhe të pranueshme për të gjitha shtetet anëtare dhe aspirante të BE-së.³⁵⁴

Sistemet kryesore të jurispritudencës, pra sistemi kontinental dhe shtetet e sistemit juridik *common law*, kanë shumë të përbashkëta si dhe vetë shtetet ndërmjet tyre dallohen elementë të përbashkët. E drejta ndërkombëtare private është një degë e pavarur e së drejtës e cila përcakton zgjedhjen e rasteve të spektrit juridiko - pasuror, të cilat thuhet se e drejta ndërkombëtare private, rregullon marrëdhënien specifike juridike civile.³⁵⁵ Këto marrëdhënie pasurore me elementë ndërkombëtar, elementi i huaj, si përcaktues i kompetencës ligjore, mund të paraqitet te palët e marrëdhënies juridike civile. Ky element i jashtëm tek raporti juridiko - civil mund të paraqitet në: subjekt, objekt dhe obligime.³⁵⁶ E drejta ndërkombëtare private, percepton një pjesë të së drejtës nacionale private³⁵⁷. Marrëdhëniet juridike civile që krijohen janë të shumëllojeshme në një ekonomi të tregut, liri e qarkullimit të mallrave dhe të njerëzve, janë të kushtëzuar nga kontratat që lidhen edhe midis personave të shteteve dhe nacionaliteteve të tjera.³⁵⁸

Në këto raste duhet të dihet e drejta civile e kujt shteti do të zbatohet.³⁵⁹

Pra, nuk jepen dispozitat e veta të vecanta nga e drejta ndërkombëtare private, po jep klauzolën e përzgjedhjes së të drejtës egzistuese nga njëri, apo tjetrit shtet për rregullimin e mar-

353 Franz, W., La denationalization du droit privé dans L'union Européenne, L'Européanisation du droit privé, Edition Universitaires Fribourg Suisse, 1998, fq.24

354 Judicial independence in the EU: a puzzle Gutmann, J., Voigt, S., - European Journal of Law and Economics, 2020 - Springer

355 Comparative administrative law Rose-Ackerman, S., Lindseth - 2010, PL., - books.google.com

356 Environmental principles: from political slogans to legal rules De Sadeleer, N., - 2020 - Oxford University Press

357 Mills, A., vepra. fq.92.

358 The Main Directives of the Process of Unification Commercial ...www.ersj.eu > journal > download

359 Fundamentals of European civil law Vranken, M., - 2010 - core.ac.uk

rëdhënies ligjore konkrete.³⁶⁰Unifikimi i së drejtës civile në shtetet e BE-së,do të bëjë të mundur heqjen e dallimeve nga ligjet në fushën e së drejtës private,rast konkret do të ishte unifikimi i zotësisë juridike të personit fizik,ose përgjegjesia kontraktore dhe jo kontraktore,etj. Unifikimi i atyre fushave të cilat janë të pranueshme për të gjithë në fillim,p.sh. E drejta pronësore;E drejta e trashëgimisë; E drejta kontraktore, do ta bënte më të afërt idene e hershme të një kodi unik civil në një evrope të bashkuar.³⁶¹

Bashkimi evropian, aktualisht e ka prioritet të vet unifikimin e çështjeve juridike nga fusha e të drejtës private dhe është në fokusin e saj të zyrës për çështjet juridike.³⁶²

Po hidhen hapa konkrete lidhur me rregullimet kontraktore pra hidhen bazat për parimet e së drejtës kontraktore evropiane,realizohen bazat e parimeve të së drejtës familjare evropiane,me synim për të arritur qëllimin final atë të një kodi civil evropian.³⁶³

5.1.2 PËRGATITJA E KODIT CIVIL EUROPIAN

PE(Parlamenti evropian) ka nxjerrë dy rezoluta që kanë të bëjnë me unifikimin dhe harmonizimin e së drejtës private.³⁶⁴ Këto dy rezoluta janë: E para: Rezoluta për njehsimin e së drejtës private të shteteve anëtare,në vitin 1989; E dyta: Ajo për harmonizimin e fushave të caktuar të së drejtës private të shteteve anëtare të BE-së e vitit 1994. Përgatitja e kodit civil European,shfaqet në disa qendra koordinuese ku dallojmë që dhe janë formuar grupet punuese në qendra të ndryshme të shteteve anëtare : kontratat afatgjata në

³⁶⁰ Reference Matrix of EU Law Schmon, C., - The Interconnection of the EU Regulations Brussels I ..., 2020 - Springer

³⁶¹ International Unification of Trade Laws Srivastava , A.,- Modern Law of International Trade, 2020 - Springe

³⁶² Rethinking the boundaries between public law and private law for the twenty first century: An introduction Rosenfeld, M., - International journal of constitutional law, 2013 - academic.oup.com

³⁶³ The emergence of EU contract law: exploring Europeanization Miller, L., - 2011 - OUP Oxford

³⁶⁴ A European Framework for private international lawwww.europarl.europa.eu › document › activities › cont

Amsterdam;Tilburg - Shërbimet;³⁶⁵ Utreht - Shitja e mallit; Hamburg Mjetet për sigurimin personal; Osnabruk - E drejta e dëmit; Salzburg - E drejta e pronësisë mbi sende të luajtshme,etj. Gjykata Evropiane e drejtësisë luan një rol të rëndësishëm gjithashtu në unifikimin e së drejtës private të Bashkimit Evropian.

Nga puna këtyre grupeve ka rezultuar publikimi i pjesëve që kanë të bëjnë me disa të drejta si ajo tregëtare,praktikisht Kodin Civil Evropian. Publikimet e BE-së,kanë prezantuar krahasimet e zgjidhjeve që ekzistojnë në shtete të ndryshme dhe në fund është dhënë dhe propozimi që mendohet të jetë i nevojshëm për të gjitha shtetet anëtare të europës së bashkuar. Unifikimi i së drejtës nënkupton nxjerrjen e normave të njëjta nga nocioni i të drejtës materiale apo procedurale që kanë vlefshmeri në territorin e një shteti apo më shumë shtetesh .³⁶⁶ Shqipëria dhe harmonizimi i të drejtës civile në Shqipëri me të drejtën civile të Bashkimit Evropian. Harmonizimi i të drejtës civile të Shqipërisë me atë të shteteve anëtare të Evropës bëhet me rastin e miratimit të ligjeve përkatëse civile në Shqipëri.³⁶⁷

E drejta e zbatuar, respektivisht përshtatja e të drejtës civile me të drejtën civile të vendeve të bashkimit evropian, është proces i varur edhe nga zhvillimi social - ekonomik i Shqipërisë. Harmonizimi i të drejtës civile dallon nga fjala unifikim i të drejtës civile, sepse unifikimi nënkupton të drejtën e njëjtë civile në shtetet e Bashkimit Evropian.³⁶⁸ Mendohet,se kjo do të ndodhte në të ardhmen kur të bëhet miratimi i Kodit Civil të Bashkimit Evropian.

³⁶⁵ The European Parliament's right of initiative www.europarl.europa.eu > IPOL_STU(2020)655134_EN

³⁶⁶ Belicanec, T., Sostojbite i potrebat,od kodifikacija na makedonskoto pravo, Godisnik na pravniot fakultet, Shkup 2001, fq.37.

³⁶⁷ International investment law: reconciling policy and principle SPS QC - 2020 - Bloomsbury Publishing

³⁶⁸ The Unification of Private Law in Europe from the Perspective ...www.researchgate.net > publication > 255686789_The_U.

5.2 E DREJTA E PRONËSISË INTELLEKTUALE

E drejta e pronësisë intelektuale si një pjesë e së drejtës civile, përbën shtyllën kryesore të mbrojtjes ligjore të krijimeve intelektuale, produkt i individit në fushën industriale, shkencore, letrare ,artisike,etj. Kjo e drejtë konsiderohet si një mjet ekuilibruës midis ligjeve të tregut dhe aftësive intelektuale, dukurive ekonomike dhe atyre shpirtërore, interesave të prodhuesit dhe interesave të konsumatorit, interesit publik për inovacionin dhe interesit privat për ndarjen e përfitimeve që rrjedhin prej tyre. Ky punim është realizuar me synim trajtimin e një prej fushave më moderne të jurisprudencës dhe praktikës gjyqësore, “të drejtën e pronësisë intelektuale”. Ashtu si të mirat materiale dhe krijimet e individit në fushën industriale, shkencore, letrare dhe artisike, mund të jenë objekt i pronës. Këto krijime rregullohen nga e drejta e pronësisë intelektuale, një nga institutet e së drejtës civile.³⁶⁹ Sjell si vijon një trajtim të kësaj të drejte në planin kombëtar dhe atë ndërkombëtar duke u përqëndruar në rregullimet ligjore të dy kategorive kryesore të saj.

5.2.1 E DREJTA E AUTORIT DHE PRONËSIA INDUSTRIALE

Një vend me rëndësi kanë dhe problematikat lidhur me zbatimin e kësaj të drejte. Nisur nga kjo e fundit, vlen të theksohet se përmirësimi i kuadrit ligjor dhe ndërmarrja e politikave për të siguruar zbatueshmërinë e saj, përbëjnë sfidat më të mëdha lidhur me këtë të drejtë, pasi standardi i emancipimit të një shoqërie varet nga respektimi i të drejtës së pronësisë intelektuale. Si një e drejtë e krijuar rishtazi, por me një kornizë ligjore të mirëorganizuar në plan kombëtar e ndërkombëtar, e drejta e pronësisë intelektuale ka problematika lidhur me zbatueshmërinë e saj. Nevoja për politika, rregullim ligjor dhe zbatueshmëri të legjislacionit, cilësohen si prioritete lidhur me këtë fushë të re të së drejtës.³⁷⁰

³⁶⁹ The global political economy of intellectual property rights: The new enclosures? May , C., - 2013 - books.google.com

³⁷⁰ Breyer, SG., Stewart, RbB, Sunstein, CR., Vermeule, A., - 2017 - Wolters Kluwer Law & Business

Në plan ndërkombëtar, vlen të përmendet roli i Bashkimit Evropian që prej disa vitesh, është duke zhvilluar një politikë aktive në fushën e pronësisë intelektuale lidhur me harmonizimin e legjislacioneve kombëtare.³⁷¹

Politika po ndërmerren edhe në vendet në zhvillim si Shqipëria, të cilat konsiderohen me tradita të pakëta në fushën e të drejtës së pronësisë intelektuale. Një ndër sfidat me të rëndësishme për një shtet është që të siguroj një ambient të përshta shëm për krijuesit dhe ndërmarrësit, mbi të gjitha pikësynim me rëndësi është tërheqja e investitorëve të huaj. Dhe sigurisht që të përmbushet ky synim, duhet të sigurohet mbrojtja e krijimtarisë, pra mbrojtja e pronësisë intelektuale në tërësi. Pronësia Intelektuale ndahet në dy kategori kryesore: E drejta e autorit dhe Pronësia Industriale. Në vijim, ndalemi në një trajtim më të hollësishëm të secilës kategori. E drejta e autorit, si një kategori e të drejtës së pronësisë intelektuale, realizon mbrojtjen e krijimtarisë në fushën letrare, shkencore dhe artistike.

E drejta e autorit, por dhe pronësia intelektuale në tërësi, përbëjnë koncepte relativisht të reja në Shqipëri. Ishte Kodi Civil i vitit 1929 ai që shënoi fillimet e para të mbrojtjes së të drejtës së autorit. Në këtë kod, kjo e drejtë cilësohej si e drejta e autorit dhe e shpikësve mbi veprat dhe shpikjet e tyre.

Ndërkohë, krijimtaria e individit gjatë regjimit komunist, nuk cilësohej pronë private, pra mbajtësi i të drejtës së autorit ishte shteti, ai vendoste për riprodhimin e veprës, përkthimin në gjuhë të ndryshme dhe për çdo formë tjetër disponimi të saj.

Pas rënies së regjimit komunist dhe tranzicionit drejt demokracisë lindi koncepti “pronë private”, krijimet tashmë u cilësuan si pronë private e autorëve.

Ligji nr. 7564, datë 19.05.1992 “Për të drejtën e autorit”, i amenduar disa herë, për të arritur përshtatjen me standardet ndërkombëtare, përbën ligjin e parë që sanksionon mbrojtjen e të drejtës së autorit. Gjatë kësaj periudhe të drejtat e autorit u rregulluan në mënyrën më të plotë të rregulluar ndonjëherë në Shqipëri deri në atë moment. Kushtetuta e vitit

³⁷¹ Developing a private international intellectual property law: the demise of territoriality Dinwoodie , GB., - Wm. & Mary L. Rev., 2009 - HeinOnline

1994³⁷²përbante dispozita që i referoheshin specifikisht të drejtës së autorit lidhur me lirinë e krijimit, përdorimit, përfitimit prej saj dhe mbrojtjen ligjore.

Ligji bashkëkohor që rregullon të drejtën e autorit është ligji nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të”. E drejta e autorit trajton atë pjesë të legjislacionit të një vendi që siguron mbrojtje për një vepër të caktuar duke i garantuar autorit të saj një sërë të drejtash ekskluzive dhe duke i ndaluar të tjerët nga përdorimi i kësaj vepre për një afat kohor të caktuar. Qëllimi i ligjit është mbrojtja e të drejtës së autorit dhe e të drejtave të tjera të lidhura me të”.³⁷³ Ky ligj përcakton të drejtat dhe detyrimet e subjektit pjesëmarrës në veprimtaritë krijuese, prodhuese, tregtare ose në çdo veprimtari tjetër vlerësimi, shfrytëzimi, përdorimi a tjetërsimi të veprave letrare, artistike apo shkencore.³⁷⁴

E drejta e autorit aplikohet në të gjitha veprat origjinale letrare, shkencore dhe artistike.

Këto përfshijnë librat, muziken, skulpturat, pikturat, fotografinë, filmat, programet radio-televizive, programet kompjuterike. Titullarët e të drejtave mund të jenë autori, bashkëautorët dhe persona të tjerë. Autori është personi ose janë personat fizikë, që krijojnë një vepër letrare, artistike ose shkencore.

Kur vepër e përbashkët është puna krijuese e disa autorëve në bashkëpunim, kemi të bëjmë me bashkëautorësi. Marrëdhëniet midis tyre rregullohen me marrëveshje ndërmjet palëve ose sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Titullar të së drejtës së autorit mund të jenë edhe trashëgimatrët e autorit të veprës si rrjedhojë e trashëgimisë ligjore ose testamentare. Përfitimi i autorit të veprës është si ekonomik, ashtu edhe moral. Të drejtat ekonomike përfshijnë të drejtën e riprodhimit të veprës, qiradhënies, shpërndarjes, interpretimit të veprës në publik, transmetimit në publik, përpunimit etj.

³⁷² Nene nga Kushtetuta e vitit 1994: “1. Liria e krijimit artistik dhe e kërkimit shkencor, vënia në përdorim si dhe përfitimi prej arritjeve të tyre janë të garantuara për të gjithë.2. E drejta e autorit mbrohet me ligj.”

³⁷³ Neni 1 i ligjit nr.9360, datë 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të”.

³⁷⁴ Neni 2 i ligjit nr.9360, datë 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të”.

Titullari i një vepre gëzon gjithashtu të drejtën e transferimit të të drejtave ekonomike pjesërisht ose tërësisht tek një palë e tretë kundrejt një pagese, bazuar në të ardhurat e siguruara nga përdorimi ose tregëtimi i veprës.

Nëse transferohen të gjitha të drejtat ekonomike, atëherë pronari i ri i veprës është personi që ka të gjitha të drejtat. Një formë tjetër transferimi i të drejtave ekonomike është licënsimi.

Kjo e fundit nënkupton të drejtën e pronarit për të autorizuar një person të tretë që të kryej veprime lidhur me të drejtat ekonomike për një kohë të caktuar, por duke e ruajtur pronësinë mbi veprën pronari fillestar. Për sa i përket të drejtave morale, në këtë kategori përfshihet e drejta e publikimit për herë të parë të veprës, e drejta e njohjes së autorësisë, e drejta e respektimit të integritetit të veprës, e drejta e heqjes dorë. Nga ana tjetër, përfitimi moral që merr autori i veprës shprehet në formën e rritjes së reputacionit dhe emrit të mirë në treg.

E drejta e autorit për veprën e tij letrare ose artistike zgjat gjatë gjithë jetës së autorit dhe deri 70 vjet pas vdekjes së tij, pavarësisht nga data kur vepra është bërë publike në mënyrë ligjore. Me përfundimin e afati të parashikuar vepra kalon në zotërim të publikut, pra vepra mund të shfrytëzohet lirisht pa qenë nevoja për të marrë lejen e autorit për kryerjen e veprimeve që përfshihen në të drejtat ekonomike të tij³⁷⁵. Të drejtat e lidhura me të drejtën e autorit përbëjnë të drejtat e interpretuesëve/ ekzekutuesëve të veprave artistike, të drejtat e prodhuesëve të regjistrimeve audio e audiovizuale dhe të drejtat e shoqërive transmetuese të programeve radiofonike dhe televizive.

Ligji “Për të Drejtën e Autorit e të Drejta të Tjera të Lidhura me Të”, përcakton si institucion kryesor Zyrën Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA)³⁷⁶, që përbën institucioni përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale në Shqipëri.

Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit është një institucion qendror në varësi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me seli në Tiranë.

375 Siç shprehet neni 21 i ligji nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të”.

376 B.urim i të dhënave: Faqja zyrtare e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit

ZSHDA-ja ka si objekt të veprimtarisë mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të autorëve dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të, nga subjektet, persona fizikë/juridikë, privatë a publikë, përdorues të pronësisë letrare, artistike, shkencore. Kjo zyrë shqyrton çdo aplikim për regjistrim; çertifikon çdo marrëveshje apo kontratë ku objekt janë të drejtat mbi veprën ose kalimin e të drejtave pasurore mbi veprën; ofron shërbime të specializuara për çdo rast konflikti ndërmjet palëve; depoziton të gjitha aplikimet, regjistrimet dhe ndryshimet e të drejtave të autorit në Regjistrin e të Drejtave të Autorit etj. Ministria e Kulturës, pas konsultimeve me grupet e interesit dhe ekspertë të BE-së, ka hartuar projektligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to, i cili pritet të miratohet në Parlamentin Shqiptar.³⁷⁷

Ky ligji i ri, sjell një rregullim ligjor të harmonizuar me standardet e BE-së si dhe të organizatave ndërkombëtare ku Shqipëria është palë.

5.2.2 PRONËSIA INDUSTRIALE

Krijimtaria intelektuale që gjen zbatim në industri, quhet pronësi industriale. Ligj nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” i ndryshuar 378, gjithashtu dhe marrëveshjet ndërkombëtare ku Shqipëria ka aderuar, krijojnë kuadrin ligjor të kësaj fushe të së drejtës në Shqipëri. Gjatë regjimit komunist pronësia industriale ishte aset i shtetit, pra i institucioneve shtetërore, dhe aktiviteti privat mungonte tërësisht. Regjistrimi i markave dhe patentave, që i përkisnin institucioneve shtetërore ose që i përkisnin personave të huaj ishte kompetencë e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, një organ nën varësinë e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Me ligjin Nr. 7819 janë krijuar organe të reja përgjegjëse për vlerësimin e aplikimeve, regjistrimin si dhe monitorimin e patentave dhe markave. Konkretisht institucioni kompetent ishte

³⁷⁷ Kuvendi i Shqipërisë www.parlament.al.

378 I ndryshuar nga ligji nr. 55/2014 datë 29.05.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008, Për Pronësinë Industriale”.

Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave e krijuar me V.K.M nr.135, datë 22 Mars 1993, si një institucion qëndror publik i varur drejtpërdrejt nga Këshilli i Ministrave.

Sipas ligjit Nr. 9525 datë 25 Prill 2006, DPPM-ja u shndërrua në një institucion publik nën varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës. Misioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave është të forcojë mbrojtjen e pronësisë industriale brenda territorit shqiptar nëpërmjet njohjes ose regjistrimit të këtyre të drejtave dhe nëpërmjet krijimit dhe organizimit të regjistrave të të drejtave në fuqi në Shqipëri.³⁷⁹ Ky institucion ndjek procedurat për dhënien dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale; kryen regjistrimin e patentave, markave, dizenjove, treguesëve gjeografik; harton ligjet dhe rregulloret që kanë të bëjnë me përsosjen e sistemit të pronësisë industriale; përfaqëson në gjykatë për çështje që lidhen me administrimin e objekteve të pronësisë industriale; përfaqëson vendin dhe plotëson detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet dypalëshe, me zyra homologe dhe organizma e organizata ndërkombëtare për çështje të pronësisë industriale.³⁸⁰ Vlen të përmendet gjithashtu rëndësia e institucioneve si Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, lidhur me rolin e tyre në monitorimin dhe sigurimin e zbatueshmërisë së të drejtës së pronësisë intelektuale. Kategoritë që gjejnë mbrojtje sipas ligjit për pronësinë industriale janë: patentat dhe modelet e përdorimit; markat tregëtare dhe të shërbimit; dizenjot industriale; treguesit gjeografik. Përpara se një ndërmarrje të përfitojë nga pronësia mbi pasuritë intelektuale, ajo duhet të fitojë të drejtat ligjore mbi këto pasuri. Të drejtat e pronësisë industriale duhet të regjistrohen sipas formës së parashikuar në ligj për të siguruar mbrojtjen e aktivitetit krijues dhe nxitjen për prurje në vazhdimësi. Nëse kushtet e regjistrimit përmbushen, mbrojtja sipas kërkesës realizohet në nivel rajonal ose ndërkombëtar. Ky regjistrim sipas ligjit dhe institucionit

379 Marrë nga “Strategjia për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale nga Administrata Doganore Shqiptare”, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Departamenti Operativ-Hetimor, Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale.

380 Veprimtari kryesore të parashikuara në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave.

përgjegjës, i jep pronarit të drejta ekskluzive duke përjashtuar çdo individ nga përdorimi i paautorizuar i pronës intelektuale të regjistruar.

Patenta është një e drejtë ekskluzive që jepet për një shpikje.³⁸¹

Shpikja të gëzojë mbrojtje ligjore, duhet të përbëjë risi, të pëmbajë hap shpikës dhe të jetë e zbatueshme në industri. Patenta i jep shpikësit të drejtën për të përjashtuar të tjerët nga përdorimi për qëllime tregtare i krijimit të tij. Titullari i një shpikje mund të aplikojë sipas procedurave të parashikuar në ligj për marrjen e patentës kombëtare, rajonale ose ndërkombëtare. Kohëzgjatja e një patente për një shpikje është 20 vjet.

Marka tregtare është një shenjë dalluese, që tregon burimin e mallit ose shërbimit.³⁸² Mbrojtja e markës sigurohet përmes procedurës së regjistrimit të saj në DPPM. Shenja dalluese dhe karakteri tregtar përbëjnë kushtet e nevojshme për regjistrimin e markës. Pas regjistrimit të markës në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, pronari i markës gëzon të drejtën ekskluzive për të ndaluar të tjerët në regjistrimin e markave që kanë të njëjtat shenja dalluese. Kohëzgjatja e mbrojtjes së një marke është 10 vjet. Dizenjo industriale përcakton pamjen e jashtme të një produkti që gëzon mbrojtje ligjore si një i tërë ose i pjesëve të tij. Që një dizenjo industriale të gëzojë mbrojtje ligjore, duhet të jetë e re dhe të ketë një karakter individual.

Dizenjo Industriale që plotëson këto kushtet, gëzon mbrojtjen ligjore përmes regjistrimit në nivel kombëtar ose ndërkombëtar.

Kohëzgjatja e mbrojtjes së një dizenjo është 5 vjet, me ripërtëritje deri në 25 vjet³⁸³. Treguesi gjeografik është një shenjë e përdorur mbi mallrat që kanë origjinë specifike gjeografike dhe që zotërojnë cilësi në sajë të vendit të origjinës së tyre.

Treguesi gjeografik gëzon mbrojtje ligjore përmes regjistrimit të parashikuar nga ligji “Për pronësinë industriale”.³⁸⁴

³⁸¹ Frequently Asked Questions: Patents - WIPO www.wipo.int > patents > faq_patents

³⁸² Trademark - Wikipedia en.wikipedia.org > wiki > Trademark

³⁸³ Referuar ligj nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”.

³⁸⁴ Dega, F., “Pronësia Intelektuale”, Tiranë, 2014, fq. 93.

Një fornë e veçantë e mbrojtjes së pronësisë industriale, është dhe sekretit tregëtar, që përbën çdo informacion konfidencial që mbrohet në mënyra të përshtatshme për të mbrojtur interesat e nje ndërmarrje në treg duke siguruar një konkurrencë të ndershme.

5.3 RREGULLIMI LIGJOR NDËRKOMBËTAR I PRONËSISË INTELEKTUALE

E drejta e autorit rregullohet në dokumenta ndërkombëtar me rëndësi që kanë dhënë një kontribut të madh dhe janë model për krijimin e kuadrit ligjor kombëtar për çdo shtet.

Një nga dokumentat më të rëndësishëm që sanksionon të drejtën e autorit është Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, e miratuar më 10 dhjetor të vitit 1948 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. Kompetencë të ngjashme me atë të parashikuar në ligjin Shqiptar e gjejmë edhe tek vendet e tjera, kryesisht të sistemit anglo-sakson (ShBA, Argjentinë, Brazil, etj) por edhe tek ato të sistemit të së drejtës civile (Itali, Spanjë, pjesërisht Gjermani, Austri)³⁸⁵. Konkretisht neni 27 i saj parashikon se: Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore të bashkësisë, të gëzojë artet dhe të përfitojë nga përparimi shkencor dhe dobitë e tij. Gjithkush ka të drejtë të mbrojë interesat morale dhe materiale, që rrjedhin nga çdo krijimtari shkencore, letrare dhe artistike, autori i të cilave është ai vetë.

Dokumenta të tjera me rëndësi janë Pakti Ndërkombëtar për të drejtat pasurore e shoqërore; Pakti Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike. Konventa themeluese e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (OBPI) e nënshkruar më 14 korrik 1967 ne Stokholm nga 123 shtete, përbën një dokument me rëndësi që kishte si objektiv kryesor nxitjen e mbrojtjes së pronësisë intelektuale në të gjithë botën përmes bashkëpunimit mes shtetve ose në raste të nevojshme edhe mes organizatave botërore. Por, vlen të përmendet dhe fakti që UNESCO ³⁸⁶ ka dhënë një kontribut të madh në adoptimin e kësaj konvente.

385 Në këtë material do të paraqes karakteristikat e disa prej tyre, duke përjashtuar rastin italian.

³⁸⁶ UNESCO - [Wikipediaen.wikipedia.org > wiki > UNESCO](http://Wikipediaen.wikipedia.org/wiki/UNESCO)

Shqipëria u bë palë e saj më 30 Qershor 1992.³⁸⁷Konventa e Bernës është cilësuar si konventa kryesore që i siguron një trajtim gjithëpërfshirës mbrojtjes ndërkombëtare të veprave. Konventa është nënshkruar në Bernë në 09.09.1886 dhe ka pësuar disa ndryshime e modifikime. Kjo konventë përmban tre parime bazë mbi të cilët ajo ushtron veprimtarinë e saj. Parimi i trajtimit kombëtar parashikon që veprat e krijuara në një shtet të caktuar gëzojnë të njëjtat vlera në të gjitha shtetet anëtare. Parimi automatik parashikon se të drejtat gëzohen automatikisht, për t'i gëzuar ato, nuk vendosen kushte. Parimi i pavarsisë së mbrojtjes parashikon se pavarsisht mbrojtjes në vendin e origjinës, në qoftë se vepra përdoret në një shtet palë të konventës, gëzohen të drejtat e autorit automatikisht. Konventa e Bernës mbron çfarëdo veprave letrare e artistike të çdo lloji forme qoftë ajo. Mbrojtja e të drejtave sipas kësaj konvente ka një kohëzgjatje prej 50 vjetësh pas vdekjes së autorit. Në vijim ndalemi në trajtimin e disa prej dokumentave kryesorë që përbëjnë kuadrin ligjor ndërkombëtar lidhur me të drejtën e pronësisë industriale. Konventa e Parisit “Për mbrojtjen e Pronësisë Industriale” e nënshkruar në Paris, më 20 Mars 1883, ishte një nga traktatet e para që bashkoi shtetet me mision mbrojtjen e pronësisë industriale. Konventa zbatohet lidhur me patentat, modelet e përdorimit, markat tregtare, dizenjot industriale.

Sipas nenit 2/1 të traktatit, nënshkruarit angazhohen t'i njohin qytetarëve të vendeve të tjera të BE-së të njëjtat të drejta në lidhje me pronësinë industriale, të njohura për qytetarët e tyre.

Konventa parashikon të drejtën e përparësisë dhe siguron një trajtim të barabartë në të gjitha vendet nënshkruese.³⁸⁸ Traktati mbi ligjin “Për Patentat” është një traktat multilateral i lidhur më 1 Qershor 2000 në Gjenevë, Zvicër, nga 53 shtetet dhe nga Organizata

Europiane e Patentave. Qëllimi i tij ishte harmonizimi i procedurave formale: përcaktimi i një date depozitimi lidhur me kërkesën për patentë, formën dhe përmbajtjen e një kërkesë për patentë, dhe përfaqësimin. Traktati mbi ligjin “Për Markat Tregtare”, e mirtaura në Gjenevë

³⁸⁷ Semini, M., “E drejta e autorit në Shqipëri”, Tiranë, 2009, fq. 300.

³⁸⁸ Neni 4/2 i Konventës së Parisit “Për mbrojtjen e Pronësisë Industriale” sipas së cilës, *e drejtë e përparësisë*, do të thotë se kushdo që ka paraqitur në një vend të BE-së një patentë për shpikje, model përdorimi, dizenjo industriale, markë tregtare, do të gëzojnë të drejtën e përparësisë për regjistrimin në vendet e tjera nënshkruese të konventës.

më 27 Qershor 1994, standardizoi dhe modernizoi procedurat kombëtare dhe rajonale për regjistrimin e markës tregtare. Kjo u arrit përmes harmonizimit të procedurave, duke i bërë kështu aplikimet për markë dhe administrimin e procedurës së regjistrimit të markës tregtare, në juridiksione të ndryshme, si një proces më pak kompleks dhe më të organizuar.

Marrëveshja e Madridit në Lidhje me Regjistrimin Ndërkombëtar të Markave e nënshkruar në 14 Prill 1891 dhe protokollin e saj, përbëjnë sistemin kryesor ndërkombëtar për lehtësimin e regjistrimit të markave tregtare në juridiksione të shumtë në mbarë botën. Baza e saj ligjore është një traktat multilateral i cili siguron një mekanizëm të vetëm për mbrojtjen e markës tregtare në shumë vende. Kjo realizohet përmes një regjistrimi ndërkombëtar, në një gjuhë të vetme dhe me një pagesë të vetme.

Ky sistem administrohet nga Zyra Ndërkombëtare e Organizatës Ndërkombëtare të Pronësisë Intelektuale (EİPO).³⁸⁹ Traktati i Bashkëpunimit për Patentat (TBP) është një traktat ndërkombëtar mbi patentat, i miratuar në Washington më 1970. Objektivi kryesor ishte përmirësimi i mjeteve të mëparshme të aplikimit për patentë në vende të ndryshme. Ky traktat parashikoi një procedurë të unifikuar për paraqitjen e kërkesës për patentë duke siguruar mbrojtje të shpikjes në secilin nga shtetet kontraktuese. Marrëveshja mbi Aspektet Tregtare të Drejtave të Pronësisë Intelektuale³⁹⁰ nënshkruar në prill të vitit 1994 është një marrëveshje ndërkombëtare e administruar nga Organizata Botërore e Tregtisë (OBT)³⁹¹ e cila parashtrori standardet për format e pronësisë intelektuale. Kjo marrëveshje lindi si një përpjekje për të kapërcyer hendekun e dallimeve ligjore të rregullimeve të së drejtës së pronësisë intelektuale nëpër botë, për të sjellë rregulla të përbashkëta ndërkombëtare. Ajo parashikon një nivel minimal të mbrojtjes që çdo qeveri duhet t'i sigurojë pronësisë intelektuale. Marrëveshja TRIPS përcakton kushtet ligjore që vendet anëtare duhet të përmbushin për të mbro-

³⁸⁹ WIPO - World Intellectual Property Organization www.wipo.int

³⁹⁰ Malltezi, A., Rystemaj, J., Pelniku, L., "Aspekte të së drejtës së biznesit në Shqipëri", Tiranë, 2013, fq. 155.

³⁹¹ World Trade Organization - Home page - Global trade www.wto.org

jtur pronësinë intelektuale, konkretisht të drejtën e autorit, treguesit gjeografikë, dizenjot industriale, patentat, markat tregtare të regjistruara dhe shumë fusha të tjera. Gjithashtu ajo përcakton udhëzime lidhur me zbatimin e ligjeve për mbrojtjen e pronës intelektuale dhe procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Marrëveshja prezanton për herë të parë kërkesa ligjore konkrete për të drejtën e pronësisë intelektuale në sistemin tregtar ndërkombëtar dhe aktualisht është marrëveshja ndërkombëtare e më e plotë mbi pronësinë intelektuale. Lidhur me kuadrin ligjor evropian vlen të përmendet Konventa Evropiane e Patentave si dhe direktivat dhe rregulloret përkatëse. Konventa Evropiane e Patentave, e nënshkruar më 5 Tetor 1973, është traktati multilateral themelues i Organizatës Evropiane të Patentave. Kjo konventë ofron një kornizë ligjore me procedura të harmonizuara për dhënien e patentave evropiane nga Zyra Evropiane e Patentave.³⁹²

Një aplikim i vetëm për patentë, në një gjuhë zyrtare, mund të dorëzohet në Zyrën Evropiane të Patentave në Mynih, në degët e saj në Hagë, Berlin ose në një zyrë kombëtare të një shteti kontraktues, nëse ligji kombëtar i shtetit e lejon.³⁹³

5.3.1 KËNDVËSHTRIMI I BASHKIMIT EUROPIAN LIDHUR ME TË DREJTËN E PRONËSISË INETEKTUALE

Bashkimi Evropian është duke zhvilluar prej disa vitesh një politikë aktive në fushën e pronësisë intelektuale me qëllim harmonizimin e legjislacioneve kombëtare. Pra, edhe pse të rregulluara me ligjet e tyre kombëtare, të drejtat e pronësisë intelektuale janë të rregulluara edhe me legjislacionin e BE-së. Që prej hyrjes në fuqi të Traktatit për Funksionimin e Bash-

³⁹² EPO - Legal texts - European Patent Office www.epo.org › law-practice › legal-texts

³⁹³ The World Intellectual Property Organization (WIPO), faqja zyrtare ku janë parashikuar dokumentat ndërkombëtarë në lidhje me pronësinë industriale. <http://www.wipo.int/treaties/en>.

kimit European në vitin 2009, BE-ja ka kompetencë të përcaktuar në lidhje me të drejtën e pronësisë intelektuale, kjo e parashikuar në nenin 118 të saj³⁹⁴.

Rregjistrimet e markave dhe dizenjove në nivel evropian i nënshtrohen një sistemi të unifikuar ligjor, i cili siguron një mbrojtje të plotë dhe të njëtrajtshme në të gjithë Bashkimin Evropian.³⁹⁵

Aktiviteti legjislativ i Bashkimit Evropian në këtë fushë përqëndrohet në harmonizimin e disa aspekteve të veçanta të së drejtës së pronësisë intelektuale nëpërmjet krijimit të një sistemi të vetëm evropian, si në rastin e markave tregtare, dizenjove industriale komunitare, dhe patentave. Parimet që qëndrojnë në themelin e politikës së Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së pronësisë intelektuale janë parimet themelore të tregut të brendshëm, veçanërisht lëvizja e lirë e mallrave dhe shërbimeve dhe parimi mbi konkurrencën e lirë. Në mënyrë që të mbrojtë të drejtat e pronësisë intelektuale në territorin e saj, Bashkimi Evropian ka ndërtuar një sistem të bazuar në veçanti në uniformitetin e të drejtave të pronësisë intelektuale në nivel evropian.

Me këtë qëllim, ajo ka dy entitete të mëdha, Zyrën për Harmonizimin e Tregut të Brendshëm (OHIM)³⁹⁶ dhe Zyrën Europiane të Patentave (ZEP)³⁹⁷.

Zyra për Harmonizimin në Tregun e Brendshëm³⁹⁸ është organi përgjegjës për regjistrimin e markave tregtare dhe dizenjove duke siguruar kështu mbrojtjen në të gjithë Bashkimin Eu-

394 Neni 118, TFBE: “Në kuadër të krijimit dhe funksionimit të tregut të brendshëm, Parlamenti European dhe Këshilli, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legjislative, vendosin masat për krijimin e të drejtave të pronësisë intelektuale evropiane për të siguruar mbrojtje të njëjtë të të drejtave të pronësisë intelektuale në të gjithë Bashkimin dhe për ngritjen e kuadrit organizativ të centralizuar në mbarë Bashkimin për autorizimin, bashkërendimin dhe mbikëqyrjen.”

395 Intellectual, industrial and commercial property | Fact Sheets ...www.europarl.europa.eu > factsheets > sheet > propried..

396 (OHIM) Office for Harmonization in the Internal Market.

397 Consiglio regionale del Piemonte, “La tutela della proprietà intellettuale nell'Unione Europea”. <http://www.cr.piemonte.it/>

398 Office for Harmonization in the Internal Market, Wikipedia.

ropian. Pra, zyra kryen procedurat e ekzaminimit, regjistrimit, kundërshtimit dhe revokimit të markave tregtare dhe dizenjove komunitare.

Procedura tepër e thjeshtëzuar: me një aplikim të vetëm, një gjuhë të vetme për depozitimin e kërkesës, një qendër e vetme administrative, një skedar i vetëm, një pagesë e vetme, me mundësinë e aplikimeve të shumta; nxit prodhuesit që të ndjekin modelin e regjistrimit të një marke tregtare, ose një dizenjo në nivel evropian në OHIM.

Organizata Europiane e Patentave është e përbërë nga dy organe kryesore, Zyra Europiane e Patentave dhe Këshilli Administrativ.

Zyra Europiane e Patentave vepron si organi ekzekutiv i Organizatës, ndërsa Këshilli Administrativ vepron si organ mbikëqyrës dhe në një masë të kufizuar si organ legjislativ.

Zyra Europiane e Patentave³⁹⁹ ushtron funksionin e saj kontrollues përmes inspektorëve, të cilët vlerësojnë aplikimet për patentë, në mënyrë që të vendosin nëse shpikja i përmbush kushtet e parashikuara për patentë europiane.

Ajo gjithashtu është përgjegjëse për shqyrtimin e kundërshtimeve të paraqitura kundër patentave europiane.⁴⁰⁰ Ajo drejtohet nga një president i cili është njëkohësisht dhe përfaqësues i Organizatës Evropiane të Patentave.

Ndërsa për sa i përket menaxhimit të veprimtarisë së Zyrës, kjo kompetencë i përket të deleguarve nga shtetet kontraktuese në Këshillin Administrativ. Gjuhët zyrtare të Zyrës Europiane të Patentave janë anglishtja, frëngjishtja dhe gjermanishtja. Aplikimet për patentë europiane mund të paraqitet në çdo gjuhë të huaj, me kusht që të sigurohet një përkthim në një nga gjuhët zyrtare brenda dy muajve nga dita e aplikimit.

Lidhur me legjislacioni aktual të BE-së mbi të drejtën e autorit, ende nuk kemi një legjislacion të harmonizuar, duke krijuar pasiguri ligjore për individët dhe bizneset.

399 Official website of European Patent Office.

⁴⁰⁰ Legal foundations - EPOwww.epo.org › about-us › foundation

Vlen të përmendet se zhvillimet jashtëzakonisht të shpejta që kanë prekur botën dixhitale, sjellin nevojën për azhorinime dhe reforma në vijim. Pra, reformat në fushën e të drejtës së autorit duhet të ndërmerren duke marrë në konsideratë fenomene të reja, të tilla si: rrjetet sociale, ëeb streaming, nxjerrjen e të dhënave dhe tekstet, fotografi grafike etj. Legjislacioni mbi pronësinë intelektuale në Republikën e Shqipërisë synon mbrojtjen e të drejtave të autorit si dhe përafrimin e legjislacionit shqiptar me acquis e Bashkimit Europian, ratifikimin e konventave ndërkombëtare në këtë fushë dhe zbatimin e tyre, për arritjen e një niveli të ngjashëm mbrojtjeje me atë që ekziston në konventat ndërkombëtare.

Detyrimet e Shqipërisë, përcaktohen nga Nenet 70 dhe 73 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ku një vend me rëndësi ka dhe pronësia intelektuale. Për përmbushjen e këtyre kushteve është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 760, datë 1.9.2010 “Strategjia Kombëtare e Zbatimit të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale”⁴⁰¹ e cila përcakton një sërë masash të rëndësishme që janë sfida të së ardhmes për Shqipërinë dhe do të afrojnë vendin tonë drejt integimit.

Objektivat kryesore janë: plotësimi i kuadrit rregullator dhe legjislativ; zhvillimi dhe forcimi i institucioneve, të përfshira në zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale; forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit midis institucioneve në nivel kombëtar dhe rajonal; rritja e ndërgjegjësimit të publikut në lidhje me mbrojtjen e pronësisë intelektuale.⁴⁰²

Mungesa e informacionit dhe e ndërgjegjësimit për rëndësinë e të drejtës së pronësisë intelektuale ka sjellë problematika lidhur me zbatueshmërinë dhe mbrojtjen e kësaj të drejte. Kjo mungesë informacioni lidhet me faktin që ndodhemi përpara një të drejte të krijuar rishtazi në Shqipëri por edhe në botë.

Nisur nga ky fakt, iniciativat kryesore që duhen ndërmarrë, janë politikat inkurajuese për krijimin, shfrytëzimin e pronësisë intelektuale dhe për mbrojtjen e saj.

⁴⁰¹ Konferencën Kombëtare – 26 Prill 2016 - Drejtoria e te ...dda.gov.al › kkombetare

⁴⁰² Objektiva të parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 760, datë 01.09.2010, “Strategjia Kombëtare e Zbatimit të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale”.

Një nga faktorët që ka sjellë ndryshime të dukshme lidhur me kushtet e mbrojtjes dhe zbatueshmërinë e të drejtës së pronësisë intelektuale është teknologjia e re dhe tendenca e globalizimit të ekonomisë e tregtisë.

Rritja shumë e shpejtë e teknologjisë dixhitale dhe internetit ka patur një efekt të përgjithshëm në mbrojtjen e pronësisë intelektuale në mbarë botën.

Zhvillimet teknologjike cilësohen si faktor pozitiv lidhur me mundësitë e reja që sjellin për ushtrimin e të drejtave nga individit, kostot minimale të riprodhimit dhe shpërndarjes, disponueshmëria e bollshme dhe e lehtë e veprave të dixhitalizuara dhe objekteve të të drejtave të përafërta. Zhvillimet teknologjike cilësohen edhe si faktor negativ, kjo nisur nga cënimet e të drejtës së autorit përmes zgjerimit të së drejtës së shpërndarjes elektronike në mënyrë të pautorizuar. Lufta ndaj shkeljeve dixhitale po bëhet dita ditës edhe më e vështirë kjo për shkak të natyrës së tyre kalimtare, nga ana tjetër aktivitete të caktuara përmes internetit përhapen me hapa shumë të shpejtë dhe kjo bën që të jetë e vështirë të kontrollohen ligjërisht.⁴⁰³

Një luftë e vështirë është dhe ajo ndaj piraterisë, e cila po e sfidon dita ditës pronësinë intelektuale. Pirateria i dëmton interesat e autorëve dhe pronarëve të të drejtave, vendos në një pozitë jo të favorshme ekonomike ata të cilët veprojnë në përputhje me ligjin dhe pengon zhvillimin normal të ekonomisë së tregut ⁴⁰⁴. Problematikat në Shqipëri, lidhur me zbatueshmërinë, evidentohen dukshëm dhe me shtimin e rasteve nga praktika gjyqësore të shkeljes së kësaj të drejte, problematika me ekzekutimin e vendimeve dhe vjeljen e gjobave ndaj shkelësve dhe mungesa e bashkëpunimit të përdoruesëve lidhur me pagimin e tarifave të përdorimit.

403 Kikkis, J., "Digital piracy/Copyright violations in the Internet", TAIEX Workshop on the enforcement of copyright and related rights INT MARK 56995, organised in co-operation with the Albanian Copyright Office, Tiranë, 2016.

404 Sipas "Strategjisë për Zbatimin e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale", 2010-2015.

5.4 ADMINISTRIMI I ORGANIZATAVE SINDIKALE NË SHQIPËRI

E drejta e punës, si një degë e së drejtës civile, ndalet në trajtimin e instituteve kryesore lidhur me marrëdhëniet kontraktuale të punës. Ajo përfshin një tërësi të drejtash juridike të cilat kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve, të parashikuara në Kodin e Punës dhe ligje specifike.

Ky punim, ndalet në trajtimin e një elementi të domosdoshëm të së drejtës së punës, organizatat sindikale. Ato janë pjesë përbërëse e së drejtës sindikale, që përfaqëson tërësinë e normave juridike që rregullojnë pozitën juridike të organizatave sindikale, kontratave kolektive, të drejtën e grevës si dhe zgjidhjen e konflikteve të punës⁴⁰⁵.

Organizatrat sindikale cilësohen si një nga shyllat e demokracisë, kjo për shkak të lidhjes së tyre me interesat e shumë individëve dhe sigurisht me të drejtat e tyre themelore.

Nga përplasja e interesave të palëve, punëdhënës e punëmarrës, janë punëmarrësit ata më të pambrojturit, e për të përballuar çdo problematikë të krijuar në punë, krijojnë sindikatën si një instrument sigures për ta. Pra, organizatat sindikale cilësohen si organizime të grupimeve të ndryshme profesionale, me ide dhe qëllime të përbashkëta, në interes të mbrojtjes së tyre nga çdo fenomen dhe praktikë dëmtuese, si gjatë procesit të punësimit ashtu dhe kushteve të tjera gjatë jetës së tyre.⁴⁰⁶

Sindikatat kanë si qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe përfaqësimin e interesave ekonomike dhe shoqërore të anëtarëve të tyre, për këtë arsye, ato cilësohen si pjesa më profesionale dhe më cilësore e shoqërisë civile.

Shoqëria i jep një vend të veçantë sindikatave pasi ato organizojnë dhe përfaqësojnë njerëz, që për shkak të pamundësisë së tyre në mënyrë individuale, dhe për shkak të pamundësisë së

405 Çela, K., “E drejtë e punës”, Tiranë, 2011, fq. 509.

406 S. Mano, M., “Sindikata si pjesë e shoqërisë demokratike”, Tiranë, 2004, fq. 82.

tyre sociale, ekonomike ose fizike, e kanë të vështirë që t'i bëjnë prezente mendimet e tyre në procesin politik, ekonomik e shoqëror të vendit⁴⁰⁷.

Organizatata sindikale janë një aset i domosdoshëm i çdo shteti demokratik, për këtë arsye çdo shtet duhet ndërmarrë politika favorizuese lidhur me garantimin e lirisë sindikale, duhet të japi përkrahjen e nevojshme insitucionale, si dhe të sigurojë mosndërhyrjen në kufizimin e kësaj lirie.

E drejta për t'u bashkuar në organizata sindikale, cilësohet si një e drejtë themelore, e parashikuar shprehimisht në nenin 50 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.⁴⁰⁸

Lidhur me procedurën e krijimit, liritë sindikale dhe ndalimin e ndërhyrjes, kemi parashikimin e tyre në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë. Pavarisht ekzistencës së një kornize ligjore të organizuar, nevoja për politika favorizuese, rregullim ligjor dhe zbatueshmëri të legjislationit, cilësohen si prioritete lidhur me këtë fushë të së drejtës. Ndër vite, lëvizjet e punëtorëve, të ndikuara nga faktorë të shumtë politik, ekonomik e shoqëror, kanë qenë një shtysë e madhe në rrugën e zhvillimit të sindikatave.

Por, vendi yne, ka një histori relativisht të re lidhur me lëvizjet sindikale, kjo si pasojë e prapambetjes ekonomike dhe shoqërore të vendit.

E para lëvizje e organizuar punëtoare është ajo e vitit 1854 e emëruar “Vegjelia Shkodrane”. Në vitin 1857 me iniciativën e Zef Jubanit u themelua në Shkodër një shoqëri punëtoare e cila kishte statutin e saj. Në vijim, në vitin 1902, me iniciativën e Shtjefën Ingrizit u formua përsëri në Shkodër një shoqëri e tillë, e cila më pas u shpërnda nga presioni i autoriteteve të kohës.⁴⁰⁹

Në vitin 1905, krijohet në Shkodër shoqëria punëtoare “për ndihmë reciproke” me iniciativën e Kol Dikës, e formuar nga një rreth ilegal në të cilin bënin pjesë zejtarë, punëtorë dhe disa intelektual.

⁴⁰⁷ Nikollaj, K., “*Konfederata e sindikatave të Shqipërisë, organizatë demokratike*”, Tiranë, 2014, fq. 113.

⁴⁰⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë - Kuvendi i Shqipërisë www.parlament.al > Kuvendi > Kush..

⁴⁰⁹ Nikollaj, K., “*Konfederata e sindikatave të Shqipërisë, organizatë demokratike*”, Tiranë, 2014, fq. 11

Në Shkodër, po në këtë vit, për herë të parë në vendin tonë u festua dita e 1 Majit, të cilës i bëri jehonë dhe shtypi i kohës. Pas shpalljes së pavarësisë,

Shqipëria nisi të funksiononte si një shtet i vetëm, por gjendja e prapambetur e vendit nxiti organizimin e punëtorëve në sindikata. Në vitin 1913 në Shkodër u ngrit përsëri “Shoqëria ndihmëtare”.

Në Gjirokastrë, në vitin 1918 u krijua organizata për mbrojtjen e interesave të mësuesëve dhe në vitin 1920 në Korçë u krijuan shoqëri punëtorësh tashmë me një program të përcaktuar.

Vitet 1925-1939 sollën ndryshime pozitive lidhur me lëvizjen sindikaliste në Shqipëri.

Në Korçë, në vitin 1933, u krijua për herë të parë Shoqëria “Puna”. Në vijim, në vitet 1934-1935, u krijuan shoqëri profesionale të punëtorëve rrobaqepësve, këpucarëve, të shoferëve e të nënpunësve privatë.

Shoqëritë sindikaliste të kohës, i drejtoheshin punëdhënësit dhe qeverisë lidhur me kërkesat ekonomike, respektimin e 8-orëshit të punës, rritjen e pagës, sigurimin në punë etj.

Në 28 nëntor 1935 u organizua greva e parë në historinë e lëvizjes sindikale, e cila në 11 shkurt 1936 u shndërrua në një grevë të përgjithshme.

Me pushtimin e vendit nga Italia dhe fillimin e Luftës së Dytë Botërore, këto organizata sindikale u shpërndanë.⁴¹⁰ Pas çlirimit dhe vendosjes së diktaturës marrëdhëniet e punës u centralizuan, pra nuk bëhej fjalë për një lëvizje të vërtetë sindikale.⁴¹¹

Në vitet e diktaturës bëhej fjalë për bashkime profesionale të cilat zbatonin politikën e Partisë së Punës. Baza e rregullimit ligjor të bashkimeve profesionale në Shqipëri ishte sanksionuar për herë të parë në Ligjin Nr 82, datë 9 Korrik 1945 “Mbi kohën e shërbimit, mbrojtjen dhe shpërblimi në punë” (në nenin 7 të këtij ligji). Vlejnë të përmenden gjithashtu Kodi i Punës i vitit 1947 dhe Kodi i Punës i vitit 1956. Formalisht çdo mosmarrveshje që nuk mund të zgjidhej prej palëve në konflikt, zgjidhej prej sindikatave dhe punëdhënësve. Kur kjo nuk arrihej, mosmarrveshjet zgjidheshin nga Arbitrazhi i Ministrisë së Asistencës Sociale.

⁴¹⁰ Cela, K., “E drejtë e punës”, Tiranë, 2011, fq. 597.

⁴¹¹ Trade unions in Western Europe: hard times, hard choices Gumbrell-McCormick, R., Hyman, R., - 2013 - books.google.com

Kodi i Punës i vitit 1980, në nenin 12 të tij, shpallte parimin se “punëtorët dhe nënëpunësit kanë të drejtë të organizohen në Bashkime Profesionale”, por ideologjizmat, politizimi dhe demagogjia ishin ende të pranishme dhe në këtë periudhë. Pas rënies së regjimit diktatorial, në vend u krijuan kushte të përshtatshme për lindjen e marrëdhënieve të punës midis punëdhënësve dhe punëmarrësve dhe gjithashtu lindjen e sindikatave të para në Shqipëri.

Në vitin 1991 kemi të bëjmë me sindikatën e parë shqiptare, sindikatën e pavarur të minatorëve. Në 29.04.1991 parlamenti i parë pluralist miratoi ligjin “Për Sindikatat në Republikën e Shqipërisë”, i cili më vonë u përfshi në Kodin e Punës. Në vijim, pushuan së ekzistuari Bashkimet Profesionale dhe filloi një riorganizim i ri i sindikatave në kushtet e ekonomisë së tregut, duke respektuar anëtarësimin mbi baza vullnetare dhe bindjet politike të të gjithë anëtarëve⁴¹². Ndërsa në botë, sindikatat e lidhin zhvillimin e tyre me lindjen dhe rritjen e kapitalizmit.

Si një lëvizje e organizuar, sindikalizmi e ka origjinën e lindjes në shekullin e 19-të në Britaninë e Madhe, Evropën Kontinentale, dhe Shtetet e Bashkuara. Shoqatat e para të punëtorëve filluan të shfaqen në Britani në shekullin e 18, por ato mbetën sporadike dhe jetëshkurtër edhe përgjatë pjesës më të madhe të shekullit të 19. Kjo pjesërisht e ndikuar për shkak të konfliktit mes punëdhënësve dhe qeverisë, pasi kjo e fundit e kundërshtonte këtë formë të re të politikës dhe ekonomisë.

Këto lëvizje në Britaninë e Madhe favorizuan aktivizmin politik, gjë që çoi në formimin e Partisë së Punës në vitin 1906, ndërsa sindikatat amerikane ndoqën marrëveshjet kolektive, si një mjet i punëtorëve për të siguruar përfitimet e tyre ekonomike.⁴¹³

412 Nikollaj, K., “Konfederata e sindikatave të Shqipërisë, organizatë demokratike”, Tiranë, 2014, fq. 23.

413 Trade unions in Western Europe: hard times, hard choices Gumbrell-McCormick, R., Hyman, R.,- 2013 – books.google.com

Vlen të përmendet se organizatat sindikale, pavarësisht zhvillimeve historike, kanë pasur një ndikim afatgjatë si rregullatore të marrëdhënieve të punës, pasi parimet dhe praktikat e sindikatave janë të rrënjësura në sistemet ekonomike të shumicës së vendeve industriale.⁴¹⁴

5.4.1 RREGULLIMI LIGJOR I ORGANIZATAVE SINDIKALE NË SHQIPËRI

Kreu XVI i Kodit të Punës, trajton organizatat sindikale duke u ndalur në procedurën e krijimit të organizatave sindikale, liritë sindikale dhe ndalimin e ndërhyrjes. Konkretisht, Neni 176 i këtij kreu, jep përkufizimin dhe qëllimin kryesorë të organizatave sindikale: “Sindikatat dhe organizatat e punëdhënësve janë organizata profesionale shoqërore të pavarura që krijohen si bashkime vullnetare të punëmarrësve ose punëdhënësve. Qëllimi i tyre është përfaqësimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesave ekonomike, profesionale dhe shoqërore të anëtarëve të tyre.”⁴¹⁵. Pika e dytë e këtij neni, parashikon mundësinë e krijimit të federatave dhe konfederatave nga organizatat e punëmarrësve dhe të punëdhënësve, gjithashtu dhe të drejtën e anëtarësimit në to. Konkretisht, “organizatat e punëdhënësve dhe të punëmarrësve kanë të drejtë të krijojnë federata e konfederata dhe të anëtarësohen në to.

Federatat krijohen nga bashkimi vullnetar i dy ose më shumë organizatave profesionale. Konfederatat krijohen nga bashkimi vullnetar i dy ose më shumë federatave.”⁴¹⁶. Këtu, vlen të përmendet organizata sindikale më e madhe dhe më e organizuara në Shqipëri, Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë, e themeluar më 5 Qershor 1991, në Tiranë, me pjesëmarrjen e delegatëve nga të gjitha Federatat Sindikale të degëve të ekonomisë. KSSH u ngrit mbi baza vullnetare, e nxitur nga nevoja e punonjësve për të mbrojtur vëtveten në kushtet e reja social ekonomike e shoqërore. Qëllimet kryesore të KSSH janë:⁴¹⁷

414 Encyclopedia Britannica, "Trade union" <http://www.britannica.com/>

415 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Kreu XVI, Neni 176/1.

416 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Kreu XVI, Neni 176/2.

417 Trade unions in Western Europe: hard times, hard choices Gumbrell-McCormick, R., Hyman, R., - 2013 – books.google.com

Ruajtja dhe zhvillimi i një organizate Sindikale Kombëtare të fuqishme, të bashkuar, pluraliste, demokratike; Punësim të plotë dhe të zgjedhur lirisht, mirëqënie dhe standartizim më të mirë të jetesës për të gjithë anëtarët e sindikatës, përfshirë sigurimin e pagave, pensioneve dhe rregullimin e kohës së punës; Integrimin e plotë të grave në organizatat sindikale dhe promovimin në mënyrë aktive të barazisë gjinore në strukturat e saj vendimmarrëse të të gjitha niveleve; Mbështetjen e të drejtave të të rinjëve për punë të denjë, edukim dhe trajnim, si dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë në të gjitha nivelet vendimmarrëse⁴¹⁸. Pika e tretë e nenit 176 të Kodit të Punës, parashikon përfshirjen në nocionin sindikatë edhe të personave të tjerë jo punëmarrës, konkretisht, pensionistët dhe të papunët mund të anëtarësohen në organizatat e punëmarrësve.

Neni 177 i Kodit të Punës, parashikon numrin minimal të anëtarëve themelues të organizatave sindikale, pra akti i krijimit dhe statuti i çdo organizate profesionale duhet të nënshkruhen nga jo më pak se 5 anëtarë themelues për organizatën e punëdhënësve dhe jo më pak se 20 anëtarë themelues për organizatën e punëmarrësve.⁴¹⁹ Kjo dispozitë parashikon si dokumenta kryesorë të organizatës sindikale, Aktin e krijimit dhe Statutin, si dhe në vijim, parashikon formën ligjore dhe përmbajtjen e këtyre akteve.

Në statut detyrimisht duhet të përcaktohen: emri i organizatës; vendi ku ndodhet selia e saj; qëllimet e saj; kushtet e pranimit, të dorëheqjes dhe të përjashtimit të anëtarëve; të drejtat dhe detyrat e anëtarëve; përbërja dhe funksionimi i organeve drejtuese, si dhe kohëzgjatja e mandateve; sipas rastit, përkatësia në federatë ose në konfederatë; masat që merren në rast shpërndarje.⁴²⁰

Fitimi i personalitetit juridik lidhet me dorëzimin e aktit të krijimit dhe statutit në gjykatë, e parashikuar në nenin 178 të Kodit të Punës, ku në bazë të vlerësimit, gjykata me vendim i njeh këto subjekte si persona juridik.

418 Faqja zyrtare e Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë. <http://kssh.org/>

419 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Kreu XVI, Neni 177/1.

420 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Kreu XVI, Neni 177/2.

Po kjo dispozitë, në pikën e dytë, parashikon afatin prej 60 ditëve nga dorëzimi i statutit në Gjykatën e Tiranës,

që organizata sindikale të fitoj personalitet juridik, me përjashtim të rasteve kur gjykata jep vendim të kundërt. Për të ruajtur individualitetin dhe personalitetin e vet, nenet 179 dhe 180 të Kodit të Punës, përcaktojnë se asnjë organizatë profesionale nuk mund të ketë emrin e një organizate ekzistuese. Kjo kërkesë i shërben edhe individualizimit të përgjegjësisë së tyre në raste të caktuara. Çdo organizatë profesionale është e detyruar të depozitojë një kopje të statutit të saj pranë Ministrisë së Punës, në dobi të kësaj garancie⁴²¹. Më konkretisht, Kodi i Punës trajton liritë sindikale, ku, çdo organizata sindikale organizon lirisht administrimin dhe veprimtarinë e saj, gjithashtu harton lirisht programin e saj.⁴²²

Një nga parimet kryesore që parashikon kjo dispozitë, është ndalimi i diskriminimit ndaj përfaqësuesëve të sindikatës, parim ky që udhëheq sindikalizmin në çdo vend demokratik. Neni 181 i Kodit të Punës parashikon rastin e zgjidhjes së kontratës së punës nga punëdhënësi pa pëlqimin e organizatës së punëmarrësve, zgjidhje që konsiderohet e pavlefshme. Ligji parashikon gjithashtu disa raste përjashtimore të zgjidhjes së kontratës së punës edhe pa pëlqimin e organizatës së punëmarrësve, konkretisht, kur punëmarrësi shkel ligjin, kontratën kolektive të punës, kontratën individuale të punës ose nëse punëdhënësi provon që zgjidhja e kontratës është e domosdoshme për veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjes. Gjithashtu, për sa i përket ndryshimit të kushteve të kontratës së punës të përfaqësuesve të organizatës së punëmarrësve, kjo dispozitë parashikon se ndryshimet mund të bëhen vetëm me pëlqimin e punëmarrësit, gjithashtu dispozita parashikon dhe rast përjashtimor.

Neni 181 i Kodit të Punës, në vijim trajton detyrimin e punëmarrësit për të garantuar kushtet dhe lehtësitë e nevojshme për përfaqësuesit e organizatave të punëmarrësve për ushtrimin normalisht të funksioneve të tyre. Për këtë qëllim punëdhënësi duhet:

⁴²¹ Çela, K., *“E drejta e punës”*, Tiranë, 2011, fq. 586.

⁴²² Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Kreu XVI, Neni 181.

a) të lejojë hyrjen e tyre në mjediset e punës; b) të lejojë shpërndarjen e njoftimeve, broshurave, publikimeve dhe dokumenteve të tjera të organizatës së punëmarrësve; c) t’u japë kohën e nevojshme për të marrë pjesë në veprimtaritë e këtyre organizatave brenda dhe jashtë vendit; ç) të lejojë dhe t’u krijojë lehtësi në mjediset e punës për grumbullimin e kuotizacioneve të organizatës, si dhe për organizimin e mbledhjeve dhe të takimeve⁴²³. Neni 182 i Kodit të Punës, parashikon mbrojtjen e të drejtave të anëtarëve të organizatës së punëmarrësve në gjykatë. E drejta për një proces të rregullt ligjor garanton të drejtën e çdo personi që për mbrojtjen e interesave të tij të ligjshme, t’i drejtohet gjykatës ose organeve kompetente shtetërore.⁴²⁴ Gjykata Kushtetuese në interpretimin që i bën të drejtës për t’ju drejtuar gjykatës, e cilëson atë: “...si të drejtën që gëzon çdo individ për të ngritur padi në një gjykatë që ka juridiksion të plotë për të zgjidhur çështjen, që sanksionon në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t’ju drejtuar gjykatës por edhe detyrimin e shtetit që t’ia garantojë atij këtë akses. Gjykata Kushtetuese shprehet se në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesin në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës..”. Pra, kjo dispozitë garanton të drejtën e çdo organizate punëmarrësish për t’ju drejtuar gjykatës për mbrojtjen e interesave të tyre. Përveç detyrimit të shtetit lidhur me garantimin e lirisë sindikale, nga ana tjetër qëndron detyrimi lidhur me mosndërhyjen në kufizimin e kësaj lirie. Neni 184 i Kodit të Punës, parashikon se ndalohet çdo akt ndërhyrjeje në krijimin, funksionimin ose administrimin e organizatave profesionale nga organet shtetërore⁴²⁵

Në vijim, për t’i dhënë siguri juridike këtij rregullimi ligjor, në dispozitën vijuese, legjislatori ka parashikuar se organizata sindikale mund t’i drejtohet gjykatës për të ndaluar çdo veprim ndërhyrjeje ose kërcënimi ndaj saj.

⁴²³ Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Kreu XVI, Neni 181.

⁴²⁴ Omari, L., Anastasi, A., “*E drejta kushtetuese*”, Tiranë, 2010, fq. 183.

⁴²⁵ Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Kreu XVI, Neni 184.

Neni 184 i Kodit të Punës, gjithashtu parashikon dhe ndalimin e çdo akt ndërhyrjeje në krijimin, funksionimin ose administrimin e organizatave të punëmarrësve nga punëdhënësit ose organizatat e punëdhënësve. Si akte, ose veprime të ndërhyrjes së punëdhënësit ose të një organizate punëdhënësish konsiderohen ato veprime të parashikuara në Nenin 186 të Kodit të Punës. Konkretisht, përfshihen veprimet që nxisin krijimin e organizatave të punëmarrësve që mbizotërohen nga një punëdhënës ose një organizatë punëdhënësish, që mbështesin organizata punëmarrësish me mjete financiare apo mënyra të tjera, me qëllim që t'i vendosin këto organizata nën kontrollin e një punëdhënësi ose organizate punëdhënësish; pengojnë krijimin, funksionimin ose administrimin e një organizate punëmarrësish; dëmtojnë punëmarrësin për shkak të përkatësisë ose veprimtarisë së tij sindikale, duke e diskriminuar atë. Neni 187 i Kodit të Punës,⁴²⁶ parashikon shpërndarjen e organizatave sindikale, e cila rregullohet sipas mënyrës së caktuar në statut. Ashtu si shpërndaja, edhe struktura e brendshme organizative dhe kompetencat e organeve, rregullohen sipas statuteve përkatëse.

5.5 ORGANIZATAT SINDIKALE NË BASHKIMIN EVROPIAN

Gjatë dekadës së fundit, sindikatat në të gjithë Evropën janë pothuajse universalisht duke humbur anëtarësinë, fuqinë negociuese dhe po influencohen ndjeshëm nga politika.⁴²⁷

Në të gjithë BE-në, sindikatat po dëmtohen nga globalizimi, kjo e dukshme dhe në perëndim, ku ato kanë statusin e një shtylle thelbësore sociale.⁴²⁸

Vërehet një rënie e ndjeshme në industrinë e prodhimit në shkallë të gjerë, e cila konsidero-

⁴²⁶ Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë - Kuvendi www.parlament.al › Files › sAdminis. trata › kodi_i_punes, , Kreu XVII , Neni 178.

⁴²⁷ Trade unions in Western Europe: hard times, hard choices, Gumbrell, R., - Cormick, Mc., Hyman, R., - 2013 - books.google.com

⁴²⁸ Propositions on trade unions and informal employment in times of globalisation Gallin , D., - Antipode, 2001 - Wiley Online Library

het si baza kryesore e sindikatave.⁴²⁹ Për disa dekada, ekonomia e tregut, si në perëndim dhe në lindje ka sjellë një rritje të shpejtë të forma të ndryshme atipike të punësimit, një rritje pasigurie në tregun e punës dhe rritje të papunësisë.

Këto ndryshime në Europë, kanë përfshirë ndjeshëm punëtorët e rinj, të cilët janë veçanërisht të prekur nga pasiguria e tregut të punës. Statistikat tregojnë një rënie të dendësisë së anëtarësisë gjatë tre dekadave të fundit. Përbërja e anëtarësisë sindikale dominohet kryesisht nga punëtorë meshkuj të sektorit shtetëror dhe kryesisht të sektorit të prodhimit, me përfaqësim të dobët nga sektori privat. Dendësia është në vlera nën mesataren për grupmoshat e reja. Pavarësisht kësaj krize, në shumë vende, ka pasur një kthesë aktive drejt organizimit. Disa sindikata kanë riorganizuar strukturat e tyre në mënyrë inovative, duke ripërcaktuar qëllimin e tyre dhe vizionin social, e nga ana tjetër duke ristrukturuar apo gjetur qasje të reja ndaj angazhimit politik.

Sindikatat pa mbështetje insitucionale e legjitimitet publik, mbeten në pozita të dobëta për të mbrojtur të drejtat e punëtorëve. Në përgjithësi sindikatave i mungon mbështetja institucionale, ato mbeten të varur nga burimet e tyre, burime të cilat janë të varfëra. Në praktikë, kemi raste të sindikatave që gëzojnë mbështetje institucionale. Kjo e fundit, ka reduktuar tradicionalisht nevojën për të rekrutuar anëtarë, ku si shembull tipik janë vendet nordike. Sindikatat në të gjithë Evropën konsiderojnë si sfidë me rëndësi ndërmarrjen e politikave sociale për të arritur një organizimi model, kjo kryesisht për të forcuar përfaqësimin e grave, të rinjve dhe punëtorëve të pasiguruar.⁴³⁰ Përfaqësimi i interesave të grave të punësuar ka qenë prej kohësh një çështje e diskutueshme për sindikatat në Europë. Në gati çdo konfederatë, ka komitete të veçanta për gratë e punësuar. Këto organizma kanë ndërmarrë nisma të shumta për të siguruar trajnime të veçanta për pjesëmarrjen e grave në pozicione përfaqësuese dhe për futjen e kuotave ose të vendeve të rezervuara në organet vendimmarrëse. Në shumicën e

⁴²⁹ Trade unions in Western Europe: hard times, hard choices Gumbrell-McCormick, R., Hyman, R., - 2013 - books.google.com

⁴³⁰ Trade unions and migrant workers: New contexts and challenges in Europe Marino, S., Roosblad, J., Penninx, R., - 2017 - books.google.com

vendeve, sindikatat kanë krijuar struktura të veçanta, me një buxhet të dedikuar për punëtorët e rinj. Kjo politikë është bërë një prioritet për shumë sindikata dhe konfederata, pasi vërehet një rritje e numrit të punëtorëve të pasiguruar, treguesi i cili cënon burimet e organizatave dhe dobëson kapacitetin e tyre për të vepruar.⁴³¹

Shembull është Franca, e cila ka një organizim të dedikuar për të rinjtë; disponon burime për rekrutimin, trajnimin, si dhe ka krijuar qendrat dhe agjenci të përkohshme të punës, ku shumë punëtorë të rinj janë të punësuar. Spanja dhe Portugalia, kanë numrin më të madh të punëtorëve të rinj të pasiguruar. Në këto vende, sindikatat kryesore, kanë krijuar departamente të veçanta për punëtorët e rinj, emigrantët, si dhe për gratë. Italia, është gjithashtu një shembull i vendit ku janë krijuar konfederata të veçanta për punëtorët e përkohshëm.⁴³²

Sfidat për sindikatat janë të dukshme, por mbi të gjitha, në shumicën e vendeve duhet ndërmerren politika favorizuese dhe duhet sigurohet përkrahja institucionale.

Shumë sindikata kanë humbur besimin në kapacitetin e tyre për të arritur një ekonomi më të mirë dhe një shoqëri më të mirë. Sindikatat duhet të besojnë, dhe të demonstrojnë se një e ardhme më e mirë është e mundur.⁴³³

5.5.1 RËNDËSIA E ORGANIZATAVE SINDIKALE

Nga krijimi e deri në vijim, organizatat sindikale, veçanërisht në Shqipëri, janë hasur në ndryshime të njëpasnjëshme. Ndryshime të cilat lidhen me faktorë social, krizën ekonomik dhe ndikime të ndjeshme të politikës.

Fuqia e lëvizjes punëtore në Shqipëri, në çdo moment ka qenë e lidhur me kushtet e përgjithshme ekonomike.⁴³⁴

⁴³¹ The European trade union federations: profiles and power resources—changes and challenges in times of crisis Müller, T., Platzer, HW., - waters European trade unions in a time of ..., 2017 - sarkoups.free.fr

⁴³² Xibraku, D., Pupe ,E.,- 2018 - knowledgecenter.ubt-uni.ne

⁴³³ Bernaciak, R., Gumbrell-Miccormick, R., Hyman Trade, “Unions in Europe, Innovative Responses to Hard Times”.

⁴³⁴ The economic incorporation of immigrants in 18 western societies: Origin, destination, and community effects Van Tubergen, F., Maas, I., Flap, H., - Ame

Kriza ekonomike, në vendet në zhvillim si Shqipëria, ka ndikuar dukshëm në ndryshimet që kanë prekur vitet e fundit të drejtën sindikale. Sektori i industrisë prodhuese, i konsideruar si fortësia e sindikatave në vendin tonë, vitet e fundit ka pësuar një rënie të ndjeshme, kjo e lidhur me pamjaftueshmërinë si nga ana e burimeve njërëzore, ashtu edhe nga ana e burimeve financiare. Ekonomia e tregut ka sjellë një rritje të shpejtë të sektorit privat dhe krijimin e tregut informal të punësimit. Ndërkohë në Shqipëri, sipas statistikave, rezulton se sektori privat është shumë më pak i përfshirë në organizata sindikale se sektori shtetëror.⁴³⁵ Gjatë zhvillimit historik të organizatave sindikale, vërehet se veprimi i drejtpërdrejtë i politikës, ka ndikuar në krijimin e marrëveshjeve kolektive, të cilësuar si mjeti kryesor i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mbi pagat, kushtet e punës, si dhe çështje të tjera lidhur me marrëdhënien e punës. Nga ana tjetër, lidhur me faktorin politik, në varësi të rrëzimit apo krijimit të qeverive, të cilat në historinë e Shqipërisë kanë qenë të shumta, vërehen luhajtje të numrit të anëtarësimeve në organizatat sindikale. Shpesh herë, bindjet politike bëhen shkak diskriminimi ndaj anëtarëve të sindikatave dhe si pasojë lind pasiguria për vendin e punës.⁴³⁶

Pra, faktori politik ndikon ndjeshëm tek subjektet e marrëdhënies së punë, mes tyre ka koordinim të pamjaftueshëm, mungesë bashkëpunimi dhe solidariteti. Aktualisht gjendemi mes pengesash e faktorësh që nuk garantojnë një klimë të qetë e normale të shoqërisë shqiptare, në veçanti të shtresave të pambrojtura. Roli dhe të drejtat e punëmarrësve për të themeluar grupime sindikale dhe ushtrimi i lirë i funksionit të tyre, janë të drejta të fituara nga vetë ata, nëpërmjet një aktiviteti dhe një procesi të vështirë në përballje me shumë pushtete dhe shume faktorë.⁴³⁷

Sindikalizmi si nxitës e mbrojtës, si faktor kryesor i ndryshimeve pozitive, duhet të marrë përgjegjësitë e tij përmes një aksioni konkret në kohën e duhur me profesionalizëm dhe veprime demokratike. Çdo strukturë sindikale duhet të funksionojë demokratikisht, pa u

⁴³⁵Rruga e gjatë drejt dialogut social në Shqipëri, Dragoshi, F., Pappa, A., - 2015 - idmalbania.org

⁴³⁶ Mërkuri, A., Bozo, A., - qag-al.org

⁴³⁷ Trade unions in Western Europe: hard times, hard choices
Gumbrell, R., Cormick, Mc., Hyman, R., - 2013 - books.google.com

ndikuar nga faktorë të jashtëm dhe e mbrojtur nga çdo ndërhyrje arbitrare në funksionimin e saj. Ndërtimi demokratik i institucioneve sindikale, është garanci në drejtim të respektimit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.⁴³⁸

Nisur nga kjo, përmirësimi i kuadrit ligjor, sigurimi i mbështetjes institucionale dhe aplikimi i politikave sociale duhet të jetë prioritet i shoqërisë sonë.

5.6. ROLI I GJYKATËS NË REFORMËN ADMINISTRATIVE NË SHQIPËRI DHE EFIKASITETI I SAJ

Një sistem gjyqësor efektiv ka kohë që është shumë i mirëpritur nga qytetarët në Shqipëri. Gjykata administrative ka filluar të japi konsistencat e para.⁴³⁹

Qëndrueshmëria e një reforme strukturore të gjykatave nuk duhet të bëhet pa mbajtur parasysh detyrimin e shtetit për të siguruar një sistem të drejtësisë që të garantojë të drejtën e qytetarëve nga akti administrativ", për një dëgjim publik brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e krijuar me ligj në kuadër të përcaktimit të të drejtave dhe detyrimeve të tyre administrative, civile ose të çdo forme abuzimi tjetër e administratës kundër tyre". Kjo e drejtë është e garantuar shprehimisht nga neni 42 paragrafi 2 i Kushtetutës së Shqipërisë, si dhe nga neni 6, paragrafi 1, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Ajo nuk limitohet vetëm për të garantuar në thelb të drejtën për një gjykim të drejtë në proceset gjyqësore të cilat tashmë janë në një fazë të re të implimentimit, por mishëron "të drejtën për një gjyq", si një e drejtë për të pasur një pretendim para një gjykate të mirëorganizuar". Vetë ekzistenca e së drejtës për një gjykatë sipas ligjit në fuqi, megjithatë, nuk është e mjaftueshme dhe konverguese.⁴⁴⁰ Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka për qëllim që të mos garantojë të drejta që janë teorike apo iluzione por të drejtat që janë praktike dhe efektive, dhe e njëjta vlen sigurishte edhe sot për Kushtetuten Shqiptare. Aplikimi i

⁴³⁸ Binaku, M - uet.edu.a, Tiranë 2017

⁴³⁹ Zaganjori, Xh., Anastasi, A., Methasani., - 2011 - Adelprint Publishing House, Tirana

⁴⁴⁰ Xibraku, D., Pupe, E., - 2018 - knowledgecenter.ubt-uni.

parimeve të mirenjohura dhe të provura në praktike duhet në riorganizimin e planifikuar të gjykatave të shkallës së parë dhe veçanërisht në krijimin e gjykatave administrative si garanci për një proces të rregullt ligjor të çon në përfundimet e mëposhtme.

Sot Shqipëria po jeton një situatë të një pritshmërie të lartë nga këto gjykata si formë të rregullimit të një kontrolli gjyqësor mbi problematikat e shumta të administratës në tërësi .⁴⁴¹

Gjyqësia administrative paraqet lloj të kontrollit mbi administratën, përkatësisht mbi aktin administrativ, në rradhë të parë aktin administrativ të veçantë dhe individual.⁴⁴²

Ky lloj i kontrollit realizohet në atë fushë të veprimtarisë administrative nëpërmjet të së cilës zhvillohet forma më e rëndësishme e funksionit të saj⁴⁴³. Vende të ndryshme Europiane konsiderohen ‘djep’ i gjyqësisë administrative. Praktika juridike franceze, ka krijuar format e para të gjyqësisë administrative dhe të konfliktit administrativ (le contentieux administratif). Në fillim të shekullit të XIX-të, zgjidhja e konflikteve administrative midis administratës publike dhe qytetarëve i ishte besuar këshillave të veçanta dhe Këshillit Shtetëror (Conseil d’Etat). Në këtë mënyrë, Franca shërbeu si ‘model’ dhe si ‘shembull’ për gjyqësinë administrative që, më vonë, u ndoq edhe nga vendet e tjera të Europës. Vlen të theksohet se Këshilli Shtetëror në Francë, nga një ‘organ administrativ’ me kohë ‘u shndërrua’ në një ‘gjykatë të veçantë administrative’, me kompetencë që të zgjidhë konfliktet që krijoheshin me fokus çështjet administrative.

Një fakt i tillë ‘ndikoi në masë të madhe’ në ‘qëndrimin e teorisë franceze’, sipas së cilës gjykatat e veçanta administrative u konsideruan ‘pjesë e pushtetit administrativ’, e jo ‘pjesë e pushtetit gjyqësor’. Në fakt, doktrina franceze përherë ka ‘refuzuar’ që Këshillin Shtetëror dhe gjykatat e tjera administrative t’i trajtojë si pjesë e ‘sistemit unik gjyqësoro-juridik’, veçse i ka paraqitur si ‘organizata të veçanta’, të lindura në ‘krahun e administratës’.⁴⁴⁴

⁴⁴¹ Xibraku, D., Pupe, E., - 2018 - knowledgecenter.ubt-uni.ne

⁴⁴² Probleme të organizimit të sistemit gjyqësor për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative
Daci, J., - Gjeopolitika, 2011 - ceeol.com

⁴⁴³ <http://www.esat.stavileci.com/index.php/artikujt/122-gjyqesia-administrative-mundesite-dhe-perparesite>

⁴⁴⁴ Borkovic, I., Upravno pravo (E drejta administrative), ‘Informator’, Zagreb, 1997, faqe 448.

Gjygjësia administrative sot është e përhapur në të gjithë Europën dhe kjo praktikë është instaluar së fundmi edhe në vendin tonë.

Krijimi i gjykatës administrative është një risi për sistemin tonë gjygjësor, pasi jo vetëm që i lehtëson punën gjykatave të tjera, individëve si edhe organeve publike; por ekzistenca e një gjykate të tillë është edhe garanci për një gjykim më të drejtë.

5.6.1 GJYKATA ADMINISTRATIVE KONTROLLUESE E LIGJSHMËRISË

Proçesi i rregullt ligjor nuk është thjesht vetëm një e drejtë.⁴⁴⁵ Ai sot trajtohet më shumë si një parim kushtetues që shtrihet ndaj disa të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në tërësi. Ai ka si funksion dhe qëllim mbrojtjen e individit nga ndërhyrjet e paligjshme të autoriteteve publike. Për ta bërë sa më efektive këtë mbrojtje, ligjvënësi kushtetues ka parashikuar edhe një mjet juridik të kontrollit ndaj këtyre akteve, përveç atij administrativ.⁴⁴⁶

Zgjedhja aktuale ligjore e zgjedhur për këtë qëllim është i kenaqshëm, por ngelet larg nga qëllimi i krijimit të tyre. Kontradiksioni, në disa vende ai ushtrohet nga gjykatat e zakonshme, në disa vende nga gjykata të posaçme të ashtuquajtuara edhe gjykata të të drejtave të njeriut. Të tilla mund të konsiderohen edhe gjykatat kushtetuese, të cilat i gjejmë të pëhapura gjerësisht në Europë e më pak në kontinente të tjera. Kushtetuta e Shqipërisë bën kontrollin e përputhshmërisë me aktin administrativ.⁴⁴⁷

Hartimi i një ligji për organizimin dhe funksionimin e gjyktave administrative erdhi ndër të tjera si rezultat i nevojës për shmangjen e zvarritjes së proçeseve gjyqësore mes biznesit dhe shtetit, apo edhe qytetarit dhe shtetit, në kuadër të parimeve dhe rekomandimeve të Këshillit të Europës, si dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila në

⁴⁴⁵ Rule of Law in the Constitution of the Republic of Albania Zaganjori, Xh., Anastasi, A., Methasani, E., - 2011 - Adelprint Publishing House, Tirana

⁴⁴⁶ Xibraku, D., Pupe, E., - 2018 - knowledgecenter.ubt-uni.ne

⁴⁴⁷ Zaganjori, Xh., Vorpsi, A., Biba, D., Parime Kushtetuese dhe të Drejtat Themelore në Jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, Botimet Konr.ad Adenauer Stiftung & Universiteti i Tiranës, Adelprint, Tiranë 2012

shumicën e çështjeve kundër shtetit shqiptar ka konstatuar një cënim të procesit të rregullt ligjor.⁴⁴⁸

Për qëllim të respektimit të parimit të një procesi gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, ligji parashikon afate të shpejta përpara i përket shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e shkallës së parë Administrative dhe Gjykata e Apelit Administrative, me qëllim reduktimin e ndjeshëm të zvarritjes së proceseve gjyqësore me objekt gjykimi aktet , veprimet administrative.

Gjithashtu në kuadër të këtij parimi, ligji i ka kushtuar një rëndësi edhe parashikimeve ligjore përpara i përket përsheptimit dhe efektivitetit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, si pjesë e pandashme e procesit të rregullt ligjor me synim efikasitetin e ligjshmerisë.⁴⁴⁹

Ligji sot garanton mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të personave nëpërmjet detyrimit që u vihet organeve publike në provimin e ligjshmërisë të formës dhe të përmbajtjes së veprimit administrativ të nxjerrë prej tyre dhe kjo po shfaq ndikim pozitiv.⁴⁵⁰

5.6.2 ORGANIZIMI DHE GJYKIMI ADMINISTRATIV

Eshte formuar një gjykatë administrative në dy shkallë,atë të nivelit të ulët ose fillestar dhe ai në gjykim në nivel të dytë nga një gjykate Apeli.Kjo e fundit është një dhe e vendosur në kryeqytetin Tiranë.⁴⁵¹

Gjykimi i efektshëm gjyqësor i akteve administrative është një element kryesor i sistemit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në të njëjtën kohë është një instrument i domsdoshëm për përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë administrative dhe për të siguruar një performancë të mirë të administratës publike. Për më tepër është një kërkesë e një shoqërie në

448 ECHR, CEDH, news ... - European Court of Human Rights www.echr.coe.int › Pages

449 Rule of Law in the Constitution of the Republic of Albania Zaganjori, Xh., Anastasi, A., Methasani, E., - 2011 - Adelprint Publishing House, Tirana

450 Xibraku, D., Pupe, E., - 2018 - knowledgecenter.ubt-uni.net

451 Gjykata Administrative e Apelit www.gjykataadministrativeeapelit.al

zhvillim, sepse siguria e tregëtisë dhe investimeve ndërkombëtare kërkojnë organe publike vendim-marrëse që t'u nënshtrohen mjeteve të efektshme të mbrojtjes.⁴⁵²

Ngritja e sistemit gjygjësor administrativ në Shqipëri përputhet me standartet europiane, nëse garantohet pavarësia dhe paanësia e gjykatës. Gjykata administrative në Shqipëri punon me një gjygtarë në Gjykatën e Shkallës së Parë, dhe tre gjygtarë në Gjykatën e Apelit. Rastet administrative shqyrtohen dhe me një koleg administrativ në Gjykatën e Lartë⁴⁵³.

Të tri shkallët e asaj gjykatë filluan punën në të njëjtën ditë sipas ligjit. Po ashtu edhe janë objekt shqyrtimi dhe hyjnë në juridiksionin e gjykatës administrative të shkallës së parë edhe kerkese paditë që lidhen me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar.⁴⁵⁴

Subjektet që legjitimohen për të bërë padi në gjykatën administrative janë disa, ku mund sipas ligjit te rendisim :

- a) Çdo subjekt që pretendon se i është cënuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik.
- b) Organi i administratës publike që pretendon së është cënuar në ushtrimin e kompetencave nga një akt administrativ apo një akt nënligjor normativ i paligjshëmi një organi publik me të cilin nuk ka lidhje varësie hierarkike.
- c) Në këtë rast organi shtetëror mund të kërkojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës dhe shfuqizimin e aktit.
- d) Punëmarrësi ose punëdhënësi për mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës kur punëdhënësi është një organ i administratës publike.

452 Marie Woehrling, J., Kontrolli Gjygjësor i Autoriteteve Administrative ne Europe: Drejt nje modeli te përbashkët, i redaktuar nga SIGAMA (një iniciativë e përbashkët e OSBE dhe BE)

453 Neni 4 pika 1 e Ligjit nr 49/2012 “Pwr organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

454 Natyra kushtetuese dhe normative e dekretit të Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve dhe kontrolli i drejtësisë kushtetuese mbi këtë akt, DACI, J., - academia.edu

- e) Çdo subjekt që pretendon se është cënuar në të drejtat dhe interesat e tij të ligjshëm për shkak të ndërhyrjes së paligjshme të organit publik që nuk kanë formën e aktit administrativ.
- f) Çdo shoqatë apo grup interesi që pretendon se i është cënuar një interes i ligjshëm publik.
- g) Nga një akt normativ.
- h) Nga një akt administrativ në rast se një e drejtë e tillë u njihet me ligj.
- i) Çdo subjekt tjetër të cilit kjo e drejtë i njihet shprehimisht në ligj⁴⁵⁵.

Sipas KPC-së, paraqitja e provave nga palët bëhet në çdo rast përpara seancës së parë gjyqësore. Me kërkesë më shkrim të motivuar të organit publik të paraqitur brenda afatit të caktuar sipas shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 25 të këtij ligji gjykata i cakton atij një afat të dytë, që duhet të mbarojë jo më vonë se 5 ditë përpara datës së seancës gjyqësore.

Në rastet e mosparaqitjes së provave edhe mbas afatit të dytë të caktuar, shqyrtimi i çështjes vazhdon vetëm mbi aktet e paraqitura.

